

Komuna e Istogut



HARTA ZONALE E KOMUNËS SË ISTOGUT 2022 - 2030

urban
STUDIO E PLANIFIKIMIT DHE DIZAJNIT URBAN



Përmbajtja

1.0	HYRJE	9
1.1	Baza ligjore për hartimin e Hartës Zonale të Komunës.....	9
1.2	Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës	9
1.3	Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës.....	12
1.4	Kërkesat që rrjedhin nga planet zhvillimore sektoriale të Planit Zhvillimor Komunal	12
1.5	Ndërlidhjet me Planet Rregulluese në fuqi.....	13
1.6	Ndryshimet në tematikë ose në strategjinë sektoriale lokale që nga miratimi i Planit Zhvillimor Komunal	13
2.0	ARSYETIMI	15
2.1	Aspekte të rëndësishme për trajtim para përcaktimit të zonave dhe kushteve të përgjithshme zhvillimore	16
2.2	Zonat	17
2.3	Zonat mbishtresore	18
3.0	KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSME	19
3.1	Shfrytëzimet e tokës	19
3.2	Qasja në parcelen kadastrale	19
3.3	Vija ndërtimore	20
3.4	Qasja në infrastrukturën teknike	20
3.5	Rregullat për parkim dhe shkarkim.....	21
3.6	Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës	23
3.7	Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial	23
3.8	Kërkesat për zvogëlim të zhurmës	24
3.9	Formësimi estetik arkitektonik	25
3.10	Kërkesat për peizazh dhe mobiluar urban	26
3.11	Kërkesat për përcaktimin e kuotës së përdhësës	27
3.12	Kërkesat tjera- konzollat, shkallët e jashtme, rampat, rrethojat	27
3.13	Kërkesat lidhur me karakteristikat e terrenit dhe kushtet e zhvillimit të terrenit.....	28
4.0	LISTA E ZONAVE	29
4.1	Zonat, nën-kategoritë dhe nën-zonat në komunën e Istogut.....	29
4.2	Zonat mbishtresore të përcaktuara brenda territorit të komunës.....	31
4.3	Zonat, nënzonat dhe zonat mbishtresore në secilin vendbanim.....	32
5.0	ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KUSHTET ZHVILLIMORE	35
5.1	ZONA E BANIMIT- ZB.....	36
5.1.1	Zona e banimit të përhershëm- ZB (5.1 Kodi HILUCS 2)	37
5.1.2	Zona e banimit me funksione në pajtueshmëri- ZBmix (5.2 Kodi HILUCS 2)	42
5.2	ZONA KOMERCIALE- ZK.....	44
5.3	ZONA INDUSTRIALE- ZI.....	46
5.3.1	Zona industriale e lëndës së parë- ZILP (2.1.7 Kodi HILUCS 3)	46
5.3.2	Zona industriale e prodhimeve të lehta- ZIPL (2.3.1 Kodi HILUCS 3).....	46

5.3.3 Zonë industrial- prodhim I energjisë- ZIPE (2.4.4 Kodi HILUCS 3).....	47
5.4 ZONA PËR SHFRYTËZIM TË PËRZIER- ZSHP	49
5.5 ZONA USHTARAKE E SIGURISË- ZUS.....	50
5.5 ZONA E SHËRBIMEVE- ZSH	53
5.5.1 Zona e shërbimeve tregtare, ZSHT (3.1 Kodi HILUCS 2)	53
5.5.2 Zona shërbimeve financiare dhe të informacionit, ZSHFI (3.2 Kodi HILUCS 3).....	55
5.6 ZONË BUJQËSORE- ZB	57
5.7 ZONA PYJORE- ZP	61
5.8 ZONA MINIERE-SIPËRFAQËSORE- ZMS	63
5.9 SIPËRFAQE E MBROJTUR- SM	67
5.10 ZONA E VEÇANTË E MBROJTUR- ZVM.....	69
5.11 ZONA E VEÇANTË - ZV	72
5.12 SIPËRFAQET UJORE DHE ZONAT E MBROJTURA SANITARE TË BURIMEVE TË UJIT	74
5.13 ZONË E NDIKUAR NGA VËRSHIMET- ZNV.....	78
5.14 ZONË E MBROJTUR ARKEOLOGJIKE-HISTORIKE- ZMAH.....	79
6.0 KUSHTET ZHVILLIMORE TË ZONAVE MBISHTRESORE	85
6.1 Masat mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore – të përcaktuar në zonën bazë (ZMaH).....	85
6.2 Masat mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura dhe zonat mbrojtëse.	85
6.2.1 Mbrojtja e zonave dhe sipërfaqet e mbrojtura- të përcaktuar tek zona bazë (SM)	85
6.2.2 Mbrojtja e zonave të veçanta- të përcaktuara tek zona bazë (ZV)	85
6.2.3 Mbrojtja e zonave të veçanta të mbrojtura- të përcaktuara tek zona bazë (ZVM)	85
6.3 Masat mbrojtëse për resurset lokale natyrore si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve.....	85
6.3.1 Masat mbrojtëse për tokë pyjore:	85
6.3.2 Masat mbrojtëse për ujëra- të përcaktuara në zonën bazë (ZMU)	85
6.4 Masat mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, orteqeve, termetet e të tjera	85
6.4.1 Masat për mbrojtje nga zjarri	85
6.4.2 Masat për mbrojtje nga vërshimet	86
6.4.3 Masat për mbrojtje nga erozioni	86
6.4.4 Masat për mbrojtje nga tërmetet	87
6.4.5 Masat për mbrojtje nga breshëri	88
6.5 Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për tu zbatuar në gjithë territorin e Komunës. 88	
6.5.1 Masat për mbrojtje nga stuhitë e erës.....	88
7.0 INFRASTRUKTURA RRUGORE.....	91
7.1 Shfrytëzimet e lejuara dhe kushtet zhvillimore	91
7.1.1 Kushtet teknike	92
7.2 Rrjeti I transportit- ZKT (4.1 Kodi HILUCS 3).....	93
7.2.1 Transporti I motorizuar	93
7.2.2 Transporti jo I motorizuar	102
7.3 Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural.....	103

8.0 INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	105
8.1 Zona shërbimeve të komunitetit, ZSHK (3.3 Kodi HILUCS 3)	105
8.1.1 Shërbimi I administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale (3.3.1- HILUCS 3).....	108
Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat e komunitetit.	108
8.1.2 Shërbimi arsimor (3.3.2- Kodi HILUCS 3).....	109
8.1.3 Shërbim shëndetësor dhe shoqëror (3.3.3- Kodi HILUCS 3)	111
8.1.4 Shërbim tjetër I komunitetit (3.3.5- Kodi HILUCS 3)	113
8.2 Zona e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative, ZSHKR (3.4 Kodi HILUCS 3)	113
8.2.1 Shërbimi kulturor (3.4.1- Kodi HILUCS 3)	115
8.2.2 Infrastrukturë sportive dhe rekreative (3.4.3- Kodi HILUCS 3)	115
8.2.3 Hapësirë e hapur rekreative (3.4.4- Kodi HILUCS 3)	117
9.0 INFRASTRUKTURA TEKNIKE	119
9.1 Rrjeti i ujësjellësit	119
9.2 Rrjeti i kanalizimit.....	120
9.3 Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza	122
9.4 Sistemi e drenazimit	127
9.5 Rrjeti e ujitjes	127
9.6 Rrjeti I energjisë elektrike	129
9.7 Rrjeti i telekomunikacionit	139
9.8 Rrjeti I grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave	141
10.0 ARSYETIMI PËR NEVOJËN E HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME TË PLANIFIKUARA.....	145
11.0 PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM	147
11.1 Planet e veprimit lidhur me zhvillimin socio-ekonomik.....	147
11.2 Planet e veprimit lidhur me transportin	149
11.3 Planet e veprimit lidhur me infrastrukturën teknike	151
11.4 Planet e veprimit lidhur me mjedisin.....	152
12.0 NDRYSHIM PLOTËSIMET, PËRJASHTIMET DHE JOKONFORMITETI	155
12.1 Ndryshim plotësimet.....	155
12.2 Përfjashtimet.....	155
12.3 Jokonfomiteti	156
13.0 INTERPRETIMI, ANKESAT, ZBATIMI DHE MONITORIMI I HARTËS ZONALE TË ISTOGUT	157

Pjesa hartografike

REFERENCAT

Lista e figurave

Fig. 1 Tërësitë hapësinore	17
Fig. 2 Distanca në mes të ndërtesave	19
Fig. 3. Rregulli i rrafshit 45 shkallë	24
Fig. 4 Rregulli i rrafshit 45 shkallë i përcaktuar në një lartësi specifike dhe rasti në pjerrësi.....	24
Fig. 5 Paleta e ngjyrave të përdorshme dhe jo të përdorshme	26
Fig. 6 Skema e shprëndarjes së kategorive të banimit në komunën e Istogut	36
Fig. 7 Zona ushtarake e sigurisë - ZuS bashkë me perimetrin mbrojtës, zonën e sigurisë ushtarake- ZsU (burimi: Ministria e Mbrojtjes, Departamenti I Operacioneve dhe trajnimeve)	51
Fig. 8 Skema e shprëndarjes së zonës së shërbimeve	53
Fig. 9 Harta gjeologjike e komunës së Istogut (burimi: Komisioni I Pavarur për Miniera dhe Minerale, dok. 451/26.02.2021).....	64
Fig. 10 Harta e menraleve në komunën e Istogut (burimi: KPMM, dok. 451/26.02.2021)	64
Fig. 11 Licencat dhe lejet për aktivitete të veçanta (burimi: KPMM, dok. 451/26.02.2021).....	65
Fig. 12 Skema e shprëndarjes së zonës së komunikacionit dhe transportit në komunën e Istogut....	91
Fig. 13 Brezat mbrojtëse të rrugëve	101
Fig. 14 Një nga mundësitë e ridizajnit të kompleksit të përmbajtjeve publike në Dubravë.	107
Fig. 15 Sistemi aktual i përzier dhe ai i ndarë që planifikohet	124
Fig. 16 Skema e impiantit.....	125
Fig. 17 Prerja gjatësore e impiantit vertikal	125
Fig. 18 Prerja gjatësore e impiantit horizontal	127
Fig. 19 Harta elektroenergetike e Kosovës (burimi: kostt, Sistemi transmetues I Republikës së Kosovës 2016)	130
Fig. 20 Trafostacionet distributive në vendbanimet e komunës së Istogut.....	133

Lista e tabelave

Tab. 1 Lista e takimeve.....	11
Tab. 2 Shembull i propozimit të nënzonave- Zona e Banimit	18
Tab. 3 Vija ndërtimore	20
Tab. 4 Numri i vend-parkimeve për automjete në varësish nga përmbajtja	22
Tab. 5 Vlerat kufitare të burimit të zhurmës nga trafiku	25
Tab. 6. Lista e zonave dhe nënzonave në komunën e Istogut	29
Tab. 7 Zonat mbishtresore në komunën e Istogut.....	31
Tab. 8. Zonat, zonat mbishtresore dhe nënzonat nëpër vendbanimet e komunës së Istogut.....	33
Tab. 9. Nënkatëgoritë e banimit dhe shtrirja e tyre në bazë të qendrave kryesore	36
Tab. 10. Shfrytëzimet e tokës në zonën e banimi të mesëm dhe të lartë.....	38

Tab. 11. Shfrytëzimi i tokës të banimi rural	39
Tab. 12 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e ultë	40
Tab. 13 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e mesëm dhe të lartë	41
Tab. 14 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e ultë mix.....	42
Tab. 15 Dendësia banimore	43
Tab. 16. Shfrytëzimet e tokës te zona komerciale.....	44
Tab. 17 Zona industriale e lëndës së parë- shfrytëzimet e tokës	46
Tab. 18 Zona industriale e prodhimeve të lehta- shfrytëzimet e tokës.....	47
Tab. 19 Zona industriale/ prodhim i energjisë shfrytëzimet e tokës	47
Tab. 20. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat industrial dhe komerciale	48
Tab. 21 Zona ushtarake e sigurisë- shfrytëzimet e tokës.....	51
Tab. 22. Shfrytëzimet e tokës për zonën tregtare	54
Tab. 23 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbimet tregtare	55
Tab. 24. Shfrytëzimet e tokës të zona e shërbimeve financiare dhe të informacionit	55
Tab. 25. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbimet financiare dhe informacionit	56
Tab. 26. Zona bujqësore- shfrytëzimet e tokës	58
Tab. 27 Kushtet ndërtimore për ndërtesat bujqësore.....	59
Tab. 28 Zona Pyjore- shfrytëzimet e tokës	62
Tab. 29 Kushtet ndërtimore për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë	62
Tab. 30. Shfrytëzimet e tokës te sipërfaqet e mbrojtura.....	67
Tab. 31. Shfrytëzimi i tokës - zona e veçantë.....	72
Tab. 32. Shfrytëzimet e lejaure në sipërfaqet ujore	75
Tab. 33. Shfrytëzimi i tokës te zona e mbrojtur ujore	75
Tab. 34. Shfrytëzimet e tokës te zona arkeologjik-e historike	80
Tab. 35. Trashëgimia arkeologjike	81
Tab. 36. Tashëgimia arkitekturore dhe e luajtshme	82
Tab. 37 Normat për kategorinë e rrugës rajonale	92
Tab. 38 Normat për kategorinë e rrugëve lokale.....	93
Tab. 39. Sipërfaqja e rrjetit të komunikacionit- transportit në komunën e Istogut	94
Tab. 40 Kategorizimi i rrugëve	94
Tab. 41. Profilet rrugore në raport me gjendjen ekzistuese, planet dhe udhëzimin administrative ...	95
Tab. 42. Rrjeti i rrugorë- gjatësia dhe sipërfaqja	97
Tab. 43 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbime të administratës publike, mbrojtës dhe sigursë sociale	109
Tab. 44 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për institucionet arsimore	111
Tab. 45 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për institucionet shëndetësore	113
Tab. 46. Shfrytëzimet e tokës për shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreuese	114
Tab. 47 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat kulturore	115
Tab. 48. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për infrastrukturën sportive	117
Tab. 49 Normat e përdorimit	122
Tab. 50 Norma e ujerave të përdorura L/dite.....	122
Tab. 51 Norma mesatare ditore.....	123
Tab. 52 Vlerat kufizuese të efluentit urban që shkarkohet nga impianti	124
Tab. 53 Trafostacionet distributive në vendbanimet e komunës së Istogut	136

Lista e hartave

Harta 9 Klasifikimi i tokës bujqësore.....	60
Harta 10 Shfrytëzimi i tokës bujqësore.....	60
Harta 12 Zonat e veçanta të mbrojtura	71
Harta 11 Zonat e veçanta.....	73
Harta 13 Zona e ndikuar nga vërshimet.....	79
Harta 14 Zonat mbishtresore.....	89
Harta 2 Rrjeti rrugor.....	97
Harta 1 Zona e shërbimeve.....	117
Harta 3 Rrjeti i ujësjellësit.....	120
Harta 4 Rrjeti i kanalizimit fekal.....	121
Harta 5 Harta e drenazhimit	128
Harta 6 Rrjeti elektroenergjetik.....	139
Harta 7 Rrjeti i telekomunikacionit.....	141
Harta 8 Deponimi dhe menaxhimi i mbeturianave	143
Harta 15 Planet rregullore te hollesishme te parashikuara.....	146

SHKURTESAT

MMMPHI- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MEA- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish MMPH-ja)

PZHK- Plani Zhvillimor Komunal

HZK- Harta Zonale e Komunës

PRrU- Plani Rregullues Urban

PRrH- Plani Rregullues të Hollësishëm

UA- Udhëzimi Administrativ

NTPH- Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

VR- Vija Rregulluese

VN- Vija Ndërtimore

VNN- Vija Ndërtimore Ndihmëse

ISHPKZh- Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim

ISN – Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar

SGJAP – Sipërfaqja Gjelbëruese e Absorbuese e Parcelës

SGJP – Sipërfaqja Gjelbëruese e Parcelës

SAP- Sipërfaqja Absorbuese e Parcelës

VP- Vendparkingje

1.0 HYRJE

1.1 Baza ligjore për hartimin e Hartës Zonale të Komunës

Baza ligjore për hartimin e Hartës Zonale të Komunës është:

- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
- Ligji Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore
- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
- Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojes të Mjedisit
- Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e natyrës
- Ligji Nr.03/L-230 për Vlerësim Strategjik Mjedisor
- Ligji Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore
- Ligji Nr.04/L- 110 për Ndërtim

Propozim vendimi i Kuvendit Komunal dhe udhëzimet administrative si:

- Udhëzimi Administrativ Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal
- Udhëzimi Administrativ Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës si dhe
- Udhëzimi Administrativ Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor.

Dokumente të planifikimit siç janë:

- Plani Hapësinor i Kosovës
- Plani Zhvillimor i Komunës së Istogut
- Plani për Zonat e Veçanta
- Raportet zhvillimore strategjike sektoriale
- Zonat e veçanta të Mbrojtura

1.2 Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës

Ekipet e përfshira në hartimi e Hartës Zonale të Komunës:

Komuna e Istogut:

1	Haki Rugovaj	kryetar	Komuna e Istogut
2	Agim Ademaj	nënkryetar	Komuna e Istogut
3	Jashar Blakaj	drejtor	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis

4	Rexhep Blakaj	udhëheqes sektori	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
5	Elfete Blakaj	përgjegjëse/mjedis	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
6	Rrustem Gashi	arkitekt	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
7	Besart Dreshaj	Ish drejtor	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
8	Isa Hoxhaj	zyrtar për efizienzë	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
9	Hazbi Bajra	drejtor	Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi
10	Lulzim Blakaj	drejtor	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
11	Hajrush Shoshi	drejtor	Drejtoria e Arsimit
12	Enver Rugovaj	drejtor	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
13	Edona Bujupi Loxha	drejtoreshë	Drejtoria e Administratës
14	Hysni Maxharraj	drejtor	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
15	Mujë Osmanaj	drejtor	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenjë Sociale
16	Demë Çeta	drejtor	Drejtoria e Inspektionit
17	Lulzim Shoshi	drejtor	Drejtoria e Bujqësisë
18	Fjollë Berisha		Zyra e kryetarit
19	Dukagjin Hoxha	Zyrtar për adresa	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
20	Agim Haxhiu	drejtor	Shtëpia e Kulturës

Takimet kyçe gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Istogut. Qëllimi, arsyeshmeria, rezultat e të cilave janë të përmbledhur anë dokumentin “Procesi” (shih. Shtojcën “Procesi”).

	Data	Takimi	Vendi	Grupet
1	08.11.2019	Takim informues	Kuvendi Komunal , Istog	Drejtorë dhe zyrtarë të lartë të fushave përkatëse
2	14.11.2019	Takim me qytetarë	Shf. " Trepça", Banjë	Banorët e Banjës , Bajincës , Carallukës , Dubovës Së Vogël, Kashicës , Lubovës dhe Orobërdës
3	14.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Hysni Zajmi", Vrellë	Banorët e Vrellës , Kaliqanit , Prigodës dhe Studenicës

4	19.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Ismail Qemajli", Saradran	Banorët e Dobrushës , Llukavcit Të Begut , Prekallës , Saradranit dhe Turbuhovcit
5	19.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Bajram Curri", Dubravë	Banorët e Dubravës , Dragolevcit , Bellopojës , Synejit dhe Mojstirit
6	21.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Martin Camaj", Gurakocë	Banorët e Gurakocit , Kovragës , Llukavcit Të Thatë, Tomocit dhe Veriqit
7	26.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Ndre Mjeda", Rakosh	Banorët e Rakoshit , Belicës , Kërninës, Zhakovës dhe Shushicës
8	26.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Avni Rrustemi", Zallq	Banorët e Zallqit dhe Drejës
9	27.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Radosh Toshqi", Osojanë	Banorët e Osojanit, Polanit, Shalinovicës, Koshit dhe Tuçepit
10	27.11.2019	Takim me qytetarë	Shf " Tre Dëshmorët", Uçë	Banorët eCerkolezit , Uçës dhe Syrigonës
11	03.12.2019	Takim me qytetarë	Kuvendi Komunal , Istog	Banorët e Istogut , Cërrcës, Llugës, Lubozhdës dhe Muzhevinës
12	15.06.2020	Takim konsultativ	IPH- MMPHI, Prishtinë	Instituti I Planifikimit Hapësinor
13	16.06.2020	Takim punues	Kuvendi Komunal , Istog	Drejtorë dhe zyrtarë të lartë të fushave përkatëse
14	11.09.2020	Takim informues-sfidat	Kuvendi Komunal , Istog	Kryetari I Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit
15	30.09.2020	Takim konsultativ	Kuvendi Komunal , Istog	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Drejtoria e Urbanizmit
16	18.11.20	ëorkshop	Kuvendi Komunal , Istog	Zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastrit
17	03.03.2021	Takim	Kuvendi Komunal , Istog	Zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastrit
18	10.03.2021	Takim këshillues	MMPHI, Prishtinë	MMPHI
19	17.03.2021	Punëtori	Shtëpia e Kulturës, Istog	Biznese
20	30.03.2021	Punëtori	Kuvendi Komunal , Istog	Shoqëri civile (pa pjesëmarrje)

Tab. 1 Lista e takimeve

1.3 Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës

Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përcakton hollësisht shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare (Ligji 04/L-174)

Harta Zonale është mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal dhe për shtrirjen hapësinore dhe gjeografike të tyre. (UA 24/2015)

Përcaktimi i hollësishëm i kufijve të zonave dhe kushteve zhvillimore për cdo zonë

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar hapësinor

1.4 Kërkesat që rrjedhin nga planet zhvillimore sektoriale të Planit Zhvillimor Komunal

Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës- kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve dhe kontrolli i zhvillimit në zonat urbane dhe rurale, ngritja e kualitetit të hapësirave të gjelbra në qytet, mbrojtja e llojllojshmërisë së peizazheve natyrore, shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve të ujit, mbrojtja dhe zvogëlimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis, masat për parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore (vërshimet, erërat, zjarret, termetet, etj)

Infrastruktura sociale dhe publike - sigurimi i hapësirave përcjellëse shkollore, sigurimi i hapësirave shëndetësore në të gjitha vendbanimet në bazë të funksionit dhe nivelit të tyre, sigurimi i hapësirave për qendra komunitare në qendrat lokale sigurimi i hapësirave për kulturë nëpër vendbanime, sipas funksionit dhe nivelit të tyre sigurimi i hapësirave për sport dhe rekreacion

Infrastruktura teknike - përparimi i sistemeve aktuale të furnizimit me ujë në tërë territorin e komunës,

ndërtimi i sistemit të ndarë të kanalizimit fekal dhe atmosferik për tërë komunën, përfshirë impiantin qendrorë për trajtim, kalimi nga rrjeti i furnizimit me energji të tensionit 10 kV në rrjetin me tension 20 kV, zgjerimi i rrjetit dhe integrimi i telekomunikimeve në Istog dhe zonat rurale, zhvillimi i një sistemi efikas të transportit, të sigurt dhe të përshtatshëm, me qasje të lehtë duke e mbrojtur natyrën dhe peizazhin

Bujqësia - mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore, rikonstruktimi i sistemit të ujitjes, riaktivizimi i tokës ekzistuese bujqësore, krijimi i një qendre të aftësimi/shkollë e mesme profesionale për profesionet specifike (bujqësi, pylltari, peshkatari, bletari), ndërtimi i objekteve për prodhimin e produkteve bujqësore specifike (peshku, molla, mjalti, etj.), zhvillimi i marketingut aktiv për prodhime rajonale

Turizmi - Krijimi i një bordi lokal për turizëm, krijimi i hapësirave adekuate për turizëm, ndërtimi i njësive të akomodimit dhe pikave informuese turistike, rindërtimi i kapaciteteve ekzistuese turistike, revitalizimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve turistike malore, krijimi i një sinergjie në mes të bujqësisë, turizmit dhe ndërmarrjeve, zhvillimi dhe zbatimi i veprimeve për përmirësimin dhe ruajtjen e peizazheve natyrore

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - ndërtimi i agjencisë lokale për hulumtim dhe menaxhim të lokacioneve për biznes, zhvillimi i zonave të përshtatshme për biznes dhe atyre industriale me furnizim vetanak me energji dhe në lidhje me rrjetin kryesor rrugor, trajnime për zeje dhe profesione specifike

1.5 Ndërlidhjet me Planet Rregulluese në fuqi

Komuna e Istogut ka hartuar tetë plane hapësinore- zhvillimore dhe rregulluese të cilat janë në fuqi. Të gjitha planet përfshijnë territorin e zonës urbane respektivisht kufirin e vendbanimit. Këto plane përfshijnë: Istogun (PZHU & PRRU), Gurakocin (PRRU), Vrellën (PZHU), Banjën (PZHU & PRRU), Rakoshin (PZHU) si dhe Saradranin (PZHU). Sipas vlerësimeve këto plane janë zbatuar pjesërisht, respektivisht me shumë në Istog si qendër kryesore ndërsa më pak te Rakoshi dhe Saradrani. Në hartën zonale janë marrë parasysh këto plane por gjithashtu edhe kërkesat aktuale lidhur me destinim apo katësi, të gjitha brenda normave dhe standardeve të përcaktuara me UA 08/2017.

1.6 Ndryshimet në tematikë ose në strategjinë sektoriale lokale që nga miratimi i Planit Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal 2019-2027 përfshinë analizën e realizimeve nga plani zhvillimor paraprak përmes krahasimit të kategorive kryesore të shfrytëzimit të tokës si dhe rrjetit rrugor. Pajisja e komunës së Istogut me Plane Zhvillimore Urbane të hartuara jo vetëm për Istogun si qendër kryesore por edhe për subqendrat (Gurakoc, Vrellë, Banjë, Rakosh si dhe për vendbanimin e Saradranit) të cilat më tutje pasojnë me Plane Rregulluese Urbane po për këto subqendra ka bërë që zhvillimi në përgjithësi përkon me planet në fuqi. Zhvillimet në vendbanimet rurale kanë qenë realtivisht të vogla sa përket shtrirjes së funksionit të banimit. Ndryshime më të theksuara mund të vëhëren në qytet si rrjedhojë I kërkesës për banim me shumënjësi (kryesisht përgjatë arterieve kryesore të qytetit) si dhe të shërbimeve tregtare-hoteliere kryesisht të vendosura brenda resurave natyrore (rrëzë dhe bjeshkë të qytetit dhe pranë burimit të ujit). Gjatë hartimit të hartës zonale është tentuar që t'i jepet një trajtim adekuat minimizimit të ndërhyrjeve mjedisore.

Ndryshimet në kontekst të kufinjëve të vendbanimeve- baza kadastrale e përditësuar, incizimet satelitore të përditësuar, gjendja aktuale në terren dhe verifikimi I tyre gjatë procesit të involvimit të banorëve në hartimin e hartës zonale, janë përdorur si parime për përcaktimin e saktë të kufinjëve. Definimi apo përcaktimi më I saktë I kufinjëve mbi këtë parim mund të konsiderohet ndryshim nga ajo që është paraparë në PZHK (e shpjeguar në kap.5.0).

Ndryshimet si rezultat I masave mbrojtëse- lidhen kryesisht me zonën e minierave sipërfaqësore të cilat kanë rrjedhur si rezultat I kufizimeve që përcaktohet nga buffer zonat duke I shndërruar destinimin aktual në tokë pyjore/ bujqësore respektivisht në tokë për rehabilitim (e shpjeguar më detalisht në nënkapitullin 5.8). Ndryshimet si rezultat I masave mbrojtëse janë bërë edhe në afërsi tek zonat e veçanta të mbrojtura sic është rasti tek zona

urbane- zona në afërsi të Manastirit të Gorioçit (e shpjeguar më detalisht në nënkapitullin 5.3.3)

2.0 ARSYETIMI

Bazuar në qëllimin e hartës zonale si një document multisektorial e cila nënkupton përcaktimin e kufinjëve të zonave dhe kushteve zhvillimore ajo në të njëjtën kohë ka pasur për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar hapësinor. Qëndrueshmëria është ndërtuar bazuar parime të cilat kanë qenë të përcaktuara nga shumë faktorë:

- Kërkesat të cilat kanë rrjedhur nga Plani Zhvillimor Komunal I Istogut si dhe planet sektoriale duke u fokusuar në :
 - Mjedisin dhe shfrytëzimin të tokës
 - Infrastrukturën sociale dhe publike
 - Infrastrukturën teknike
 - Bujqësinë
 - Turizmin
 - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
- Ndërlidhjet me planet në fuqi- Komuna e Istogut ka hartuar tetë plane hapësinore-zhvillimore dhe rregulluese të cilat janë në fuqi. Në hartën zonale janë analizuar këto plane si dhe janë harmonizuar me gjendjen aktuale si dhe me kërkesat e banorëve gjithëmonë brenda normave dhe standareve të përcaktuara me rregullore dhe ligje në fuqi.
- Parimet lidhur me rrjetin e qëndrueshëm rrugor të cilat janë bazuar në:
 - Profilet ekzistuese të rrugëve
 - Planet rregulluese urbane (Istog, Gurakoc, Vrellë, Banjë)
 - Planet zhvillimore Urbane (Rakosh, Saradran)
 - Normave teknike dhe standareve sipas UA 08/2017
 - Tipologjisë së vendbanimeve
 - Ruajtjes së tokës bujqësore, dhe
 - Kriteri ku çdo parcelë e ndërtuar të këtë qasje ne rrjetin rrugor.
- Gjendja aktuale në terren- në raste të caktuara janë bërë analiza më të hollësishme për përcaktimin e destinimit të parcelës përmes skemave në nivel të dizajnit urban.
- Takimet me banorë- krijimi I strategjisë për pjesëmarrje më të kënaqshme dhe involvim përmes mjeteve dhe metodave më të kapshme duke siguruar takime produktive e në vecanti identifikim dhe zgjidhje të problemeve në nivel të parcelës.
- Metodologjia e punës- “koncepti I përmbysur”, hulumtimi dhe zhvillimi I fazës ë propozimit duke filluar nga destinimi I njësisë më të vogël hapësinore “parcela” si përcaktuese e nënklasës dhe klasës për të ardhur deri tek identifikimi I të gjitha klaseve dhe nënklaseve në nivel të komunës. Pastaj I tërë procesi është pasqyruar duke e

luajtur rolin e verifikimit të funksioneve të tyre si dhe harmonizimin me propozimet nga PZHK.

2.1 Aspekte të rëndësishme për trajtim para përcaktimit të zonave dhe kushteve të përgjithshme zhvillimore

Koncepti i zhvillimit hapësinorë i paraparë me PZHK ka qenë bazë për përcaktimin e shfrytëzimeve të tokës, zonimeve si dhe përcaktimit të kushteve tjera zhvillimore. Shfrytëzimet e tokës janë përcaktuar në bazë të tri tërësive hapësinore të propozuara me PZHK:

- Tërësia 1-Bjeshka (Natyra dhe Malet)
- Tërësia 2- Rrëza (Uji dhe Peshku)
- Tërësia 3- Rrafshi (Jeta dhe Kopshti)

Zona e ultë “Rrafshi”- është e pasur me tokë bujqësore të kualitetit të lartë, zona “Rrëzë”- me tokë kualitative dhe dy burimet kryesore të ujit dhe “Bjeshka”- e pasur me pyje, kullosa dhe motive peizazhi. Këto karakteristika kanë rezultuar me tri elemente qenësore të zhvillimit hapësinor:

- Diferencimi i zonave të komunës në bazë të veçorive gjeomorfologjike dhe mjedisore si dhe resurseve natyrore të cilat i posedojnë.
- Rrjeti hierarkik i vendbanimeve bazuar në funksionin e tyre për ofrimin e shërbimeve administrative, ekonomike dhe shoqërore për banorët e qendrës dhe vendbanimeve që gravitojnë përreth.
- Rrjeti hierarkik i rrugëve bazuar në lidhjet e trafikut në mes të vendbanimeve brenda territorit të komunës së Istogut dhe me vendbanimet në komunat fqinje.

Nëse konceptin e përkthejmë në kontekst të ‘nyjeve’, korridoreve, dendësimit, mbajtjes nën kontrollë dhe rritjes atëherë komuna e Istogut do të shikohet si një entitet i përbërë prej tri tërësive kryesore të cilat lidhen mes veti përmes ‘nyjeve’- qendrave kryesore në të cilat dendësimi bëhet me zhvillime të caktuara karakteristike për qendrën dhe komunën në përgjithësi dhe “korridoreve” të cilat promovojnë konceptin e ‘mbajtjes nën kontrollë’ të tokës bujqësore dhe pyjore dhe në të njëjtën kohë inkurajon zhvillimin ekonomik (turizmi dhe bujqësia).

Nyjet si hapësira të cilat promovojnë intesitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve në komunën e Istogut mund të ndahen në nyjet të cilat lidhen me mjedisin e ndërtuar dhe të pandërtuar. Këtu bëjnë pjesë qendat kryesore lokale si : Istogu, Vrella, Gurakoci, Banja, Rakoshi dhe ‘nyjet’ e zonës së bjeshkes dhe rrafshit të cilat paraqesin komponenta kryesore të turizmit dhe bujqësisë.

Korridoret në kontekst të konceptit të propozuar paraqesin lidhjet në mes të nyjeve të cilat kryesisht kanë për qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet por në të njëjtën kohë inkurajojnë një intensitet të rritur të zhvillimit të cilat lidhet me bujqësinë dhe turizmin në pjesën e bjeshtë.

Mbajtja nën kontrollë lidhet me konceptin e densifikimit e cila integrimin hapësirnor e bën përmes interpolimit brenda kufinjëve ekzistues të hapësirës së zhvilluar me një zgjerim minimal për të bërë mbrojtjen e tokës e tokës bujqësore dhe pyjore.

Për të siguruar shfrytëzim efikas të tokës zonat e rritjes janë tentuar të parashihen brenda kufinjëve ekzistues apo me një zgjerim me ndikim minimal në hapësirën e lirë.

Për çështje praktike këto tërësi hapësirnoe janë ndarë edhe në disa nëntërësi të cilat ndihmojnë një krijimin e një ideje më të qartë të shfrytëzimeve të lejuara nëpër tërësitë përkatëse e sidomos në kontekst të tokës pyjore dhe bujqësore.




Fig. 1 Tërësitë hapësinore

2.2 Zonat

Zonimi I komunës është bërë duke u bazuar në shfrytëzimin e tokës, kushtet zhvillimore dhe ndërtimore, te cilat marrin në konsideratë aspektin ligjor, mjedisor, ekonomik, financiar dhe social.

Me qëllim të përshtatjes me karakteristikat e hapësirës së caktuar së pari është bërë zonimi parësor e më pastaj janë përcaktuar nënkategoritë e saj.

Për shembull për zonën e banimit (ZB) janë propozuar 4 nënzona përfshirë edhe banimin me funksione në pajtueshmëri (ZB mix): zonë e banimit të ultë ZBU, zonë e banimit të mesëm ZBm, zonë e banimit të lartë ZBl, zonë e banimit rural ZBR.

Zona	Nën kategoritë	Nën-Zona	
ZB	Zonë banimi	ZBU/ ZBU mix	Banim I ultë/ Banim I ultë I përzier
		ZBm/ ZBm mix	Banim I mesëm/ Banim I mesëm I përzier
		ZBl/ ZBl mix	Banim I lartë/ Banim I lartë I përzier
		ZBR	Banim rural

Tab. 2 Shembull i propozimit të nënzona- Zona e Banimit

2.3 Zonat mbishtresore

Në territorin e komunës së Istogut ekzistojnë ekzistojnë 6 kategori apo lloje të zonave të cilat kërkojnë kushte zhvillimore më strikte apo masa shtesë. Këtu bëjnë pjesë:

- Zonë e veçantë ZV, ku si nënzona janë : pasuritë nëntokësore ZV-pn që përfshijnë rezervat e thengjillit ne Tuçep dhe shtratimin e oniks, oniks-travertini dhe travertine në Banjë; trafostacioni “Peja 3” ZV-t dhe qendra korrektuese ZV-qk në nivel shtetëror në Dubravë.
- Zonë e mbrojtur arkeologjike-historike është ndarë në disa nënzona bazura në karakteristikat themelore, si: lokalitet arkeologjik, vendbanim parahistorik, tuma ilire, gërmadha të kishës, kishë, xhami, kullë, mulli shkollë, truall, truall sharre dhe urë.
- Zonat e vecanta të mbrojtura ZVM në të cilën bëjnë pjesë: kompleksi I objekteve me rëndësi të trashëgimisë kulturore: Manastiri I Gorioçit ZVM-m në Istog, Kisha e Shën Nikollës ZVM-k në Gurakoc dhe lokacioni arkeologjik në Studenicë duke e përfshirë Manastirin e Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosnos ZVM-a.
- Zona e mbrojtur ujore ZMU, në të cilën bëjnë pjesë: burim I ujit në Istog dhe Vrellë ZMU-bu, dhe uji termal në Banjë ZMU-ut.
- Zona e ndikuar nga vërshimet ZnV në të cilën bëjnë pjesë shtretërit e lumenjëve kryesor ,Drini I Bardhë, lumi I Istogut dhe Vrellës si dhe vija fundore e bjeshkës e cila është nën ndikim të erozionit të shkaktuar nga rrjedhat e bjeshkëve.
- Sipërfaqe e mbrojtur SM, bëjnë pjesë: Parku Kombëtar “Bjeshket e Nemuna” SM-pk, Park –pylli SM-pp në Banjë, shpella e Hoxhës në Vrellë SM-sh dhe kompleksi I trungjeve SM-kt në Synejë.

3.0 KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSME

3.1 Shfrytëzimet e tokës

Klasifikimi shfrytëzimit të tokës është bërë sipas nomenklaturës së Sistemit Hierarkik të Klasifikimit të Shfrytëzimit të Tokës (HILUCS) të përcaktuar në UA, Nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit. Të gjitha llojet e aktiviteteve janë përcaktuar bazuar në kategoritë e caktuara të shfrytëzimit të tokës.

Shfrytëzimet të lejuara- përcaktojnë funksione dhe aktivitete që lejohen në zonën e caktuar.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore- përcaktojnë funksione dhe aktivitete që janë dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë dhe mund të gjenden në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin.

Shfrytëzimet të lejuara të vecanta- përcaktojnë funksione dhe aktivitete që janë të lejuara për një periudhë specifike kohore pas së cilës largohen plotësisht.

Shfrytëzimet të përkohshme dhe të ndaluara në zonë përcaktojnë funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe janë të deklaruar në mënyrë specifike sit ë pa lejuara.

3.2 Qasja në parcelen kadastrale

- Qasja në parcel kadastrale duhet të sigurohet para çdo fillim zhvillim apo ndërtimi të saj
- Parcela kadastrale duhet të ketë mundësi hyrjeje të drejtëpërdrejtë nga më së paku një rrugëje publike apo private.
- Rrugët t'i plotësojnë kushtet për qasjen e automjeteve private si dhe makinerive tjera apo të zjarrëfikësve
- Dimensioi i pjesës qasëse të parcelës duhet të jetë në përputhje me destinimin e parcelës.




Fig. 2 Distanca në mes të ndërtesave

3.3 Vija ndërtimore

Vija e ndërtimit është përcaktuar në raport me kategorinë e rrugëve duke ruajtur minimumet. Distancat minimale të objekteve nga vija rregulluese për rrugët e caktuara është:

- Për rrugët rajonale (ZTR) jo më pak se 10m¹, përveç kur rruga rajonale kalon brenda vendbanimit në zonë të dendur mund të jetë 7.5 m.
- Për rrugët tranzite ZTT jo më pak se 7.5m
- Për rrugët përmbledhëse/ shprëndarëse (ZTP/SH) minimum 5.0m për banim të ultë dhe minimum 7.5 m' për ndërtesa që e kalojnë lartësinë prej 10m.
- Për rrugët servitore (ZTVS) dhe banesore (ZTVB) minimum 5.0 m
- Për rrugët qasëse (ZTVQ) minimum 5.0m si dhe minimum 3.0m në rastet kur parcelat kanë forma të ndërlikuara dhe vetëm për rastet e banimit të ultë

Vija ndërtimore (m')	Kategoria e rrugës	Kodi	Vija ndërtimore	
	Rrugë rajonale	ZTR	7.5m *-10.0m	*7.5m' për ZTR brenda vendbanimeve
	Rrugë tranzite	ZTT	7.5m	
	Rrugë përmbledhëse/ shprëndarëse	ZTP/SH	5.0m*-7.5m	*5.0m për ndërtimes të banimit të ultë
	Rrugë servitore	ZTVS	5.0 m	
	Rrugë banesore	ZTVB	5.0 m	*3.0m' për parcelat me forma të ndërlikuara vetëm për banim të ultë
	Rrugë qasëse me dy kahje	ZTVQ	3.0m*-5.0m	

Tab. 3 Vija ndërtimore

3.4 Qasja në infrastrukturën teknike

- Në zonat e reja për destinuar për ndërtim duhet të ofrohet infrastruktura dhe shërbimet si: energjia elektrike, kanalizimi dhe ujësjellësi
- Infrastruktura teknike duhet të zhvillohet gradualisht bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës
- Nëse një parcelë kadastrale ka mundësi të lidhet me shërbimet publike, si ujësjellës dhe kanalizim, në atë parcelë nuk lejohet të ndërtohet asnjë ndërtim apo strukturë, nëse e njëjta nuk lidhet me shërbimin publik në dispozicion
- Përzgjedhja e lokacionit për ndërtesat ose pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza duhet të bëhet në përputhje me UA mbi NTPH
- Përzgjedhja e lokacionit për vendosjen e linjave mbitokësore dhe nëntokësore të energjisë elektrike duhet të bëhen në përputhje me UA mbi NTPH
- Përcaktimi i vëllimit dhe kapacitetit të deponive si dhe kushtet për përcaktimin e lokacionit për deponi/stacion transferi duhet të bëhet në përputhje me UA mbi NTPH
- Të gjitha zhvillimet apo ndërtimet duhet të lidhen me rrjetet infrastrukturore të ujit të pijshëm, kanalizimit, ujërave atmosferik, energjisë elektrike, rrjetit të teknologjisë informative, si dhe rrjetit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave;

¹ Ligji Nr.2003/11, neni 26, pika 26.2, fq.7

- Rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe infrastruktura shoqëruese me to duhet të ndërtohen dhe shfrytëzohen në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike.

3.5 Rregullat për parkim dhe shkarkim

Të gjitha vendparkingjet, qofshin ato: rrugore, jashtë-rrugore publike, jashtë rrugore-private ose jashtë-rrugore private për banorë, duhet të planifikohen dhe dimensionohen sipas UA 08/2017 si në vijim:

- Parkimi i automjeteve për nevoja të ndërtesës së banimit duhet të projektohet me dokumente të planifikimit hapësinor si hapësirë nëntokësore, mbetokësore i hapur dhe i mbyllur, në kuadër të objektit garazhues apo të kombinuar
- Numri i vend parkimit të automejeteve për njësitë e banimit duhet të jetë minimum 1 VP/ banësë
- Numri i vend parkimit të automejeteve për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, duhet të jetë minimum 1 VP/30m² neto sipërfaqe afariste
- Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës duhet të jetë jo më shumë se 100 m
- Dimensionet minimale për haëspritat e parkimit në varg të automjeteve motorike standard duhet të jenë në përputhje me dimensione e paraprara në UA 08/2017
- Vendparkingjet për qasje të personave me kërkesa të veçanta duhet të jenë së paku 5% e numrit të gjithëmbarshtëm të parkigjeve. Vendparkimi duhet të jetë afër hyrje në ndërtesë dhe t'i plotësojë kushtet lidhur me dimensionet të parapara në UA 08/2017.
- Gjërësia e shtegut të këmbësorëve duhet të jetë së paku 1.8 m (në raste kur nuk është e mundur mund të jetë 1.5 m), në mënyrë që të mundësohet lëvizja pa pangesa e personave me kërkesa të veçanta; gjërësia e kalimeve mes pengesave duhet të jetë min 0.9 m.
- Pjerrësia e rampave për personat me kërkesa të veçanta nuk duhet të jetë më e madhe se 5 % (në rastet ku nuk është e mundur ajo mund të shkojë max 8%)
- Dimensionet e vendparkimit për bicikletë duhet të jenë 1.20 m² bicikletë
- Ndalet për parkim të transportit publik duhet të jenë me gjerësi 2.0 m
- Rampat rrethore të garazhave të parkimit duhet të kenë pjerrësi maksimale: 12% për rampa rrethore të hapura, 10 % rampa rrethore të mbyllura, 12% rampa rrethore të hapura (>40 automjete). Gjërësia minimale përfshirë edhe shtegun për këmbësorë është: 4.70 m për rampë njëdrejtimëshe, 8.10 m për rampë dydrejtimëshe.
- Pjerrësia e rampave për parkim është 3%-5 %.

Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, se paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjesë të pa ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për shfrytëzim publik
	Ndërtesat e banimit të ulët/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjesë të pa-ndërtuara, domosdoshmërisht të planifikohet edhe 1 VP/ 1 ndërtesë të banimit të
	Ndërtesat e banimit të ulët- vilat (deri në 4 njësi maksimal)	3 VP/ njësi banimi	-
Hoteleria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP/ 100 m ²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP/ 100 m ² të hapësirës	-
	Ndërtesa/ hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m ² të hapësirës	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m ²	-
Biznes dhe publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqe me të vogla se 100 m ² , të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative	2 VP/ 100 m ²	
Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m ²	-
Kultura dhe arsimi	Ndërtesat e kopshteve/ çerdheve të fëmijëve	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e shkollave të mesm	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat religjioze- xhamitë, kishat, etj	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m ²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP/ 100 m ²	Numri i VP duhet të jetë jo me i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m ²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
Terminalet e udhëtareve	Ndërtesat e terminaleve të autobusëve	-	Për ndërtesat e terminaleve duhet të hartohet projekti i teknik i trafikut, me kalkulimin e numrit të VP, në veçanti për: Vendqëndrimet (ngarkim/ shkarkim); parkim afat-shkurtë; parkim afat-gjatë

Tab. 4 Numri i vend-parkimeve për automjete në varësish nga përmbajtja

3.6 Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës

Zhvillimi i peizazhit të komunës është një ndër kriteret kryesore marrë parë bazë pasurinë e komunës me llojllojshëmri të tyre si dhe marrë parasyh që ilstogu është pjesë e projekteve në nivel ndërkombëtar si European Green Belt.

- Mbrojtja e llojllojshërisë dhe biodiversitetit
- Shfrytëzimi racional i burimeve natyrore dhe në bazë të rregulloreve të përcaktuara për kategoritë e caktuara natyrore
- Vlerësimi, inventarizimi dhe sensibilizimi i banorëve për vlerat natyrore
- Respektimi maksimal i resurseve natyrore gjatë implementimit të infrastrukturës teknike
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i hapësirave të caktuara përmes simulimeve të ndryshme të sektorit privat
- Ruajtja maksimale e peizazhit bujqësor e sidomos në zonën e rrafshit dhe rrëzës
- Ruajtja maksimale e tërësive të kullosave në peizazhin e bjeshkës
- Krijimi i rrjetit të gjelbër përmes parqeve publike, parqeve të lagjes, brezave të gjelbër rrugor dhe brezave të gjelbër përgjatë rrjedhave ujore.
- Në nivel të parcelës ndërtimore:
 - të bëhet ruajtja sa më shumë e drunjëve ekzistues
 - të mbjellet së paku një dru me kurorë të gjërë për çdo 250m² të sipërfaqes së pandërtuar.
 - të krijohet sistem hierarkik i gjelbrimit duke specifikuar rolin e gjelbrimit: izolues, interpolues, dekorues etj.
 - gjatë realizimit të çdo ndërtese të re të mbillen drunjë izolues në mes të ndërtesës dhe rrugës.

Mbrojtja dhe zhvillimi i peizazhit është i përcaktuar edhe në rregullat e përcaktuara tek zona pyjore dhe bujqësore.

3.7 Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial

- Të sigurohet djellosja maksimale duke respektuar anët e horizontit në raport me haëpsirat specifike për kategori të caktuar të ndërtesave
- Të sigurohet djellosja maksimale duke u bazuar në rregullin e rrafshit prej 45' duke e kontrolluar hijëzimin e strukturave dhe pronave fqinje
- Ndërhyrjet e lejuara në rrafshin e ndriçimit natyror mund të bëhen nga strukturat si: oxhaqet, boshtet e ventilimit, boshtet e ashensorëve, boshtet e shkallëve dhe rezervuarëve të ujit në çati me kusht që dimensionimi maksimal nuk e tejkalon 1 m² dhe

me kusht që distance minimale mes secilës strukturë të jetë 20m dhe që nuk i tejkalojnë muret e jashtme të ndërtesës ku janë vendosur

- Të sigurohet distanca në mes të ndërtesave në mënyrë që në ditën me më së paku ndriçim direkt diellor (21 dhjetor) të kenë së paku 2 orë djellosje të drejtpërdrejtë (në mes të orës 10.00-14.00).




Fig. 3. Rregulli i rrafshit 45 shkallë




Fig. 4 Rregulli i rrafshit 45 shkallë i përcaktuar në një lartësi specifike dhe rasti në pjerrësi.

3.8 Kërkesat për zvogëlim të zhurmës

Parandalimi, zvogëlimi apo shmangja e ekspozimit të zhurmës është e rregulluar përmes Ligjit për mbrojtjen nga zhurma Nr.02/L-102. Ky ligj ofron bazën e krijimit të masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga:

- Burimet e mëdha si psh rrjeti rrugor
- Pajisjet e jashtme dhe industriale
- Burime tjera të ndotjes nga zhurma.

Mbrojtja nga zhurma aplikohet duke u bazuar në tri faza kohore: ditën (07.00-19.00), në mbrëmje (19.00-22.00) dhe natën (22.00-07.00). Kushtet për zvogëlim të zhurmës sipas Ligjit Nr. 02/L-102, neni 16², përfshijnë:

² Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr.02/L-102, faqe 7

- Ndalimin e kryerjes së punëve, vepritarive dhe aktiviteteve tjera, në mënyrë që me zhurmë pengohet qetësia dhe pushimi i njerëzve, në vende të hapura dhe të mbyllura nga ora 22.00-07.00
- Në vendbanime lejohet dëgjimi i zërimit të zileve dhe pajisjeve elektroakustike nga ora 07.00-22.00, me përjashtim të zërimit në kohën e riteve fetare si dhe ditët e festive.

Për zvogëlimin e zhurmës duhet gjithashtu të:

- Planifikohet gjelbërim izolues përgjatë rrugëve. Në rrugë të vendosen rende të drunjëve në të dy anët e saj. Në rrugët e kategorisë më të lartë (rrugës rajonale dhe kryesore urbane) të shikohet mundësia e përdorimit të rendeve të dyfishta me shmangje.
- Punohet harta strategjike e zhurmës apo planet të veprimit
- Vlerësohet niveli i zhurmës dhe masat e mbrojtjes nga zhurma dhe të përfshihet në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Vlerat kufitare të burimit të zhurmës (dB)	Trafiku rrugor	
	Ditën	Natën
Zona urbane	64	54
Zona e përzier	64	54
Zona e banimit në vendbanime të vogla	59	49
Zona e shërbimeve publike dhe sociale	57	47

Tab. 5 Vlerat kufitare të burimit të zhurmës nga trafiku

3.9 Formësimi estetik arkitektonik

Me qëllim të sigurimit të harmonisë dhe relacionit të shëndoshë në mes të ndërtesave dhe mjedisit ku ndërtohet duhet respektuar edhe rregullat e mëposhtme:

- Dizajni i ndërtesës duhet t'i përshtatet kontekstit të vendit dhe funksionit të saj
- Inkurajohet përdorimi i materialve natyre (tullë, gurë, dru apo të ngjajshme)
- Kulmi mund të jetë i rrafshtë apo pjerrtë
- Nuk lejohet përdorimi i kulmeve mansard
- Nuk lejohet përdorimi i ngjyrave bazë bazë apo intensive
- Inkurajohet përdorimi i ngjyrave pastele sipas paletës së dhënë ose të ngjajshme
- Minimizimi i përdorimit të ngjyrave të cilat e tërheqin vëmendjen
- Nuk lejohet përdorimi i dritave pasqyre dhe me ngjyrë
- Inkurajohet arkitektura e theksuar, e pastër pa shumë detaje
- Materialet dhe dizajni duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës
- Sygjerohet shmangja e fasadave të tej-dizajnuara
- Ndalohet përdorimi i materialeve të rrezikshme
- Udhëzohet përdorimi i materialit të prodhuar në vend pas demolimit (ripërdorimi)




Fig. 5 Paleta e ngjyrave të përdorshme dhe jo të përdorshme

3.10 Kërkesat për peizazh dhe mobiliar urban

- Të sigurohet qasje për të gjithë, përmes sigurimit të shkallëve, rampave (me dorëza) ku ka ndryshime të nivelit
- Të shfrytëzohen materiale të forta, jo të rrëshqitshme
- Të realizohet drenazhi për të siguruar rrjedhën e ujit atmosferik në sipërfaqen e të tokës.
- Ndriçimi të potencojë materialet e peizazhit (të forta dhe të buta) dhe minimizojë hijet e thella
- Lokimi i vendeve për ulje të ofrojë zgjedhje për diell, hije si dhe të mundësohet strehim nga të reshurat
- Sugjerohen materialet e forta dhe jo të rrëshqitshme për dyshemesi: guri i përpunuar, pllaka argjilore, betoni e të ngjashme
- Të përdoren materialet me teksturë që ndihmojnë orientimin, orientojnë lëvizjen (të ndihmojnë njerëzit me pengesa në të pamur)
- Mobiliari urban duhet të jetë i thjeshtë, të përcjell dizajnin në nivel të qytetit nëse është vendosur
- Ndriçimi të përdoret si mjet për të pamundësuar krimin
- Gjatë pajisjes së hapësirave publike, dizajni dhe zgjedhja e mobiliarit urban të paraqesë vepra të artit publik
- Nuk preferohet përdorimi i materialeve të cilat ndikojnë në perceptimin e vështirët hapësirës (psh. Stacioni i autobusëve krejt në qelq), për shkak të vështirësive në komunikim që u shkakton, njerëzve me vështirësi në të pamur.
- Kiosqet nuk mund të jenë të muratuar nga tullat, betoni ose elemente tjera të ngjashme ndërtimore; duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë) ; duhet të vendosen në zonë e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve
- Panotë e reklamave duhet të vendosen në zonë e shiritit të gjelbërt të rrugëve me qëllim që të mos pengojnë shikueshmërinë në trafik; duhet të vendosen në shtylla mbi lartësinë min.2.0 m.
- Tek sheshet duhet të respektohen vijat e lëvizjes duke mos vënë pengesa për

lëvizje. të planifikohen vende për ulje nën hije të drunjve, të planifikohet gjelbërimi duke i përfshirë katëgoritë dhe rolin e tij si (izolues, dekorues, interpolues, theksues etj), të planifikohen sipërfaqe të ujit- fontana, kroje etj.

3.11 Kërkesat për përcaktimin e kuotës së përdhesës

Kuota e përdhesës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike gjegjësisht në krahasim me kuotën zero:

- Kuota e përdhesës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se sa kuota e niveletës publike
- Kuota e përdhesës mund të jetë më së shumti 1.2 m mbi kuotën zero
- Për ndërtesa që në përdhesë kanë tregti apo shërbime, kuota e përdhesës mund të jetë më e madhe se kuota e trotuarit për maksimum 0.3 m.

Në rastet kur terreni është i pjerrët atëherë:

- Përdhesa përcaktohet në bazë të rrugës më të afërt për qasje
- Çdo gabarit i cili del deri në 1.2 m mbi kuotën zero llogaritet suterren
- Koeficienti ndërtimor për suterren llogaritet 50% e sipërfaqes së ndërtesës, d.m.th suterreni do të trajtohet nëse mbi 50% e vëllimit të katit hyn nën tokë
- Suterren tek terrenet pjerrëta konsiderohet nëse vëllimi i katësisë hyn nën 50% mbi tokë

3.12 Kërkesat tjera- konzollat, shkallët e jashtme, rampat, rrethojat

Konzollat:

- Ballkonet mund të kalojnë vijën ndërtimore (kur përputhet me vijën rregulluese) më së shumti deri 1.2 m.
- Konzollat më të mëdha se 1.2 m nuk mund të kalojnë vijën ndërtimore, ato duhet të vendoset brenda saj

Shkallët e jashtme:

- Shkallët e jashtme të hapura të cilat kanë lartësinë deri 1.2 m, nuk lejohet të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore

Rampat:

- Duhet të planifikohen në atë mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve
- nuk lejohen të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore

Rrethojat:

- parcelat ndërtimore të ndërtesave publike (përveç çerdhe/kopshteve dhe shkollave) dhe të banimit shumëbanesor nuk duhet të rrethohen

- aty ku lejohet përdorimi I rrethojës, ajo mund të jetë në lartësi 1.2 m nga kuota e trotuarit
- nëse rrethoja është mur atëherë ai duhet të jetë në lartësinë prej 0.9 m, ndërsa nëse është transparente mund të shkojë deri në 1.4 m
- rrethoja duhet të vendoset në vijën rregullues, në formë që shtyllat e gardhit të gjendet brenda parcelës ndërtimore dhe rrethohet
- dyert duhen të hapen brenda vijës rregullues
- rrethoja nuk është e lejuar të përdoret tek ndërtesat e banimi të përkohshëm
- rrethojat të cilat janë të ndërtuara dhe të cilat dalin nga rregullat e përcaktuara me këtë plan duhet të ndryshohen me qëllim të ruajtjes së interesit të përgjithshëm (siguri, dukje estetike, higjienë)

3.13 Kërkesat lidhur me karakteristikat e terrenit dhe kushtet e zhvillimit të terrenit

Për shkak se një pjesë e vendbanimeve të Istogut shtrihet në pjesën e rrëzës bazuar në hartën e karakteristikave të terrenit³ dhe kushteve të zhvillimit për zonën urbane duhet të mirren parasysh propozimet lidhur me masat mbrojtëse për kategoritë e caktuara- I, II, III (shih. Hartën 12.1 “Karakteristikat dhe kushtet e terrenit në zonën urbane”). Ndërsa për kategorinë e III-të të cilësuar si terrene me kufizime të njohura duhet si vijon:

- Kategoria III-1, për shkak të kushteve të papërshtatshme të punës dhe shfrytëzimit të terrenit propozohen masa mbrojtëse
- Kategoria III-2, për shkak të pjerrësive të mëdha dhe bazës gjeologjike përjashtohen të gjitha aktivitetet ndërtimore dhe ndërmarrja e masave të caktuara të mbrojtjes.

³ Plani territorial për Istogun 1997-1998 “ Karakteristikat e terrenit dhe kushtet e zhvillimit të terrenit”

4.0 LISTA E ZONAVE

4.1 Zonat, nën-kategoritë dhe nën-zonat në komunën e Istogut

Në tabelën e mëposhtme janë prezentuar të gjitha nën kategoritë e zonave kryesore si dhe nën-zonat të përcaktuara përmes karaktersitikave të caktuara.

Zona	Nën kategoritë			Nën-Zona	
ZB	Zonë banimi			ZBU/ ZBU mix	Banim I ultë/ Banim I ultë I përzier
				ZBM/ ZBM mix	Banim I mesëm/ Banim I mesëm I përzier
				ZBL/ ZBL mix	Banim I lartë/ Banim I lartë I përzier
				ZBR	Banim rural
ZK	Zone Komeriale				
ZI	Zonë Industriale	Industri e lëndës së parë-LP	Prodhim I produkteve jometalike minerale	ZILP-b	Hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e blloqeve të betonit
				ZILP-a	Prodhim asfalti
			Prodhim I drurit dhe produkteve më bazë druri	ZILP-d	Hapësira të shfrytëzuara për prodhim të drurit dhe prdukteve të saj
			Prodhim I produkteve më bazë plastikes	ZILP-p	Hapësira të shfrytëzuara për prodhim të plastikes
		industri e prodhimeve të lehta-PL	Prodhim I pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit	ZIPL-p	Hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e peshkut
				ZIPL-q	Hapësia për prodhimin e qumështit
				ZIPL-l	Hapësira për prodhimin e lëngjeve
				ZIPL-u	Hapësirë për prodhimin e ujit
				ZIPL-bk	Hapësirë për prodhimin e bukës
				ZIPL-bm	Hapësira për prodhimin e produkteve nga bimët mjekësore
		Prodhim I energjisë-PE	Prodhim I energjisë termile	ZIPE-d	Hapësirë që shfryëzon burimet termike- Prodhim I energjisë nga dielli
				ZIPE-u	Hapësirë që shfryëzon burimet ujore Prodhim I energjisë nga uji
ZM	Zonë për shfrytëzim të përzier				
ZuS	Zonë ushtarake e sigurisë			ZuS-FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
				ZsU-FSK	Zona e sigurisë së FSK-së
ZK-T	Zonë e komunikacionit-transportit		Rrjetet e transportit	ZKT-a	Stacion I autobusëve
				ZKT-p	Zonë e parkimit
			Shërbim publik	ZKT-n	Ngrohtorja
				ZKT-m	Infrastrukturë për trajtimin e mbeturinave
			ZKT-uz	Hapësirë për trajtimin e ujërave te zeza	
ZSH	ZSHT	Shërbim tregtar	Shërbim I akomodimit dhe ushqimit	ZSHT-h	Hotel
				ZSHT-r	Restoran
				ZHST-k	Kafene
			Sh. tregtar ,riparim I automjeteve	ZSHT-pf	Pushimore e fëmijëve
				ZSHT-qt	Qendër tregtare
				ZHST-th	Treg I hapur
	ZSHFI	Shërbim profesional financiar dhe I informacionit	Sh. financiar I sigurimit telekomunkimit	ZSHT-pk	Pikë karburanti
				ZSHFI-p	Postë
			ZSHFI-b	Bankë	

Tab. 6. Lista e zonave dhe nënzonave në komunën e Istogut

	ZSHK	Shërbimi I komunitetit	Shërbim I administratës publike, mbrojetes dhe sigurisë sociale	ZSHK-kk	Kuvendi komunal
				ZSHK-zv	Zyre vendi
				ZSHK-p	Policia
				ZHSK-zf	Zjarrëfikësit
			Shërbim arsimor	ZSHK-q	Qerdhe
				ZSHK-shf	Shkollë fillore dhe emesme e ulte
				ZSHK-shm	Shkolle e mesme e lartë
			Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	ZSHK-pmf	Punkt i mjekësisë familjare (ambulancë)
				ZSHK-mf	Qendër e mjekësisë familjare
				ZSHK-kmf	Qendër kryesore e mjekësisë familjare
ZSHK-qr	Qendra rehabilituese				
ZSHK-shtm	Shtëpia për të moshuar				
ZSHK-qk	Qendra e komunitetit				
	ZSHK-sv	Stacioni I veterinarisë			
	ZSHK-xh	Xhami			
	ZSHK-k	Kishë			
	Shërbim fetar	ZSHK-k	Kishë		
	Shërbim tjetër	ZHSK-v	Varreza		
ZSH	ZSHKR	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	Shërbim kulturor	ZSHKR-b	Bibliotekë
				ZSHKR-m	Muze
				ZSHKR-g	Galeri
				ZSHKR-t	Teatër
				ZSHKR-shk	Shtëpi kulture
			Shërbim argëtues	ZSHKR-pm	Park memorial
				ZSHKR-s	Stadioni
			Infrastrukturë sportive	ZSHKR-ps	Palestra sportive
				ZSHKR-fs	Fushë sportive
			Hapësirë e hapur rekreative	ZSHKR-psh	Pishinë
				ZSHKR-s	Sport dhe rekreim
				ZSHKR-p	Park
				ZSHKR-P	Pyll
ZSHKR-gjl	Gjelbrim përgjatë sipërfaqeve ujore				
	Shërbim tjetër	ZSHR-sh	Shesh		
Zb	Zonë bujqësore	Prodhim bujqësor komercial	Zb-K	Kullota	
		Infrastrukturë bujqësore	Zb-mb	Te mbjellura	
			Zb-sht	Shtalla	
ZP	Zonë pyjore				
Zms	Zonë miniere sipërfaqësore		ZmS-g	Gurore	
SM	Sipërfaqe e mbrojtur		ZmS-r	Përpunim dhe prodhim I rërës	
			SM-pk	Park Kombëtar	
			SM-pp	Park pylli	
			SM-sh	Shpellë	
ZVM	Zonë e veçantë e mbrojtur		Sm-kt	Kompleks trungjesh	
			ZVM-m	Manastir	
			ZVM-k	Kishë	
			ZVM-a	Lokalitet arkeologjik	
ZV	Zonë e veçantë		ZV-pn	Pasuri nëntokësore	
			ZV-t	Trafostacion	
			ZV-qk	Qendra korrektuese	
			SU-a	Hurdhë peshku (Akuakulturë)	
SU	Sipërfaqe ujore		SU-l	Lum	
			SU-p	Përrua	
			SU-j	Jaz	
			SU-lg	Liqe glacial	
			SU-au	Akumulues uji	
ZmV	Zonë e ndikuar nga vërshimet				
ZMU	Zonë e mbrojtur ujore		ZMU-bu	Burim uji	
			ZMU-ut	Ujë termal	
ZmAH	Zonë e mbrojtur arkeologjiike-historike		ZmAH-l	Lokalitet arkeologjik	
			ZmAH-vp	Vendbanim parahistorik	
			ZmAH-ti	Tumë ilire	
			ZmAH-gk	Gërmadhë e kishës	
			ZmAH-k	Kishë	
			ZmAH-xh	Xhami	
			ZmAH-kl	Kullë	
			ZmAH-sh	Shkollë	
			ZmAH-t	Truall	
			ZmAH-m	Mulli	
			ZmAH-u	Urë	
			ZmAH-shrr	Sharrë	

4.2 Zonat mbishtresore të përcaktuara brenda territorit të komunës.

Zona	Nën kategoritë	Nën-Zona	
SM	Sipërfaqe e mbrojtur	SM-pk	Park Kombëtar
		SM-pp	Park pylli
		SM-sh	Shpellë
		Sm-kt	Kompleks trungjesh
ZVM	Zonë e veçantë e mbrojtur	ZVM-m	Manastir
		ZVM-k	Kishë
		ZVM-a	Lokalitet arkeologjik
ZV	Zonë e veçantë	ZV-pn	Pasuri nëntokësore
		ZV-t	Trafostacion
		ZV-qk	Qendra korrektuese
ZmV	Zonë e ndikuar nga vërshimet		
	Zonë erozive		
	Zonë sizmike		
ZMU	Zonë e mbrojtur ujore	ZMU-bu	Burim uji
		ZMU-ut	Ujë termal
ZmAH	Zonë e mbrojtur arkeologjike-historike	ZmAH-l	Lokalitet arkeologjik
		ZmAH-vp	Vendbanim parahistorik
		ZmAH-ti	Tumë ilire
		ZmAH-gk	Gërmadhë e kishës
		ZmAH-k	Kishë
		ZmAH-xh	Xhami
		ZmAH-kl	Kullë
		ZmAH-sh	Shkollë
		ZmAH-t	Truall
		ZmAH-m	Mulli
		ZmAH-u	Urë
		ZmAH-shrr	Sharrë

Tab. 7 Zonat mbishtresore në komunën e Istogut

4.3 Zonat, nënzonat dhe zonat mbishtresore në secilin vendbanim

Madhësia e vendbanimit	Vendbanimi	ZONA-kodi	Zonat	Nënzonat	ZONA mbishtresore
VSHVR Vendbanim shumë i vogël rural > 200	Belicë	ZR	ZB,ZSH	ZSHKR-s	
	Bellopojë	ZR	ZSH	ZSHKR-s, ZSHK-k, ZHK-shf	
	Llukac i Thatë	ZR	ZSH,ZV	ZSHK-shf, ZSHKR-s	
	Osojan	ZR	ZV,ZSH	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHK-qk, ZSHFI-B, ZHSHFI-p, ZSHKR-p,ZSHKR-s	ZV-pn
	Polanë	ZR	ZP, ZV,ZSH	ZSHKR-s	ZV-pn
	Shalinovicë	ZR	ZV,ZSH	ZSHKR-s	ZV-pn
	Tuçep	ZR	ZV, ZSH	ZSHKR-s	ZV-t
	Veriq i Ri	ZR	ZB,ZSH,Zb	ZSHKR-s	
VVR Vendbanim i vogël rural 200-500	Cerkolez	ZR	ZP,SM,ZSH	ZSHK-q, ZHK-shf,ZSHK-a,ZSHK-zv, ZSHKR-s, ZHFI-p	SM-kt
	Dragolec	ZR	ZB, ZSHK	ZSHKR-s	ZmAH
	Drejë	ZR	ZV,ZSH	ZSHKR-s	ZV-pn
	Dubovë e Vogël	ZR	ZB,ZSH	ZSHKR-s	
	Kashicë	ZR	ZB,ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	
	Kosh	ZR	ZB,ZSH,	ZSHK-shf, ZP, ZSHKR-s	
	Mojstir	ZR	ZP, ZSH	ZSHKR-s	
	Prekallë	ZR	ZB,Zb,ZSH	ZSHKR-s	
	Serbobran	ZR		ZSHKR-s	
	Sinajë	ZR	ZB, ZP, SM, ZI	ZSHK-shf, ZSHKR-s, ZIPL-q, ZIPL-bm, ZILP-d	ZmS, SM-kt, ZmAH
	Veriq	ZR	ZB, ZSH	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHKR-s	ZmAH
	Zabllaq	ZR	ZZB, SH, ZV	ZSHKR-s	ZmS, ZV-pn
	Zhakovë	ZR	ZB,ZP, ZSH	ZSHKR-s	ZmAH
VMR Vendbanim i mesëm rural 500-1000	Carrallukë	ZR	ZB,Zb, ZSH, ZI	ZSHKR-s, ZILP-b, ZILP-d, ZILP-p	
	Banjicë	ZR	ZB, ZV		ZmS, ZV-pn, ZmAH
	Istog i Poshtëm	ZR	ZB,Zb, ZSH	ZSHKR-qk	
	Kaliqan	ZR	ZB,ZP,ZSH, SM	ZSHK-shf, ZSHK-a,ZSHKR-s	SM-pk, ZmAH
	Kërninë	ZR	ZZB, Zb,ZSH	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHKR-s	
	Kovragë	ZR	ZB, Zb,ZSH	ZSHKR-s	ZmAH
	Lubovë	ZR	ZB, Zb,ZSH	ZSHKR-s	
	Lubozhdë	ZR	ZB, ZP, ZSH, SM	ZSHKR-s	SM-pk, ZmAH
	Llugë	ZR	ZB, Zb, ZSH	ZSHKR-s	
	Muzhevinë	ZR	ZB, ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	
	Prigodë	ZR	ZB, ZSH, ZI	ZSHK-shf, ZSHKR-s, ZILP-b	
	Rakosh	ZR	ZB, ZSH, ZI,Zb	ZHSK-q, ZSHK-shf, ZSHK-zv,, ZSHFI-P, ZSHT-h, ZSHKR-shk, ZSHKR-s, ZIPL-d	
	Suhogërlle	ZR	ZB, ZP, ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	ZmS, ZmAH
	Tomoc	ZR	ZSH	ZSHKR-s	
	Trubuhoc	ZR	ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	
	Uçë	ZR	ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	ZP
	Zallq	ZR	ZB,Zb, ZSH, ZV,	ZSHK-q,ZSHK-shf, ZSHK-A, ZSHFI-p, ZSHKR-shk, ZSHKR-S, ZILP-b, Zb-sh	ZV-pn

VMMR Vendbanim I mesem I madh rural 1000-2500	Banjë	ZR	ZB, ZP, Zb, ZV, ZI, ZKT, ZIPE,	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-qk, ZSHK-zv, ZSHK-mf, ZSHT-h, ZSHT-r, ZSHT-pf, ZSHKR-s, ZSHKR-b, ZSHKR-shk, ZSHKR-p, ZSHKR-P, ZV-pn, ZIPE-S, ZMU-ut, ZKT-n, ZKT-a, ZKT-p, ZSHK-p, ZSHK-zf	ZMU, ZV, ZMAH
	Cerrcë	ZR	ZB, ZSH, ZmS	ZSHKR-s, ZSHK-k, ZHK-shf	ZMAH
	Dobrushë	ZR	ZB, Zb, ZSH, SM	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-zv, ZSHK-A, ZSHK-qk, ZSHFI-p, ZSHKR-p, ZSHKR-s, SM-PP	SM, ZMAH
	Dubravë	ZR	ZB, ZSH, ZV, ZUS	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHKR-s, ZUS	ZV-qk
	Gjurakoc	ZR	ZB, Zb, ZSH, ZVM, ZI	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-mf, ZSHKR-shk, ZSHK-p, ZSHT-h, ZSHFI-b, ZSHKR-p, ZSHK-shm, ZSHKR-s, ZVM-k, ZILP-b, ZILP-d, ZILP-p, Zb-d	ZVM
	Llukac i Begut	ZR	ZSH	ZSHK-shf, ZSHKR-s	
	Orobërdë	ZR	ZB, ZSH	ZSHKR-fs	
	Staradran	ZR	ZB, ZSH	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHKR-s	
	Studenicë	ZR	ZB, ZP, ZSH, ZVM, SM	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZSHKR-s, ZVM-a, SM-pk,	ZVM, SM, ZMAH
	Shushicë	ZR	ZB, ZP, ZSH	ZSHK-shf, ZSHK-a, ZP, ZSHKR-s	ZMAH
VRM Vendbanim rural I madh 2500-5000	Vrellë	ZR	ZP, ZB, Zb, ZSH, ZmS, ZMU, SM, ZI, ZrT	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-mf, ZSHK-qk, ZSHK-zv, ZSHKR-s, ZSHT-h, ZSHFI-p, ZIPL-I, ZIPL-d, ZIPL-b, , ZSHKR-pm	ZmS, ZMU-bu, ZrT, SM-pk, SM-sh, ZMAH
VSHVU Vendbanim shume I vogel urban 5000-10000	Istog	ZU	ZK, ZI, SU, ZSH, ZVM, ZMU, ZmS, SU, ZI	ZSHK-q, ZSHK-shf, ZSHK-shm, ZSHK-ZSHKR-sZKT-a, ZKT-p, ZIPL-p, SU-a,	ZVM-m, ZMU-bu, ZmS,

Tab. 8. Zonat, zonat mbishtesore dhe nënzonat nëpër vendbanimet e komunës së Istogut.

5.0 ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KUSHTET ZHVILLIMORE

Detyrimet nga PZHK-ja dhe kufinj të vendbanimeve- Harta Zonale e komunës së Istogut ka tentuar që sa më shumë t’i përmbahet kufinjëve të përcaktuar me PZHK-në si dhe në vecanti kritereve të përdorura në definimin e kufinjëve të vendbanimeve sipas PZHK-së siç janë: shmangja e zgjerimit jashtë zonave të ndërtuara; mbrojtja e tokës bujqësore kualitative; mbrojtja e peizazhit dhe shfrytëzimi racional i tokës.

Kufinj të vendbanimeve në hartën zonale të komunës janë përditësuar respektivisht precizuar duke u bazuar në :

- Bazën kadastrale të përditësuar nga komuna - e cila ka definuar në mënyrë të saktë kufinj të duke e përcjellur parimin e formës së parcellës që e prek kufiri i vendbanimit (dhe jo ‘cungimit’ të parcellës, ndarjes në parcela më të vogla se 2 ari)
- Incizimit satelitor të përditësuar (2019) në raport me atë të përdorur në PZHK (2014).
- Definimit dhe verifikimit i kufinjëve të vendbanimeve nga takimet dhe punëtoritë me banorët e secilit vendbanim e cila ka ndihmuar edhe në përcaktimet e destinimit të parcelave brenda kufirit të vendbanimit duke marrur parasysh orientimet sidomos të fshatërave drejt zhvillimit të bujqësisë.

Ky parim është përdorur për fshatërat/ vendbanimet të cilat nuk kanë qenë pjesë e ndonjë plani zhvillimor apo rregullues të mëparshëm. Ndërsa sa i përket vendbanimeve si: Istogut, Gurakocit, Vrellës, Banjës, Rakoshit dhe Saradranit, kufinj të tyre janë përcaktuar në bazë të planeve përkatëse të tyre, dmth sipas kufinjëve të përcaktuar në planet rregulluese/ zhvillimore urbane.

5.1 ZONA E BANIMIT- ZB

Zona e banimit përbëhet prej dy kategorive të banimit të përcaktuara me UA 08/2017:

- Banimi I përhershëm, I cili përfshinë të gjitha tipologjitë e banimit të ultë, të mesëm dhe të lartë (shtëpitë e veçanta, shtëpitë dyshe, shtëpitë në varg, ndërtesat terracore, me galeri, korridor qendror etj)
- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri apo banimi I përzier




Fig. 6 Skema e shpërndarjes së kategorive të banimit në komunën e Istogut

Në bazë të përshkallëzimit të vendbanimeve sipas madhësisë dhe funksioneve të dhëna me PZHK përmes renditje: qendra, subqendra dhe vendbanimet tjera është bërë edhe përshkallëzimi i banimit bazuar në këtë ndarje si në tabelën e mëposhtme.

	Nënkategoritë e banimit	Urbane	Vendbanimet rurale	
			Subqendra	VB tjera
Banim i përhershëm (BP)	Banim i përhershëm me një njësi: shtëpi të veçanta, dyshe, në varg BP1 me etazhitet prej P+1 deri P+2	✓	✓	✓
	Banim i përhershëm me ndërtesa shumëbanesore - BP2	✓	✓	/
Banim me funksione tjera në pajtueshmëri - (BFP) apo banim i përzier	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri me një njësi : shtëpi të veçanta, dyshe, në varg BFP1- i ulët me etazhitet prej P+1 deri P+2	✓	✓	/
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri me ndërtesat shumëbanesore BFP2 - i mesëm me etazhitet P+3 deri P+5	(përgjatë rrugëve kryesore /rajonale) ZTA	përgjatë rrugëve rajonale dhe rrugës kryesore tëVB ZTB1 & ZTB2	/
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri me ndërtesat shumëbanesore BFP3 - i lartë me etazhitet P+6	✓	/	/

Tab. 9. Nënkategoritë e banimit dhe shtrirja e tyre në bazë të qendrave kryesore

Zona e banimit të përhershëm ZB (5.1 Kodi HILUCS 2) dhe me funksione tjera në pajtueshmëri ZBmix (5.2 Kodi HILUCS 2) është ndarë në nënkategoritë e mëposhtme:

1. Zona e banimit të Ultë –ZBU ose ZBUmix
 - Zonë e banimit të ultë- Individuale ZBU-i, dyshe ZBU-d, në varg ZBU-v
 - Zonë e banimit rural- ZBR
2. Zona e banimit të mesëm- ZBM ose ZBMmix
 - ZBM1 (P+3)
 - ZBM 2 (P+4)
3. Zona e banimit të lartë- ZBL ose ZBLmix
 - ZBL 1 (P+5)
 - ZBL 2 (P+6)
 - ZBL 3 (P+6+NK)

5.1.1 Zona e banimit të përhershëm- ZB (5.1 Kodi HILUCS 2)

Shfrytëzimet e tokës (SHL, SHLD, SHLV, SHP, SHN) për zonën e banimit janë prezantuar përmes 3 tabelave të cilat lëvizin shfrytëzimet për zonën e ultë të banimit, të mesëm dhe të lartë si dhe të banimit rural.

SHL, SHLD, SHLV, SHP, SHN për zonën e banimit të ultë- ZBU

ZB- 1

ZONË BANIMI I ULTË- ZBU

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë nënkupton banimin e përhershëm respektivisht banimin e ultë i cili varësisht prej kërkesave mund të jetë i përbërë prej shtëpive të veçanta, dyshe dhe në rend. Në këtë kategori bën pjesë edhe ai me funksione në pajtueshmëri apo banim i ultë mix.	
5.1	Banim i përhershëm- ZBU
5.2	Banim me funksione në pajtueshmëri- ZBUmix
SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE	
3.3	Shërbime komuniteti
3.1	Shërbim tregtar
3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ
1.1	Prodhim bujqësor për konsum vetanak
3.1	Shërbime ushqimi: bujtina, restorante
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	

	Akomodim dhe shërbime ushqimi
	Shërbim tregtar për shtije me shumicë dhe pakicë
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME
	Shërbime argëtuese
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

Shfrytëzimet e tokës - SHL, SHLD, SHLV, SHP, SHN për zonën e banimit të mesëm dhe lartë-ZBM & ZBL

ZB- 2 & 3

ZONË BANIMI I MESËM & LARTË- ZBM & ZBL

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë përfshinë zonën e banimit të mesëm dhe të lartë përmes ndërtesave të banimit me shumë njësi të cilat mund ti takojnë tipologjive të caktuara varësisht prej kërkesave dhe karakteristikave të lokacionit ku janë të planifikuara, si: ndërtesa terracore, me galeri, me korridor qendrore, seksione etj.	
5.1	Banim I përhershëm ZBL1, ZBL2, ZBL3
5.2	Banim me funksione në pajtueshmëri ZBLmix
4.1.1	Infrastrukturë e transportit rrugor
4.3	Shërbim publik
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE
3.3	Shërbime komuniteti
3.1	Shërbim tregtar
3.2	Shërbime profesionale financiare dhe të informacionit
3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
2.3.3	industri e prodhimeve të lehta- botim dhe shtyp
2.3.1	Prodhim I ushqimit dhe pijeve (psh peshkut, qumështit)
2.3.5	Prodhim I produkteve të lehta (stoli, mobile, lodra etj)
2.3.2	Prodhim I rrobave dhe lëkurës (çanta, këpucë, aksesore)
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME
	Shërbime argëtuese
	Treg ditor, mobil
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

Tab. 10. Shfrytëzimet e tokës në zonën e banimit të mesëm dhe të lartë

Shfrytëzimet e tokës - SHL, SHLD, SHLV, SHP, SHN për zonën e banimit rural- ZR

ZB- 4

ZONË BANIMI RURAL- ZB-R

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Nënkupton zonën për zhvillim të banimit në zonat rurale. Zhvillimi i banimit rural do të jetë i vendosur dhe dizajnuar për t'a ruajtur karakterin natyror apo bujqësor të zonës dhe hapësirës përreth. Madhësia e parcelave mund të jetë më e madhe se ato që gjenden në zonën urbane.	
5.1	Shfrytëzim i përhershëm banimi (e kufizuar me shtëpi të ndara)
1.1.3	Prodhim bujqësor për konsum vetanak
4.1.1	Infrastrukturë e transportit rrugor
4.3	Shërbim publik
SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE	
1.1.1	Prodhimtari bujqësore komerciale
3.3	Shërbime komuniteti
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	
3.1	Shërbim tregtar
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOSSHME	
1.5.3	Mbledhja e produkteve bujqësore
	Shërbime të industrisë së lehtë
	Prodhim i energjisë së ripërtirshme
SHFRYTËZIMET E NDALUARA	
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

Tab. 11. Shfrytëzimi i tokës të banimi rural

Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim të përhershëm.

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E BANIMIT TË PËRHERSHËM	Simboli I zonës		
	Zona e banimit të ultë – Sip= 205171.39 ari	ZB-U1		
Shtëpi individuale (të veçanta), shtëpi dyshe, shtëpi në varg		ZBU-i	ZBU-d	ZBU-v
Parcela	Sipërfaqja minimale e parcelës (ari)	4	3	2
Vijat	Vija ndërtimore	varësisht nga kategoria e rrugës		
Dendësia	Numri I banorëve në hektar: b/ha (max.)	75	100	150
	Njësi banimi në hektar: nj.B/ha (max)	25	33	50
	Lartësia (max)	10.5	10.5	10.5
Distancat (e ndërtesës ndaj kufirit të parcelës)	Nëse ka kthina primare	min 0.75 H		
	nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H		
	në marrëveshje me fqin	min 0 H- 0.25 H		
	Distanca mes dy ndërtesave	min 1 H		
Katësia	Numri maksimal I kateve	3		
Intensiteti	ISHPKZH	30	40	50
	ISN	0.9	1.2	1.5
	SGJP	70	60	50
	SNP	30	40	50
Vendparkime		2 VP/ 100 m2		
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Në përputhje me kushtet zhvillimore respektivisht kërkesat për formësim estetik arkitektonik 3.8, përfshirë edhe kërkesat nën 3.6; 3.9; 3.11			
Qasja në parcelë	Duhet të jetë nga rruga publike apo private dhe atë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me anë të krijimit të një servitut kalimi në një parcelë fqinje. Gjërësia e hyrjes në parcelë nuk mund të jetë më I vogël se 2.5 m. Hyrja në ndërtesë parashiet të bëhet në anën e ndërtesës ku përdhesa është në nivel më të ngritur në raport me terrenin.			
Tjera	Rregullat per zhvillim peizazhor dhe shritiave mbrojtës të gjelbërimit në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për ndriçim natyror dhe artificial në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme			

Tab. 12 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e ultë

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E BANIMIT TË PËRHERSHËM	Simboli I zonës					
	Zona e banimit të mesëm ZBM - Sip=1591.39 ari dhe të lartë ZBL- Sip=167.79 ari	ZBM		ZBL			
Banesat me shumë njësi të cilat mund të jenë: me seksione, galeri, korridor qendror, terracore etj		ZBM 1	ZBM 2	ZBL1	ZBL 2	ZBL	ZBL 4*
Parcela	Sipërfaqja minimale e parcelës (ari)	12	12	15	15	15	15
Vijat	Vija ndërtimore	varësisht nga kategoria e rrugës					
Dendësia	Numri i banorëve në hektar: b/ha (max.)	250	250	450	450	450	450
	Njësi banimi në hektar: nj.B/ha (max)	8	8	6-7	6-7	6-7	6-7
Lartësia	Lartësia (min)	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5
	Lartësia (max)	14.5	17.5	20.5	23.5	26.5	29.5
Distancat (e ndërtesës ndaj kufirit të parcelës)	Nëse ka kthina primare	min 0.75 H					
	nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H					
	në marrëveshje me fqin	min 0 H- 0.25 H					
	Distanca mes dy ndërtesave	min 1 H					
Intensiteti	ISZPK	40-50	40-50	40-50	40-50	40-50	40-50
	ISN	1.6	2.0	2.4	2.8	3.2	3.2
	SGJP	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50
	SNP	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50	60- 50
Vendparkime		2 VP/ 100 m2					
Gjlebrimi	Të ruhen në maksimum drunjtë ekzistues *Druri duhet të këtë kurorën e gjërë	min 1 dru*/ 250 m2					
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Në përputhje me kushtet zhvillimore respektivisht kërkesat për formësim estetik arkitektonik 3.8, përfshirë edhe kërkesat nën 3.6; 3.9; 3.11						
Qasja në parcelë	Duhet të jetë nga rruga publike apo private dhe atë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me anë të krijimit të një servitut kalimi në një parcelë fqinje. Gjërësia e hyrjes në parcelë nuk mund të jetë më e vogël se 10 m. Hyrja në ndërtesë parashihet të bëhet në anën e ndërtesës ku përdhesa është në nivel më të ngritur në raport me terrenin.						
Tjera	Rregullat per zhvillim peizazhor dhe shritiave mbrojtës të gjelbërimit në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për ndriçim natyror dhe artificial në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme						
*	Kati fundit i tërhequr						

Tab. 13 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e mesëm dhe të lartë

5.1.2 Zona e banimit me funksione në pajtueshëmri- ZBmix (5.2 Kodi HILUCS 2)

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për zonat me banim të përzier. Zona e banimi të ultë të përzier - ZBUmix

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E BANIMIT ME FUNKSIONE NË PAJTUESHMËRI	Simboli I zonës		
	Zona e banimit të ultë- Sip=37662.53 ari	ZB-Umix		
Shtëpi individuale (të veçanta), shtëpi dyshe, shtëpi në varg		ZBU-i	ZBU-d	ZBU-v
Parcela	Sipërfaqja minimale e parcelës (ari)	4.5	3.5	2.5
Vijat	Vija ndërtimore	varësisht nga kategoria e rrugës		
Dendësia	Numri I banorëve në hektar: b/ha (max.)	75	100	150
	Njësi banimi në hektar: nj.B/ha (max)	25	33	50
Lartësia	Lartësia (min)	4.5	4.5	4.5
	Lartësia (max)	11.5	11.5	11.5
Distancat (e ndërtesës ndaj kufirit të parcelës)	Nëse ka kthina primare	min 0.75 H		
	nëse ka kthina sekondare	min 0.25 H		
	në marrëveshje me fqin	min 0 H- 0.25 H		
	Distanca mes dy ndërtesave	min 1 H		
Intensiteti	ISHPKZH	40	50	60
	ISN	1.2	1.5	1.8
	SGJP	60	50	40
	SNP	40	50	60
Vendparkime	Banim	2 VP/ 100 m2		
	Funksion në pajtueshmëri	sipas 3.4 kushteve të rregullimit , tab 3		
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Në përputhje me kushtet zhvillimore respektivisht kërkesat për formësim estetik arkitektonik 3.8, përfshirë edhe kërkesat nën 3.6; 3.9; 3.11			
Qasja në parcelë	Duhet të jetë nga rruga publike apo private dhe atë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me anë të krijimit të një servitut kalimi në një parcelë fqinje. Gjërësia e hyrjes në parcelë nuk mund të jetë më e vogël se 2.5 m. Hyrja në ndërtesë parashiet të bëhet në anën e ndërtesës ku përdheta është në nivel më të ngritur në raport me terrenin.			
Tjera	Rregullat per zhvillim peizazhor dhe shritiave mbrojtës të gjelbërimit në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për ndriçim natyror dhe artificial në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithsme Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme			

Tab. 14 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për banimin e ultë mix

Bazuar në kushtet zhvillimore dhe ndërtimore duke marrur parasysh tri kategoritë e banimit me densitetë e tyre përkatëse vijmë në përfundim që dendësia banimore në tërë komunën në përgjithësi është e ulët. Tek zonat e vendbanimeve rurale për shkak të sipërfaqes më të madhe të parcelës si rezultat i promovimit dhe inkurajimit të punimit të tokës bujqësore ka rezultuar që dendësia të jetë më e ultë. Në uljen e dendësisë ndikon edhe toka e rezervuar apo e quajtur zgjerim në të ardhmen e cila hyn në sipërfaqen e gjithmbarshme të tokës ndërtimore për zonën/ vendbanimin përkatës. Dendësia e ultë banimore lidhet edhe me tipologjinë e vendbanimit si psh vendbanimet e shprëndara që zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në komunën e Istogut.

Vendbanimi	Nr I banorëve	Sipërfaqja e vendbanimit (ha)	Dendësia banimore ban/ha
Banjë	13325	246.39	54
Banjicë	650	20.29	32
Bellopojë	210	22.00	10
Carrallukë	700	45.34	15
Cerkolez	420	14.81	28
Cerrcë	1500	50.00	30
Dobrushë	5000	217.20	23
Dragolec	500	20.00	25
Drejë	500	18.00	28
Dubovë e Vogël	300	11.33	26
Gjurakoc	17650	195.97	90
Istog	32735	237.12	138
Istog i Poshtëm	700	30.86	23
Kaliqan	1000	25.00	40
Kashicë	600	20.03	30
Kërninë	640	21.22	30
Kosh	290	19.18	15
Kovragë	900	30.00	30
Lubovë	900	29.68	30
Lubozhdë	1100	34.65	32
Llugë	700	30.00	23
Llukac i Begut	1500	75.00	20
Llukac i Thatë	200	13.57	15
Mojstir	350	27.78	13
Muzhevinë	750	34.00	22
Orobërdë	1000	40.29	25
Osojan	100	22.97	4
Prekallë	410	20.10	20
Prigodë	680	61.14	11
Rakosh	8175	143.99	57
Sinajë	300	15.86	19
Staradran	2000	91.77	22
Studenicë	1800	78.29	23
Suhogërlilë	1100	56.64	19
Shalinovicë	150	15.14	10
Shushicë	1900	95.27	20
Tomoc	950	63.51	15
Trubuhoc	1100	45.67	24
Uçë	650	56.35	12
Veriq	600	48.93	12
Veriq i Ri		0.00	
Vrellë	12370	262.02	47
Zabllaq	600	23.94	25
Zallq	650	31.67	21
Zhakovë	420	18.03	23

Tab. 15 Dendësia banimore

5.2 ZONA KOMERCIALE- ZK

Në territorin e komunës së Istogut zona komerciale më e theksuara është ajo përgjatë rrugës rajonale në kufi të zonës së Banjës e cila shtrihet në të dy anët e rrugës. Meqë është një zonë me interes jo vetëm në kontekstin funksional dhe hapësinor por edhe në kontakt të imazhit të venbanimit, me këtë hartë është propozuar që t'i nënshtrohet një intervenimi në nivel të dizajnit urban gjë për të cilën edhe është propozuar si hapësirë për trajtim në të ardhmen respektivisht hartim të planit rregullues të hollësishëm.

ZK

ZONË KOMERCIALE- ZK

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë paraqet funksionet komerciale dhe të industrisë së lehtë të cilat janë të parapara jashtë qendrave urbane dhe të cilat janë të destinuara t'i shërbejnë publikut gjatë udhëtimeve me automobil ose në një vendbanim më të largët përgjatë arterieve kryesore.	
2.3	Industri e produkteve të lehta
3.1	Shërbime komerciale
3.2	Shërbime financiare, profesionale dhe informative
3.3	Shërbime komuniteti
4.2	Shërbime logjistike dhe depo
5.2	Shfrytëzim banimi me shfrytëzime tjera në pajtueshmëri me funksionet
SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE	
4.1.1	Transport rrugor
4.3	Shërbime publike
5.3	Shërbim tjetër banimi
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	
	Infrastrukturë e energjisë elektrike, termike apo telekomunikacionit (antenë atj)
SHFRYTËZIMET E PËRKOHSHME	
	Pika të shitjes së prodhimeve që lidhen me industrinë e lehtë
SHFRYTËZIMET E NDALUARA	
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

Tab. 16. Shfrytëzimet e tokës të zona komerciale

Ndërsa kushtet ndërtimore për ndërtesa komerciale janë të prezentuaras në tabelën e mëposhtme:

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA KOMERCIALE	Simboli I zonës ZK	
	Ndërtesat komerciale		
Dimensionet e parcelës varet nga lloji I veprimtarisë komerciale		Ndërtesa tregtare me shumicë	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës	min	max
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	1000 m2	2500 m2
Vijat	Vija rregulluese	Sipas profilit rrugor	
Lartësia	Lartësia	5 m	8 m
Intensiteti	ISZPK	50% + 10-20 % pllakosje	
	ISN	1	
	SGJP	30-40%	
Vendparkime	Në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme		
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Preferohet kulmi dyujor ose I rrafshët. Nuk lejohet përdorimi I dritareve pasqyre dhe me ngjyra. Inkurajohet përdorimi I elementeve çmontuese si dhe nga materiale të cilat janë natyrore dhe të ripërdorshme. Forma dhe ngjyrat t'I përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.		
Tjera	Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi I qasjes për ndërtesë industriale të behët para zhvillimit të parcelës		

5.3 ZONA INDUSTRIALE- ZI

Zona industriale e cila përfshinë edhe atë komerciale në bazë të veprimtarive aktuale përbëhet prej këyre klasave:

- Industri e lëndës së parë e cila përfshinë prodhimin e produkteve jometalike
- Industri e prodhimeve të lehta , e cila përfshinë prodhimin e pijeve, peshkut dhe produktet e qumështit
- Prodhim I energjisë- që përfshinë prodhimin e energjisë së ripërtirshme.

5.3.1 Zona industriale e lëndës së parë- ZILP (2.1.7 Kodi HILUCS 3)

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara

ZI- 1		ZONË INDUSTRIALE E LËNDËS SË PARË- ZILP	
		Sip= 2212.338 ari	
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA		
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë është e dedikuar për industri të lehtë, respektivisht për prodhim I durirt dhe produkteve me bazë druri si dhe prodhim I produkteve jometalike minerale			
2.1.2	Prodhim I drurit dhe produkteve të saj- ZILP-D		
	Prodhim I plastikës- ZILP-P		
2.1.7	Prodhim I betornit dhe blloqeve të betonit- ZILP-B		
	Prodhim I asfaltit- ZILP-A		
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA		
4.1.1	Transport rrugor		
4.2	Shërbime logjistike dhe depo		
3.1.1	Shërbime tregtare të shitjes me pakicë		

Tab. 17 Zona industriale e lëndës së parë- shfrytëzimet e tokës

5.3.2 Zona industriale e prodhimeve të lehta- ZIPL (2.3.1 Kodi HILUCS 3)

Shfrytëzimet e tokës për zonën industriale të prodhimeve të lehta

ZI-2	ZONË INDUSTRIALE E PRODHIMEVE TË LEHTA- ZIPL	
Sip=2030.57 ari		
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA	

Arsyetimi dhe qëllimi: Industri e prodhimeve të lehta. (Prodhim I pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit) kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuar apër prodhim të peshkut, lengjëve, qumështit dhe bimëve mejkuese)	
2.3.2	Prodhim I peshkut- ZIPL-P
	Prodhim I qumështit- ZIPL- Q
	Prodhim I lengjëve- ZIPL-L
	Prodhim I produkteve nga bimët mjekësore- ZIPL-BM
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	
4.1.1	Transport rrugor
4.2	Shërbime logjistike dhe depo
4.3	Shërbime publike
3.1.1	Shërbime tregtare të shitjes me pakicë
3.1.3	Shërbime të akomodimit dhe ushqimit

Tab. 18 Zona industriale e prodhimeve të lehta- shfrytëzimet e tokës

5.3.3 Zonë industrial- prodhim I energjisë- ZIPE (2.4.4 Kodi HILUCS 3)

Shfrytëzimet e tokës për zonën industriale për prodhim të energjisë

ZI-3	ZONË INDUSTRIALE /PROD HIM I ENERGIJË- ZIPE		
Sip=898.86 ari			
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA		
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë paraqet zonën e cila shërben për prodhim të energjisë së ripërtrishme që shfërtëzon burimet ujore dhe diellore.			
2.4.4	Prodhim I energjisë nga dielli- ZIPE-D		
	Prodhim I energjisë nga uji- ZIPE-U		
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA Të VEÇANTA		
3.4.4	Hapësirë e hapur rekreative- ZSHKR-P		

Tab. 19 Zona industriale/ prodhim i energjisë shfrytëzimet e tokës

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat industriale dhe komerciale

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA INDUSTRIALE	Simboli I zonës ZI	
	Ndërtesat industriale		
Dimensionet e parcelës varen nga lloji I industrisë dhe madhësisë së veprimtarisë industriale		Ndërtesa industriale	
	Sipërfaqja e parcelës	min	max

Dimensionet e parcelave		2500 m2	10000 m2
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	Varësisht prej llojit të veprimtarisë	
Vijat	Vija rregulluese	Sipas profilit rrugor	
Lartësia	Lartësia	7 m	12 m
Intensiteti	ISZPK	50% + 10-20 % pllakosje	
	ISN	0.5-1.0	
	SGJP	30-40%	
Vendparkime	Në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme		
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Preferohet kulmi dyujor ose I rrafshët. Nuk lejohet përdorimi I dritareve pasqyre dhe me ngjyra. Inkurajohet përdorimi I elementeve çmontuese si dhe nga materiale të cilat janë natyrore dhe të ripërdorshme. Rrethoja e parcelës duhet të jetë transparente dhe në lartësi prej 1.4-2.0 m. Forma dhe ngjyrat t'I përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.		
Tjera	Distancat- ndërtesat industriale duhet të jenë të larguara nga shërbimet arsimore, shëndetësore, sportive dhe rekreative së paku 800 m'. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi I qasjes për ndërtesë industriale të behët para zhvillimit të parcelës		

Tab. 20. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat industriale dhe komerciale

Tek zona urbane, zona ekzistuese e minierës sipërfaqësore për shkak të afërsisë më zonën e banimit si dhe zonën e veçantë të mbrojtur (Manastiri I Gorioçit) është propozuar si zonë industriale marrë për bazë kufizimet në kontekst të buffer zonave si në nivel të ZVM-ve ashtu edhe të ZMS-ve. Kjo zonë industriale varësisht prej llojit të saj mund t'i ushtrojë veprimtaritë lidhur me ZILP (HILUCS3; 2.1.1; 2.1.2; 2.1.3; 2.1.5; 2.1.8) ose ZIPL (HILUCS3; 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5)

5.4 ZONA PËR SHFRYTËZIM TË PËRZIER- ZSHP

ZSHP	ZONË PËR SHFRYTËZIM TË PËRZIER- ZSHP
	Sip= 12230.57 ari
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: zonë për shërbime të llojllojshme përfshirë banimin, shërbime komerciale dhe industriale, kryesisht në qendrat të vendbanimeve të vogla.	
5.0	Banim
3.1.3	Akomodim dhe shërbime ushqimi
3.1.4	Shërbime komerciale
3.2	Shërbime financiare, profesionale dhe informative
3.3	Shërbime të komunitetit
3.4	Shërbime kulturore, zbavitje dhe rekreacion
3.1.1	Shërbime tregatë më shumicë dhe pakicë
3.1.2	shërbime të pronave të paluajtshme
1.1.3	Prodhim bujqësor për konsum vetanak
	Shërbime të logjistikës dhe magazinimit
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
4.3	Shërbime publike
	Infrastrukturë teknike
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOZHSHME
	Shërbime argëtuese (panaire)
	Pika të shitjes së prodhimeve
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

ZSHP 1	Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim sipas ZBM 1
ZSHP 2	Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim sipas ZBM 2
ZSHP 3	Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim sipas ZBL 1
ZSHP 4	Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim sipas ZBL 2
ZSHP 5	Kushtet zhvillimore ndërtimore për banim sipas ZBL 3
Kushtet për shfrytëzimet tjera të lejuara, të veçanta dhe të përkohshme sipas tabelave të prezantuara për zonat përkatëse (të përcaktuara në zonat bazë)	

5.5 ZONA USHTARAKE E SIGURISË- ZUS

Zona ushtarake e sigurisë ZuS, e përfshinë hapësirën e cila ofron shrbëime të sigurisë publike. Në përpjekje për të kufizuar shkeljet dhe për të mbajtur një ekuilibër midis trajnimit ushtarak, kërkesave të komunitetit dhe mbrojtjes së mjedisit është krijuar zona e quajtur zona e sigurisë ushtarake –ZsU. Kjo zonë kontribuon në ruajtjen e mjedisit në këto aspekte:

- Mbrojtjen nga zhurma, pluhuri dhe tymi i krijuar nga trajnimet ushtarake në pronat në afërsi të ZsU-së
- Mbrojtjen e zonavë të rëndësishme ekologjike
- Krijimin e një ambienti më të sigurt si dhe siguron forca të gatshme për mision që mund të ndihmojë në rast emergjencash të mëdha dhe fatkeqësive natyrore duke ofruar intervenim të shprejtë në situata të ndryshme.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës:

- Sipas ligjit FSK vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet zi
- nxhirit të unifikuar komandues dhe është e përberë me një komponentë aktive prej jo më shumë se pesë mijë (5000) pjesëtarë dhe nga një komponentë rezervë prej jo më shumë se tre mijë (3000) pjesëtarë.
- Struktura e FSK-se përbëhet nga Shtabi i Përgjithshëm, Komanda e Forcës Tokësore; Komanda e Gardës Kombëtare; Komanda e Logjistikës dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, e cila është e shpërndarë në disa lokacione në tërë territorin e Kosovës.
- Lokacionet ku është e vendosur FSK-ja, si dhe lokacionet ku parashihet që të ketë në pronësi, shfrytëzim/përdorim për deponimin e armëve, sistemit të armatimit, organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve, është më se e nevojshme të ketë lokacione të cilat duhet të kenë perimetër të sigurisë së veçantë.
- Këto lokacione dhe perimetri i caktuar i sigurisë janë më rendësi jo vetëm për FSK-në, por edhe për mjedisin që i rrethon ato.
- **Zonë Ushtarake – Sigurisë (ZuS)** Është territori i cili është në pronësi, menaxhim, mbikëqyrje, kontrollim, dhe shfrytëzim të FSK-se.
- **Zonë e Sigurisë Ushtarake (ZsU)** Është zona në distancë minimale njëqind metra (100 m), për rreth territorit të ZuS me interes të veçantë i cili është në pronësi shtetërore apo private dhe shfrytëzohet nga akterë të tjerë shtetëror apo privat ku vendosen ndalesa (kufizime) për shfrytëzimin e burimeve ose masa specifike të zhvillimit me qëllim ruajtjen e vlerave dhe të sigurisë.
- **Distanca e perimetrit të sigurisë ushtarake** mund të rritet sipas nevojave të FSK-se.
- Bazat ushtarake janë të pozicionuara brenda qyteteve dhe jashtë tyre, lokacione këto të cilat përdoren për stacionim të përhershëm por edhe për stacionim të përkohshëm, ku zhvillohen detyra të përditshme, trajnime, shkollime dhe stërvitje reale (live).
- Hapësira ekzistuese e FSK-se dhe ato të planifikuara në kuadër të FSK-së përfshijnë rreth 0.6 % të territorit të Kosovës.

- Në kuadër të bazave ushtarake hyjnë edhe lokacionet ku janë të vendosur forcat ndërkombëtar të KFOR-it, qe nuk janë të përfshira në hapësirat ekzistuese të FSK-se.



Fig. 7 Zona ushtarake e sigurisë - ZuS bashkë me perimetrin mbrojtës, zonën e sigurisë ushtarake-ZsU (burimi: Ministria e Mbrojtjes, Departamenti I Operacioneve dhe trajnimeve)

ZuS

ZONË USHTARAKE E SIGURISË- ZuS

Sip= 10756.524 ari

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë paraqet hapësirën që shfrytëzohet për ofrimin e shërbimeve të sigurisë publike.	
3.3.1	Forca e sigurisë së Kosovës
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
4.1.1	Transport rrugor
4.2	Shërbime logjistike dhe depo

Tab. 21 Zona ushtarake e sigurisë- shfrytëzimet e tokës

ZsU në distance minimale 100 m ndahet në dy breza të sigurisë:

Brezi i parë deri në 50 metra nga rrethoja e instalimeve ushtarake, ndërsa brezi i dytë i sigurisë nga 50 metra deri 100 metra. Gjendja faktike në teren tek disa lokacione i determinon kufizimet, të cilat nuk kërkohet domosdoshmërisht të ndryshohen, por, aktivitetet tjera të mëtejme që bien ndesh me piken 1 dhe 2 të përcaktimit të ZsU (tampon zonës) të ndalohen.

Vendosja e tampon zonave ose zonave të sigurisë ushtarake (ZsU) rreth një baze ushtarake kufizon efektet e ndërhyrjes në trajnimin ushtarak dhe maksimizon sasinë e tokës së trajnimit në dispozicion brenda kufirit të zonave ushtarake që mund të përdoret për të përmbushur misionin e saj. Zona e sigurisë gjithashtu kontribuojnë në përfitimet e bujqësisë dhe përdorimit të hapësirës së gjelbër.

ZsU është pjesë e përpjekjes së FSK-së për të kufizuar shkeljet dhe për të mbajtur një ekuilibër midis kërkesave të trajnimit ushtarak, dëshirave të komunitetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

PËRFITIMET E KOMUNITETIT dhe PËRFITIMET MJEDISORE

Zona e sigurisë ushtarake në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit:

- Mbron tokën bujqësore, të pyllëzuar, florën dhe faunën, ndihmon në ruajtjen e zonave të rëndësishme ekologjike.
- Mbron nga zhurma, pluhuri dhe tymi i krijuar nga trajnimet ushtarake në pronat në afërsi të ZsU-së.
- Një ambient më i sigurt, gjithashtu siguron forca të gatshme për mision që mund të ndihmojnë në rast emergjencash të mëdha dhe fatkeqësive natyrore që ofron intervenim të shpejtë në situata të ndryshme.

Rekomandimet dhe veprimet e nevojshme

Për arritjen e qëllimit / objektives për zhvillim dhe avancim të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes, do të zhvillohen këto veprime, masa, aktivitete dhe projekte:

- Te rishikohet dokumenti Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, të behën ndryshimet sipas realitetit të krijuar dhe të përcaktohen përkufizimet sipas nevojës së shtetit respektivisht të FSK-së për siguri.
- Përcaktimi i ZsU sipas kriterëve të poshtëshënuara:
 - Në distance dhjetë metra (10 m) nga rrethoja lejohen vetëm të mbjella bujqësore, ndërsa në distancë nga rrethoja prej dhjetë (10 m) deri pesëdhjetë metra (50 m) lejohet vetëm të mbjella bujqësore, drunjtë kurora e të cilëve nuk kalon lartësinë pesë metra (5 m) dhe dendësi jo më të vogël se dy metra (2 m).
 - Në distancë nga rrethoja prej pesëdhjetë (50 m) deri në njëqind metra (100 m) lejohen ndërtimet jo më të larta se 10 m (2 kate banimi) mbi tokë dhe dy kate nën dhe (shih Normat Teknike pika 5. Rregullat e lartësisë së ndërtesave, nën-pika 5.1. Lartësia e ndërtesës (H)); lejohen të mbjella bujqësore, drunjtë kurora e të cilëve nuk kalon lartësi 10 m.
 - Në pjesët (anët) e kazermave ku gjendet poligoni i qitjes, zona e sigurisë është më e madhe 100 m – 350 m.
 - Ndalohet lëvizja e armatosur në zonën e sigurisë (ZsU).
 - Mirëmbajtja e hapësirës brenda zonës së sigurisë (tampon zonës) të bëhet në koordinim me pronaret e pronave.
 - Vendosja e antenave transmetuese Brenda ZsU lejohet vetëm me leje të FSK-së.
- Në Master Planet Urbanistike të respektohet vendosja e zonës së sigurisë ushtarake (ZsU).⁴

⁴ Ministria e Mbrojtjes, Departamenti i Opearcioneve dhe trajnimeve, “Zona Ushtarake e Sigurisëw- draft”

5.5 ZONA E SHËRBIMEVE- ZSH

Zona e shërbimeve në komunën e Istogut duke iu referura nomenklaturës HILUCS, është e ndarë në 4 zona:

- Zona e shërbimeve tregtare ZSHT
- Zona e shërbimeve financiare dhe të informacionit ZSHFI
- Zona e shërbimeve të komunitetit ZSHK
- Zona e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative ZSHKR




Fig. 8 Skema e shprërndarjes së zonës së shërbimeve

Zona e shërbimeve të komunitetit ZSHK dhe zona e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative ZSHKR është trajtuar në kapitullin 8.0 Infrastruktura publike dhe sociale.

5.5.1 Zona e shërbimeve tregtare, ZSHT (3.1 Kodi HILUCS 2)

Në zonën e shërbimeve tregtarë në komunën e Istogut, bëjnë pjesë shërbimet tregtare me shumicë dhe pakicë (3.1.1 Kodi HILUCS 3) dhe shërbimet e akomodimit dhe ushqimit (3.1.3 Kodi HILUCS 3)

Në komunën e Istogut janë ekzistuese hotelet në zonën e Istogut, Bajës dhe Gurrakoc, ndërsa janë propozuar konviktet në zonën e Rakoshit dhe Vrellës.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara për shërbimet tregtare

ZSH- 1

ZONË E SHËRBIMEVE TREGTARE- ZSHT

Sip= 968.28 ari

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Në zonën e shërbimeve tregtare bëjnë pjesë të gjitha hapësirat që ofrojnë shërbime si të akomodimit dhe ushqimit si psh: akomodim në hotel, fshat turistik, vendkëmbim, restorant, bar, salla mbledhjeje etj si dhe shërbimeve që lidhen me shitjen e shumicë dhe pakicë.	
3.1.3	Hotel- ZSHT-H
	Restorant- ZSHT-R
	Kafene- ZSHT-K
	Pushimore e fëmijëve- ZSHT-PF
3.1.1	Shërbime tregtare të shitjes me pakicë
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
4.1.1	Transport rrugor
4.2	Shërbime logjistike dhe depo
4.3	Shërbime publike

Tab. 22. Shfrytëzimet e tokës për zonën tregtare

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbimet tregtare

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA SHËRBIMEVE TREGTARE	Simboli i zonës			
	Hotel, bujtina- Sip=966.43 ari	ZSHT			
Bujtinat (në vendbanimet në të cilat është paraprirë zhvillimi i turizmit- Banjë, Vrellë,..)		Ndërtesa hotelierike		Bujtina	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m ²)	min	max	min	max
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	1000	2500	500	1000
Vijat	Vija ndërtimore (m')	sipas profilit rrugor			
Lartësia	Lartësia (m')	13	16	10	13
Intensiteti	ISHPKZH	30%+ 10 % pllakosje		30%+ 10 % pllakosje	
	ISN	0.25-0.5		0.25-0.5	
	SGJP	60%		60%	
Vendparkime		0.2 VP/ një shtrat (3*) 0.5 VP/ një shtrat (4*)		3 VP/ njësi banimi	

Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.
Tjera	Distanca- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi i qasjes për ndërtesë hoteliere të behët para zhvillimit të parcelës

Tab. 23 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbimet tregtare

5.5.2 Zona shërbimeve financiare dhe të informacionit, ZSHFI (3.2 Kodi HILUCS 3)

Në komunën e Istogut janë ekzistuese postat në zonën e Istogut dhe Osojanit, dhe të propozuara me Planin Zhvillimor Komunal në zonën e Rakoshit, Cërkolez, Vrellë, Dobrushë dhe Zallq. Ndërsa Bankat gjenden në Istog, Gurakoc dhe Osojan.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara për shërbime financiare dhe të informacionit

ZSH- 2

ZONË E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE TË INFORMACIONIT- ZSHFI

HILUCS Kodi i shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Në zonën e shërbimeve bëjnë pjesë të gjitha shërbimet profesionale financiare dhe të informacionit, përfshirë shërbimet financiare të sigurimit si dhe të informimit dhe komunikimit.	
3.1.3	Postë - ZSHFI-P
3.1.1	Bankë- ZSHFI-B
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
3.1	Shërbim tregtar
4.2	Shërbime logjistike dhe depo
4.3	Shërbime publike

Tab. 24. Shfrytëzimet e tokës të zona e shërbimeve financiare dhe të informacionit

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat e postës dhe bankës

	ZONA E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE TË INFORMACIONIT	Simboli i zonës
--	---	-----------------

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	Postë, Bankë- Sip= 64.253 ari	ZSHFI			
Postat e propozuara janë në: Rakosh, Cërkolez, Vrellë, Dobrushë, Zallq		Postë ZSHFI-P		Bankë ZSHFI-B	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m2)	min 400	max 2000	min 400	max /
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	min. 7.50 m			
Vijat	Vija rregulluese (m')	sipas profilit rrugor			
Lartësia	Lartësia (m')	13	15.5	13	15.5
Intensiteti	ISHPKZH	40%		40%	
	ISN	0.25-0.8		0.25-0.8	
	SGJP	60%		60%	
Vendparkime		2 VP / 100m2		4 VP / 100 m2	
		Për ndërtesa me sipërfaqe më të vogla se 100 m2, të sigurohen së paku 2 VP			
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.				
Tjera	Distancat- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike Lokacioni në pjesën / pjesët qendrore të vendbanimeve. Duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë në rrugë publike. Të ndërtohen në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen Ky lloj i ndërtimeve është më së miri i përshtatshëm i kombinuar me destinime të tjera afariste-administrative, dhe në afërsi me zona banimi që popullësia të ketë qasje sa më të shpejtë.				

Tab. 25. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbimet financiare dhe informacionit

5.6 ZONË BUJQËSORE- ZB

Sipas Ligjit për tokën bujqësore Nr. 02/-L-26, toka bujqësore paraqet tokën e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdhë peshku dhe moçale si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë natyrore dhe ekonomike⁵. Toka bujqësore mund të jetë e punueshme si: ara, kopshti, pemishte, vreshta dhe livadh si dhe tokë bujqësore e papunueshme si: kullotat, hurdhat e peshkut dhe moçali.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara

Zb	ZONË BUJQËSORE- Zb	T1- BJESHKA			T2- RRËZA			T3- RRAFSHI		
		T	T	T	T	T	T	T	T	T
		1	1	1	2	2	2	3	3	3
		a	b	c	a	b	c	a	b	c
Sip=1955932.92 ari										
KODI HILUC S	SHFRYTËZIMET E LEJUARA									
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë parasheh zhvillimin bujqësor dhe pyjor përfshirë edhe mbrojtjen e tokës bujqësore dhe pyjore nga zhvillimi jo-bujqësor që mund të kërcënimin e zhvillimit të ardhshëm të bujqësisë dhe pylltarisë. Në këtë zonë lejohen shfrytëzime tjera (dytësore) të cilat nuk e pengojnë shfrytëzimin kryesor (bujqësinë)										
1.1.1	Prodhim bujqësor komercial				X	X	X	X	X	X
1.1.3	Infrastrukturë bujqësore									
1.2	Pylltari	X	X	X				X		X
1.5	Prodhimtari tjetër kryesore		X	X	X	X	X	X	X	X
SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE										
5.1	Shfrytëzim I përhershëm banimi			X	X	X	X	X	X	X
5.2	Shfrytëzim banimi me destinime tjera në pajtueshmëri				X	X	X	X	X	X
3.1.1	Shërbime tregtare të shitjes me shumicë dhe pakicë (që mbështet ekonominë bujqësore lokale				X	X	X	X	X	X
3.3	Shërbime komuniteti				X	X	X	X	X	X

⁵ Ligji Nr.02/L-26 për tokën bujqësore

4.1.1	Transport rrugor	X	X	X	X	X	X	X	X	X
1.1.2	Infrastrukturë bujqësore							X	X	X
4.3.4	Infrastrukturë e ujitjes				X	X	X	X	X	X
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA										
1.3	Miniera dhe gurore				X	X	X			
1.4	Akuakulturë dhe peshkim	X		X	X	X				
1.5.2	Menaxhim i kafshvë shtegtare									
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME										
1.5.3	Mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore, blegtorale									
	shërbim argëtues dhe rekreativ (panairë, festivale)	X	X	X	X	X	X	X	X	X
SHFRYTËZIMET E NDALUARA										
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara									

Tab. 26. Zona bujqësore- shfrytëzimet e tokës

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat bujqësore

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA BUJQËSORE	Simboli i zonës ZP	
	Ndërtesat bujqësore- Sip=1942.011ari		
Ndërtesa bujqësore, ferma dhe ndërtesa përcjellëse për bagëti, shpezëtarë, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore si psh depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore , plemë, hambar, ahur . Garazha, hangar dhe ndërtesa tjera për vendosjen e mjeteve dhe makinave bujqësore si dhe ndërtesa tjera ndihmëse bujqësore		Ndërtesa bujqësore- Kategoria I	Ndërtesa bujqësore- Kategoria II
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (min)	800 m2	5000 m2
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	/	/
Vijat	Vija rregulluese	sipas profilin rrugor	
Lartësia	Lartësia (max)	7 m	25 m
Intensiteti	ISHPKZH	40%	40%
	ISN	0.5	0.5
Vendparkime	Në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme		

Formësimi arkitektonik dhe estetik	Materiali i ndërtësive mund të jetë nga betoni , druri apo metali. Inkurajohet përdorimi i elementeve çmontuese si dhe nga materiale të cilat janë natyrore dhe të ripërdorshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtësës
Tjera	Distanca- në rastet ku ka banim dhe shtallë për bagëti distancat duhet të jetë: min 50 m' nëse shtallat përdoren për konsum komercial dhe min 15 m' nëse shtallat përdoren për konsum vetanak Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi i qasjes për ndërtësë bujqësore të behët para zhvillimit të parcelës

Tab. 27 Kushtet ndërtimore për ndërtësat bujqësore

Masat mbrojtëse


Masat mbrojtëse nga breshëri- Ekzistojnë dy mënyra për mbrojtjen nga breshëri. Mënyra e parë dhe më efektive sipas ekspertëve, është riaktivizimi i sistemit raketor për shpërndarjen e reve, dhe mënyra e dytë është mbrojtja e parcelave të punueshme bujqësore me rrjeta mbrojtëse nga breshëri.

Për sistemin e parë kompetent është niveli qendror, respektivisht MBPZHR. Prandaj duhet të ndërmerren iniciativa që në bashkëpunim me këtë ministri dhe me institucionet e tjera përgjegjëse të bëhen përpjekje për tejkalimin e problemeve për realizim sa më të shpejtë të këtij sistemi.


Ndërsa në anën tjetër i mbetet komunës që të përkrahë fermerët në subvencionimin e rrjetave mbrojtëse nga reshjet e breshërit, si masë shumë e rëndësishme për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë.

Si masa të përgjithshme, për mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, janë:

- Zbatimi i të gjitha detyrimeve ligjore që dalin nga korniza ligjore në fuqi, e për të cilat është kompetent Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal.
- Ngritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, të shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
- Sigurimi i hapësirave të nevojshme për strehim në rast të evakuimit të banorëve dhe kafshëve nga zonat e rrezikuara.
- Sigurimi i strehimoreve publike nga qeverisja vendore, me ndihmën ose subvencionimin e qeverisë qendrore



Harta 1 Klasifikimi i tokës bujqësore



Harta 2 Shfrytëzimi i tokës bujqësore

5.7 ZONA PYJORE- ZP

Sipas UA 08/2017, toka pyjore apo pylli paraqet tokën e mbuluar me pemë pyjore në formë të grumbullit pyjor që përfshihet dhe bashkësitë bioekologjike, me sipërfaqe më të madhe se dhjetë ari⁶. Pyjet, sipas llojit, janë të ndara në: pyje të larta, të ulëta dhe me bimësi. Të tri këto kategori gjenden në komunën e Istogut.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara për tokën pyjore janë paraqitur përmes 3 tërësive hapësinore kryesore dhe nëntërësive të prezentuara në kapitullin 2.0 Arsyetimi.

ZP	ZONË PYJORE- ZP	T1- BJESHKA			T2- RRËZA			T3- RRAFSHI		
		T		T	T		T	T		T
		1 a	T1 b	1 c	2 a	T2 b	2 c	3 a	T3 b	3 c
Sip= 2216872.87 ari										
KODI HILUC S	SHFRYTËZIMET E LEJUARA									
Arsyetimi dhë qëllimi: Kjo zonë parasheh zhvillimin pyjor përfshirë edhe mbrojtjen e tokës pyjore nga shpyllëzimi që mund të jetë kërcënim për zhvillimin të ardhshëm të pylltarisë. Në këtë zonë lejohen shfrytëzime tjera (dytësore) të cilat nuk e pengojnë shftrtëzimin kryesor.										
1.2.1	Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër	X	X	X				X		X
1.2.3	Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshmë	X	X	X				X		X
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE									
1.5.3	Mbledhja e produkteve natyrore	X	X	X				X		X
1.1.1	Prodhim bujqësor komercial	X	X	X	X	X	X	X	X	X
4.1.1	Infrastrukturë e transporti rrugor	X	X	X	X	X	X	X	X	X
3.4.4	Turizëm natyror ZrT-tn	X	X	X						X
3.4.1	Turizëm kulturor ZrT-tn dhe rural ZrT-tr	X	X		X	X	X	X	X	X
3.4.2	Turizëm shëndetësor- ZrT-sh							X		
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA									

⁶ UA 08/2017, mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, fq.55

1.5.1	Gjuetia ZrT-gj	X								
3.4.4	Speleoturizëm ZrT-st		X							
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME									
5.3	Kampingje për pushim ZB-kp	X	X	X				X		
5.3	Banim tjetër- stane ZB-s		X	X						
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA									
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara									

Tab. 28 Zona Pyjore- shfrytëzimet e tokës

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA PYJORE	Simboli i zonës
	Ndërtesa mbështetëse të pylltarisë	ZP
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (min)	300 m ²
	Pjesa e përparme e parcelës (min)	5 m
Vijat	Vija rregulluese	5 m
Lartësia	Lartësia (max)	4.0 m
Intensiteti	ISHPKZH	50%
	ISN	0.5
Vendparkime	Në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Ndërtesat duhet të jenë nga elemente çmontuese si dhe nga materiale të cilat janë natyrore dhe të ripërdorshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit	
Tjera	Siguria nga zjarri- në përputhje me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Pyjet e Kosovës si dhe udhëzimin administrativ për mbrojtjen e pyjeve Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sipas kushteve zhvillimore të përgjithshme	

Tab. 29 Kushtet ndërtimore për ndërtesat mbështetëse të pylltarisë

Masat mbrojtëse

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore- bëhet përmes:

- Mbrojtjes së tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj tokë për shfrytëzime tjera jo-pyjore;

- Mbrojtjes dhe rregullimit të tokës pyjore përmes pyllëzimit- krijimii një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore në një tokë ku nuk kishte pyll.
- Mbrojtjes dhe rregullimit të tokës pyjore përmes rpyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore në formë të natyrshme ose artificiale.

5.8 ZONA MINIERE-SIPËRFAQËSORE- ZMS

Ndërtimi gjeologjik I territorit të komunës së Istogut përfaqësohet nga këto formacione litologjike:

- kuarternar (Holoceni)- Aluvione, proluvione
- Kuaternar (Pleistoceni)- zhavorr, rërë, tuf gëlqeror/ travgertinë, sediment lumore dhe liqenore
- Neogjen (Pliocen, Pliocen I sipërm)- argjilë, rërë, zhavorr, pjesërisht tufite dhe linjit
- Neogjen (Pliocen, Pliocen I poshtëm)- argjilë, rërë, zhavorr, mergel, pjesërisht linjit
- Neogjen (Miocen, Miocen I sipërm)- zhavorr, rërë, argjilë, mergel, gëlqeroro mergelor
- Jurastik (gëlqeror I rikristalizuar dhe olistolite mermeri)
- Jurastik, Jurastik I mesëm- sipërm- rreshpe sericitike, filite, rreshpe graffiti, mataranor, konglomerade kuarci
- Triastik (triastik I sipërm)- gëlqeror, dollmit
- Triastik (triastik I poshtëm)- gëlqeror, dollmit, brekçie
- Paleozoik, Paleozoik I sipër- rreshpe të gjelbërta, filite, metadeltinite, strallor
- Ngjarjet Jurastike- Jurastik I mesëm, I sipërm, seria vullkano- sedimentare (keratofire, kuarckeratofire, diabaz, gabbro, shkëmbinjë piroklastik
- Ngjarjet Paleozoike- metakuarcporfir⁷

⁷ Komisioni I Pavarur për Miniera dhe Minerale, Dok. 451/26.02.2021




Fig. 9 Harta gjeologjike e komunës së Istogut (burimi: Komisioni I Pavarur për Miniera dhe Minerale, dok. 451/26.02.2021)




Fig. 10 Harta e menraleve në komunën e Istogut (burimi: KPMM, dok. 451/26.02.2021)

Zona minierë sipërfaqësore është zona në të cilën zhvillohet aktiviteti i prodhimit të rërës, gurëthyes etj. Në komunën e Istogut, sipas hulumtimit në terren guroret të cilat operojnë gjenden në vendbanimet: Cërrcë, Vrellë, Lubozhdë dhe Synejë. Sipërfaqet se ku mund të zhvillohen këto aktivitete janë të prezentuara përmes hartës së licencave dhe lejeve për aktivitetet e veçanta.




Fig. 11 Licencat dhe lejet për aktivitete të veçanta (burimi: KPMM, dok. 451/26.02.2021)

Shfrytëzimet e lejuara dhe të veçanta për zona të minierave sipërfaqësore

ZmS	ZONË MINIERE SIPËRFAQËSORE- ZmS
	Sip=5667.50 ari
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsytimi dhe qëllimi: Në këtë zonë bëjnë pjesë zonat e miniereave dhe guroreve të cilat operojnë ose kanë mundësi operimi në bazë të planeve të nivelit qëndror. Kjo klasë përfshinë gurore të gurit dhe minierë apo gurore tjetër.	
1.3.3	Gurore

	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
4.1.1	Transport rrugor
4.2	Shërbime logjistike dhe depo

Mbrojtja e zonave

UA nr.08/2017 ka paraqitur një listë masash e cila lidhet me ndalimin e planifikimit apo ushtrimit të ndonjë veprimtarie mbi shfrytëzimin e resurseve minerare në ndonjë sipërfaqe që:

- Ndodhet 200 m ose më afër nga kufiri I një vendbanimi
- Ndodhet 250 m ose më afër nga ndonjë shtëpi, ndërtesë e banuar ose përkohësisht e pabanuara
- Ndodhet 20 m ose më afër nga ndonjë tokë e pastruar ose lëvruara ose në ndonjë mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore, ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur batësi I licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë
- Ndodhet 200 m ose më afër nga ndonjë pendë ose rezervuara
- Ndodhet 150 m ose më afër ndonjë termocentrali, largëpërçuesi (35 KË ose më lartë) ose lumi
- ndodhet 100 m ose më afër na varrezat
- ndodhet 100 m ose më afër nga ndonjë monument antic ose kombëtar I mbrojtur me ligj
- ndodhet brenda parkut komebtar apo komunal të mbotjru me ligj
- ndodhet 500 m ose më afër nga ndonjë ndërtesë e banimit ose institucionale dhe publike , nëse përdoret eksploziv.

Gjatë analizës në terren janë identifikuar një pjesë e konsiderueshme e zonave miniere sipërfaqësore. Harta zonale ka marrë parasysh vetëm ato, të cilave iu lejohej ushtrimi I aktiviteteve me licencat e lëshuara nga institucionet përkatëse si dhe ka marrë parasysh vetëm ato zona miniere sipërfaqësore të cilat e plotësojnë kriterin e distancës ndaj entiteteve të përcaktuara me masat mbrojtëse. Në hartën zonale respektivisht tek instruksionet e zonimit janë specifikuar distancat (buffer zonat) prej 250 m dhe 500 m. Gjithashtu një krahasim mes gjendjes aktuale të zonave ekzistuese të minierave sipërfaqësore dhe atyre më lejim ushtrimi të veprimtarive të tyre mund të shihet në bazën e të dhënave GIS.

5.9 SIPËRFAQE E MBROJTUR- SM

Në komunën e Istogut ndër sipërfaqet e mbrojtura bëjnë pjesë:

- Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” I cili përfshihet në vendbanimet: Kaliçan, Studenicë, Vrellë, Lubozhdë dhe paraqet vlerë të mbotjura të natyrës në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare⁸
- Park pylli në Dobrushë I cili paraqet një zonë natyrore pjesërisht artificiale të tokës me karakteristika ekologjike të rëndësishme në shkallë lokale.
- Shpella në Vrellë- një monument gjeomorfologjik I rëndësisë kombëtare e cila duhet hulumtuar më tutje
- Kompleksi I trungjeve në Cërkolez që paraqet një monument të arkitekturës së peziashit repsketivisht një grup trugjesh të cilat kanë vlerë të madhe estetike, kulturore-historike dhe ekologjike në nivel komëbtar dhe local.

ZP- 1

SIPËRFAQE E MBROJTUR- SM

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Përfshinë zonën e cila është e përcaktuar për qëllime të ruajtjes së burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, mbrojtje nga ndotja e mjedisit . Këto sipërfaqë janë të përcaktuara nga planet e nivelit qëndror.	
3.4.4	Park Kombëtar- SM-PK
	Park pylli- SM-PP
	Shpellë- SM-SH
	Kompleks trungjesh- SM-KT
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
	Masa mbrojtëse me karakter biologjik dhe teknik të opërcaktuara nga autoriteti përgjegjës
	Punë teknike të cilat janë në funksion të sipërfaqes së mbrojtur
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE
	Veprimtari të cilat kanë qëllim hulumtimi, mbledhje e të dhënave profesionale apo mbikqyrje për zbatim të masave
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
	Mjetet për mbrojtjen e florës dhe faunës në pajtim me ligjet në fuqi
3.4.5	Shërbime tjera rekreative
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të përcaktuara varësisht prej kategorisë së monumentit

Tab. 30. Shfrytëzimet e tokës të sipërfaqet e mbrojtura

⁸ Ndërkombëtare (shkalla e rëndësishme) - sepse është pjesë e “European Green Belt”.

Në zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës, si psh Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, i cili në komunën e Istogut përfshinë vendbanimet Kaliçan, Studenicë, Vrellë, Lubozhdë, aktivitetet të cilat lejohen apo ndalohen do të rregullohen me Planin Hapësinor për këtë park⁹.

Park pylli (Dobrushë)- Në këtë park lejohen:

- Veprimtari ekonomike dhe aktivitete tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristika e rëndësishme që e ka.
- Veprimtaritë rekreative-sportive

Në park pyll nuk lejohen:

- Ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës
- Ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve
- Deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura
- Përdorimi i të mirave të pylli për qëllime ekonomike
- Vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera
- Aktivitete të tjera të cilat mund të rrezikojnë vlerën e mbrojtur të pyllit.

Shpellë (Vrellë)- Monument natyror geomorfologjik i cili duhet të eksplorohet më tutje.

Ndalesat në objektet speleologjike:

- Ndalohet dëmtimi, shkatërrimi, bartja e shtresimeve të mineraleve ose fosileve, bota e gjallë e objektit speleologjik, gjetjet arkeologjike dhe gjetjeve të tjera.
- Ndalohet ndryshimi i kushteve të “vendbanimit “në objekt (brendi të shpellës) ose në afërsi të tij.
- Për të gjitha aktivitetet në shpellë duhet të merret leja nga Ministria e veçanërisht për:
 - shfrytëzimi dhe rregullimi i objektit speleologjik dhe pjesëve të tij
 - hapja dhe/ose mbyllja e hyrjes/ daljes në objektin speleologjik, si dhe për ndërtimin, përtëritjen ose sanimin e çdo objekti nëntokësor
 - kryerja e hulumtimeve shkencore dhe profesionale
 - zhytja në objekt speleologjik
 - xhirimi i filmave në objekt speleologjik
 - punët dhe veprimtarisë të cilat ndikojnë në veçoritë themelore, në kushtet dhe florën e faunën natyrore në objektin speleologjik ose në mbi sipërfaqen e tij
 - vizitat e organizuara dhe fotografimi në objektet speleologjike duhet të bëhet me lejen e administratës së objektit speleologjik

⁹ Listwn pwrfundimatare dhe valide me aktivitetet qw lejohen dhe ato qw ndalohen nw park do t’a jep Plani Hapwsinor i Parkut Kombwtar “Bjeshkw e Nemuna” nga momenti i hyrjes sw tij nw fuqi”.

- Për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale, shoqatave speleologjike mund t'i lëshohet leja një (1) vjeçarë
- Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës.

Kompleks trungjesh (Cërkolez)- monument I arkitekturës së peizazhit. Në sipërfaqen e monumentit të arkitekturës së peizazhit lejohen:

- Aplikimi i masave mbrojtëse me karakter biologjik dhe teknik sipas kushteve të pëcaktura nga autoriteti përgjegjës
- Të gjitha punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit

Në sipërfaqen e monumentit të arkitektuërës së peizazhit ndalohe:

- Prerja e trungut, thyerja e degëve, këputja e gjetheve apo frutave, kositja e barit si dhe të cfarëdo aktiviteti që e ndryshon gjendjen e tij
- Ndezja e zjarrit
- Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur
- Ndryshimin e pamjes së sipërfaqes së mbrojtur
- Grumbullimi i mbeturianve në sipërfaqen e mbrojtur
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen së mbrojtur

Në zonën buferike ndalohe:

- Rrjedhja e ujërave të ndotura, deponimi i mbeturianve dhe mbetjeve të tjera
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike
- Ndërrimi i kulturës
- Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit

5.10 ZONA E VEÇANTË E MBROJTUR- ZVM

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara

ZVM		ZONË E VEÇANTË E MBROJTUR- ZVM
Sip=9563.767 ari		
HILUCS Kodi i shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA	
Arsyetimi dhe qëllimi: Në këtë zonë përfshihen të gjitha zonat e themeluara me Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Këtu bën pjesë klasa e shërbimeve kulturore respektivisht hapësira të cilat shfrytëzohen për ofrimin e shërbimeve artistike, vende historike dhe shërbime të tjera kulturore.		
3.4.1	Shërbim kulturor	Manastir- ZVM-M

		Kishë- ZVM-K
		Lokalitet arkeologjik- ZVM-A
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE	
	Struktura përcjellëse në funksion të monumentit	
	Struktura informuese si kiosqet apo tabelat për informim	
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	
	Aktivitete turistike promovuese	
	Veprimtaritë bujqësore (me leje të veçantë)	
	Infrastrukturë rrugore lokale dhe shërbime publike të nevojshme	
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME	
	Shërbim tregtar me pakicë (produkte artizanale, suvenire, produkte të vendit etj)	
	Objektet e përkohshme gjatë organizimeve promovuese (tenda, bina, karriga, tavolina etj)	
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA	
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara	

Masat mbrojtëse:

Në zonat e veçanta të mbrojtura si -Manastiri i Gorioçit në Istog, Manastiri I Virgjëreshës së Shënjtë të Hvosnos në Studenicë, Kisha e Shën Nikollës në Gurakoc, ndalohen apo kufizohen aktivitetet si në vijim:

- Aktivitet e ndaluara janë:

- Ndërtimet apo zhvillimet industrial, si gjërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimii pendave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite;
- Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzim apo ndotjen e mjedisit

- Aktivitetet e kufizuara janë:

- Strukturat ose ndërtesat më të larta se monumenti kulturore që duhet të mbrohet
- Ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoraneve, bareve, kafeneve, hoteleve/ moteleve, tezgave dhe kiosqeve ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës apo ndonjë ndërtimi tjetër.
- Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike
- Transformimi i tokës bujqësore.

Në zonat e vecanta të mbrojtura me vlera arkeologjike si Manastiri I Virgjëreshës së Shënjtë të Hvosnos në Studenicë, Kisha e Shën Nikollës në Gurakoc dhe Manastiri i Gorioçit në Istog,

- Strukturat ose ndërtesat më të larta se monumenti kulturore që duhet të mborjhet
- Ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoraneve, bareve, kafeneve, hoteleve/ moteleve, tezgave dhe kiosqeve ushqimore, stacioneve të karburanteve

dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës apo ndonjë ndërtimi tjetër.

- Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike
- Transformimi i tokës bujqësore.

Në zonat e vecanta të mbrojtura me vlera arkeologjike si Manastiri i Virgjëreshës së Shënjtë të Hvosnos në Studenicë, Kisha e Shën Nikollës në Gurakoc dhe Manastiri i Gorioçit në Istog, ndalohet ndërtimi iedhe i deponive të mbeturinave. Në lokacionin ku ndërtohet apo planifikohet deponia e mbeturinave, paraqitet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zonat e vecanta të mbrojtura.

5.11 ZONA E VEÇANTË - ZV

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të vecanta, të përkohshme dhe të ndaluara

ZV

ZONË E VEÇANTË - ZV

Sip=1058122.14 ari

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë përfshinë zonat të cilat kanë veçori specifike dhe të cilat kërkojnë regjim të posaçëm organizativ, të përdorimit dhe mbrojtjes së zhvilluar nga plane të nivelit qeveritar. Këtu bëjnë pjesë sipërfaqet e linjtit (kjo sipërfaqe nuk shfrytëzohet për nxjerrje të linjit deri në hulumtimet në të ardhmen), hapësira të shfrytëzuara për shprëndarjen e energjisë elektrike, shërbime të mbrojtjes së sigurisë sociale (FSK) dhe shërbim tjetër (Qendra Korrektuese).	
1.3.1	Pasuri nëntokësore- ZV-PN
4.3.1	Trafostacioni - ZV- T
3.5	Qendra korrektuese- ZV-QK
3.3.1	Forca e Sigurisë së Kosovës- ZuS
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE
4.1.1	Transport rrugor
4.3	Shërbime publike


Tab. 31. Shfrytëzimi i tokës - zona e veçantë

Zona e veçantë ZV-PN pasuritë nëntokësore përfshijnë :

- Oniks, oniks-travertinë, travertinë (Bajë, Bajicë)
- Thëngjill (Zallq, Zabllaq, Drejë, Osojan, Polanë, Shalinovicë)

Në zonat e rezervave minerale dhe të fushave të eksploatimit ndalohet planifikimi apo ushtrimi i ndonjë veprimtarie mbi shfrytëzimin e resurseve minerale të ndonjë sipërfaqe e cila nuk është e përfshirë në sipërfaqen e lejuar lëshuar nga dokumenti zyrtar i institucionit

Zona e veçantë, Qendra Korrektuese ZV-QK Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të ndërtesave të kësaj kategorie jipen sipas udhëzuesve dhe manualeve për shërbimet e tilla dhe përcaktohen nga institucionet përkatëse.



73

5.12 SIPËRFAQET UJORE DHE ZONAT E MBROJTURA SANITARE TË BURIMEVE TË UJIT

Komuna e Istogut ka rrjet të zhvilluar hidrografik. burimet ujore të tij ndahen në:

- Burime ujore nëntokësore:
 - burime me akuifer karstik në të cilën bëjnë pjesë burimi I Istogut dhe I Vrellës
 - burime me akuifer intergranular në të cilën bën pjesë burimi I ujit termal në Banjë
- Burime ujore sipërfaqësore:
 - Ujërrjedha të hapura në të cilën bëjnë pjesë lumi I Istogut, lumi I Vrellës dhe Drini I Bardhë (si vijë kufizuese) , si dhe rrjedha tjera ujore me rendësi siç janë: Shushica, Përroi I Keq, Çausi, Bllagaça dhe lumi I Renovcit.

SU-1

SIPËRFAQE UJORE- SU

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Këtu bëjnë pjesë të gjitha sipërfaqet ujore duke filluar nga lumenjtë, burimet ujore, akumulues uji si dhe hapësirat tjera ujore si psh bazene që përdoren për mbarsjen dhe rritjen e peshkut.	
	Lum-SU-L (lumi I Istogut dhe lumi I Vrellës)
1.4.1	Akuakulturë- SU-A (Istog, Vrellë)
2.4.4	Burim uji- ZmU-BU (Burimi I Istogut dhe burimi I Vrellës)
3.3.3	Ujë termal- ZmU-UT (burimi I ujit termal në Banjë)
6.3.2	Akumulues uji-SU-AU
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
	Infrastruktura rrugore (ura, rrugë etj)
	infrastrukturë për mbrojtjen dhe rregullimin e ujërave
	infrastrukturë për mbrojtjen e natyrës
	Infrastrukturë për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike, biologjike të ujërave sipërfaqësor
	Infrastrukturë për mbrojtjen e ujërave nga ndotja
	Infrastrukturë për nevojat të organeve shtetërore që kanë të bëjnë me biodiversitetin si dhe të ngjajshme.
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
1.4.3	Peshkim profesional- SU-P
	Pushim dhe rekreacion të përcaktuara me nga autoriteti I rajonit të pellgjeve lumore me kërkesë të komunës
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA

	Ekspoatimi I rërës dhe zhavorrit. Përfashtim bëjnë rastet nëse ato shfrytëzohen për mirëmbajtjen e rrjedhave ujore
	Ndrrimi I rrjedhës së ujit (goftë sipërfaqësor apo nëntokësor) përveç në rastet kur e lejon MMPHI
	Gërmimi apo deponimi I dheut, rërës, zhavorrit apo materialeve të tjera përgjatë brigjeve të lumënjtëve
	Ndërtimi I objekteve të cfarëdo funksioni në distancë më të vogël se 10 m2 nga skaji I shtratit të rrjedhës ujore

Tab. 32. Shfrytëzimet e lejauro në sipërfaqet ujore

Në komunën e Istogut ekzistojnë tre burime të ujit të cilat kanë statusin e mbrojtjes: burimi I I ujit të pijshëm ZmU-BU në Istog dhe Vrellë si dhe burimin e ujit termal ZmU-UT në Banjë.

ZmU

ZONË E MBROJTUR UJORE- ZmU

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë përfshinë zonat të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e burimeve të ujit dhe ndërtesave me instalime për marrjen e ujit apo të mbrojtjes së burimeve nga shakrkime të ndotëseve që mund të ndikojnë drejtpërdrejtë nga aktivitetet e njeriut.	
2.4.4	Burim uji- ZmU-BU
3.3.3	Ujë termal- ZmU-UT
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
	Objekte dhe stabilimente që kanë funksion mbrojtës së burimit ujor
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE
	Veprimtari me qëllime hulumtuese, mbledhje e të dhënave profesionale dhe mbikqyrje për zbatim
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
	Mjete për mbrojtjen e bimëve dhe plehurat minerale që mund të përdoren në pajtim me ligjet në fuqi
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të përcaktuara në zonat përkatëse mbrojtëse I, II dhe III

Tab. 33. Shfrytëzimi i tokës te zona e mbrojtur ujore

Zonat e mbrojtura sanitare në burimet nëntokësore në akuifer intergranular- Burimi I ujit termal në Banjë

Zona e kufizimit- Zona I-rë:

- Kufiri I zonës së I-rë duhet të jetë së paku 10 m nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe objekteve përcejllëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit

- Zona e I-rë e mbrojtur sanitare duhet të jetë l rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile e cila duhet të jetë e lartë së paku 2 m, në mënyrë që të pengohet hurja e shtazëve apo personave të paautorizuar.
- Kufiri I zonës së I-rë të shënohet me shenjat e përcaktuara në shtojcën 1 të UA.MMPH.2015/2017.

Masat mbrojtëse për zonën e I-rë:

- Ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirembajtjen e sistemit të furnizimit me ujë
- Mund të bëhet kultivimi I barit pa përdorimin e plehrave dhe materialeve tjera që mund të rrezikojnë cilësinë e ujit
- Punimi I rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që të mos rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

Zona e Kontrolluar- Zona e II-të:

- Kufiri I zonës së II-të mbrojtur për burime dhe puse të jetë së paku 100 m nga zona e I-rë mbrojtëse
- Kufiri I zonës së II-të të shënohet me shenjat e përcaktuara në shtojcën 1 të UA.MMPH.2015/2017.

Masat mbrojtëse për zonën e II-të:

- Ndalohen të gjitha aktivitetet dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin si psh:
 - përdorimi I plehrave kimike dhe atyre të kafshëve,
 - përdorimi I pesticideve, herbicideve dhe insekticideve,
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi I puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi I fermave të shpezëve dhe kafshëve
 - ndërtimi dhe puna e reparteve industrial
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi I tubacioneve që transportojnë material kimike, karburante, vajra dhe material të tjera të rrezikshme
 - transporti I materialeve radioactive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrëve dhe materialeve tjera të rrezikshme
 - eksploatimi I rërës dhe zhavorrit
 - aktivitet të tjera të cilat konsiderohen se mund të kenë pasoja negative në burim të ujit

Zona e III-të- Zona e mbikëqyrur:

- Kufiri I zonës së III-të është së paku 500 m nga vepra ujëmarrëse.

Masat mbrojtëse për zonën e III-të:

- Në hapësirën e zonës së III_të ndalohet kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit si psh:
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura të kanalizimit
 - Ndërtimi idhe operimi i reparteve industrial dhe zejtare me teknologji të papastër
 - Deponimi i përkohshëm apo i përhershëm i mbeturinave
 - Përpunimi, deponimi apo manipulimi me material kimike, karburante, vajra dhe material tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit
 - Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorim, përpunim apo deponim të mbeturinave të rrezikshme
 - Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe material të tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së tyre në ujëra nëntokësore
 - -deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujitn
 - Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i atyre ekzistuese

Zonat e mbrojtura sanitare në burimet nëntokësore në akuifer karstik- Burimi i ujit në Istog dhe burimi i ujit në Vrellë

Zona e I-rë- zona e kufizimit:

- Kufiri i zonës së I-rë duhet të jetë së paku 20 m nga vepra ujëmarrëse.
- Zona e I-rë e mbrojtur sanitare duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile e cila duhet të jetë e lartë së paku 2 m, në mënyrë që të pengohet hurja e shtazëve apo personave të paautorizuar.
- Kufiri i zonës së I-rë të shënohet me shenjat e përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të nennit 10 të UA.MMPH.15/2017.

Masat mbrojtëse për zonën e I-rë të (akuifer karstik):

- Ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirembajtjen e sistemit të furnizimit me ujë
- Mund të bëhet kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materialeve tjera që mund të rrezikojnë cilësinë e ujit
- Punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që të mos rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

Zona e Kontrollit- Zona e II-të:

- Kufiri i zonës së II-rë duhet të jetë së paku 500 m nga vepra ujëmarrëse.

Ndalesat në zonën e II-të të mbrojtur sanitare:

- Ndalohen të gjitha aktivitetet dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin si psh:
 - përdorimi i plehërave kimike dhe atyre të kafshëve,
 - përdorimi i pesticideve, herbicideve dhe insekticideve,
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve
 - ndërtimi dhe puna e reparteve industrial
 - ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë material kimike, karburante, vajra dhe material të tjera të rrezikshme
 - transporti i materialeve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrëve dhe materialeve tjera të rrezikshme
 - eksploatimi i rërës dhe zhavorrit
 - aktivitet të tjera të cilat konsiderohen se mund të kenë pasoja negative në burim të ujit

Zona e regjimit të lehtë të mbrojtjes dhe mbikqyrjes – zona e III-të:

- Kufiri i zonës së III-të sanitare duhet të jetë së paku 1000 m larg veprës ujëmarrëse në drejtim të rrjedhjes së ujit.

Ndalesat në zonën e III-të si ato të përcaktuara në zonën e II-të.

5.13 ZONË E NDIKUAR NGA VËRSHIMET- ZNV

Masat që duhet të ndërmerren për mbrojtje nga vërshimet duhet të përfshijnë:

- Hapjen dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve kryesor, në mënyrë që të evitohen vërshimet në rast të reshjeve të mëdha dhe shkrirjes së borës. Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe mirëmbajtja e tyre, mundëson pranimin e sasisë së plotë të ujit në periudhat me intenzitet të madh të reshjeve.
- Të ndërtohen penda mbrojtëse/argjinatura për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjë e bjeshkëve përgjatë vendbanimeve që shtrihen rrëzë bjeshkëve të komunës. Duhet të bëhet vlerësim se cila është mënyra e duhur e ndërtimit dhe lokacionet e nevojshme përgjatë këtij brezi vendbanimesh. Gjatë hartimit të planeve të tilla duhet t'i kushtohet rëndësi edhe ndikimeve në mjedis, respektivisht mbrojtjes së biodiversitetit dhe respektimin e të gjitha dokumenteve relevante të të nivelit qendror dhe lokal, në zonat ku planifikohen masa të tilla.



Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara

Kufijtë e shtrirjes së këtyre sipërfaqeve përcaktohen nga sektori përkatës në bashkëpunim me sektorin e planifikimit hapësinor dhe si të tilla paraqiten në dokumentet e planifikimit. Ky përcaktim bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara përmes ligjeve përkatëse. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtur përcakton mbrojtjen afat-gjate dhe konservimin e një zone gjeografike me karakteristika të veçanta të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike, peizazhet kulturore me potencial të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit.

Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtur përfshin perimetrin e vend-shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojtje dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri.

ZmaH	ZONË E MBROJTUR ARKEOLOGJIKE-HISTORIKE- ZmaH
	Sip=1284.969 ari
HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë përfshinë sipërfaqet dhe ndërtesat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe janë pjesë e territorit të cilat përmbajnë karakteristikat dhe vlera të posaçme historike, artistike, trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike si dhe mjedisore urbane.	
3.4.1	Lokalitet arkeologjik- ZmaH-l
3.4.1	Vendbanim parahistorik- ZmaH-vp
3.4.1	Tumë ilire- ZmaH-ti
3.4.1	Gërmadhë e kishës- ZmaH-gk
3.4.1	Kishë- ZmaH-k
3.4.1	Xhami- ZmaH-xh
3.4.1	Kullë- ZmaH-kl
3.4.1	Shkollë- ZmaH-sh
3.4.1	Truall- ZmaH-t
3.4.1	Mulli- ZmaH-m
3.4.1	Urë- ZmaH-u
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE
	Struktura përcjellëse në funksion të monumentit
	Struktura informuese si kiosqet apo tabelat për informim
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
	Aktivitete turistike promovuese
	Veprimtaritë bujqësore (me leje të veçantë)
	Infrastrukturë rrugore lokale dhe shërbime publike të nevojshme
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PÛRKOHSHME
	Shërbim tregtar me pakicë (produkte artizanale, suvenire, produkte të vendit etj)
	Objektet e përkohshme gjatë organizimeve promovuese (tenda, bina, karriga, tavolina etj)
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve janë të ndaluara

Tab. 34. Shfrytëzimet e tokës te zona arkeologjik-e historike

I. Kategoria : Trashëgimia arkeologjike			
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël	Periudha	Vend-ndodhja
1	Manastiri i Goriçit	Mesjetë	Istog
2	Kisha e Shën Nikollës në Gjurakoc	Mesjetë	Gjurakoc, Istog
3	Kisha e Shën Gjonit	Mesjetë	Cërkolez, Istog
4	Ura e gurit në Zallç	Antikë , Mesjetë	Zallç, Istog
5	Gërmadhat e Manastirit "Hvosna"	Antikë e Vonë, Mesjetë	Studenicë, Istog
B	Nënkategoria: Lokalitete Arkeologjik / Rezervat		
1	Tuma në afërsi të Restorant Trofta - Istog	Parahistori	Istog
2	Tuma Ilire (Në oborrin e Kishës së Shën Pjetrit dhe Shën Palit)	Parahistori	Istog
3	Manastiri i Virgjërshës së Shenjtë të Hvosnos	Mesjetë	Vrellë, Istog
4	Shpella e Hoxhës në Vrellë	Antikë	Vrellë, Istog
5	Kisha paleokristiane në Vrellë	Antikitete i Vonë	Vrellë, Istog
6	Lokalteti arkeologjik-Fortesa në Vrellë	Antikitete i Vonë	Vrellë, Istog
7	Varret e vjetra me lisi shëkullor në Carrallukë	Mesjetë	Carrallukë, Istog
8	Gërmadhat e Kishës me varret e vjetra në Belicë	Mesjetë	Belicë, Istog
9	Gërmadhat e Kishës me varre në potesin Voçarë	Mesjetë	Dobrushë, Istog
10	Gërmadhat e Kishës paleokristiane në Bajicë	Mesjetë	Bajicë, Istog
11	Martiriumi paleokristian i Banjicës	Antikitete i Vonë	Bajicë, Istog
12	Gradina në fshatin Cërkolez	Parahistori	Cërkolez, Istog
13	Kishë e antikitetit dhe varrezë mesjetare "Te Qarrat"	Antikë	Cërkolez, Istog
14	Vendbanim parahistorik dhe antik "Arat e Hanit"	Parahistori, Antike	Cërkolez, Istog
15	Lokalteti i periudhës romake në Cërkolez	Romake	Cërkolez, Istog
16	Quka e Madhe, kështjella antike në Sine	Antikë	Sine, Istog
17	Tumat Ilire në Lubozhdë (Nëngurë)	Parahistori	Lubozhdë, Istog
18	Vendbanim Parahistorik në Lubozhdë	Parahistori	Lubozhdë, Istog
19	Lokalteti i periudhës romake në Kaliqan	Romake	Kaliqan, Istog
20	Lokalteti i periudhës romake në Cërcë	Romake	Cërcë, Istog
21	Vendbanimi neolitit në Rakosh	Parahistori	Rakosh, Istog

Tab. 35. Trashëgimia arkeologjike

II. Kategoria : Trashëgimia Arkitekturore			
C	Nënkategoria: Monument /Ansambël		
1	Kulla e Sali Bajram Dreshaj	Shek XIX	Istog
2	Kulla e Hasan Rexhë Salihaj	Shek XIX	Istog
3	Xhamija e vjetër e Istogut	1730	Istog
4	Xhamia në fshatin Kaliçan	Shek. XIX	Kaliçan, Istog
5	Kulla e Lash Ukaj	Shek. XIX	Kaliçan, Istog
6	Shkolla fillore	Shek. XX	Dobrushë, Istog
7	Xhamia e Tedelit	Shek. XIX	Vrellë, Istog
8	Mulliri i Qelë Bicaj	Shek. XX	Vrellë, Istog
9	Kulla dhe Mulliri i Ali Bel Bicaj	Shek. XIX	Vrellë, Istog
10	Kulla e Sali Osmon Bicaj	Shek. XIX	Vrellë, Istog
11	Sharra e Qelë Bicaj *	Shek. XX	Vrellë, Istog
12	Kulla e Bashor Pren Gegaj	Shek. XVIII	Gurakoc, Istog
13	Kulla e Rexhë Fetahut *	Shek. XIX	Gurakoc, Istog
14	Kulla e Qerim Rugovës	Shek. XIX	Llukavci i Begut, Istog
15	Kulla e Zeqir Hakaj	Shek. XIX	Orroberdë, Istog
16	Mulliri i Bekim Binak Kamberaj	Shek. XX	Uqë, Istog
17	Xhamia e Uqës	Shek. XIX	Uqë, Istog
18	Banja e Pejës (Ilxha)	Shek. XX	Banjë e Pejës, Istog
19	Trolli i lindjes së Presidentit Ibrahim Rugova	Shek. XIX - XX	Cercë, Istog
20	Kulla e Haxhi Buleshkaj	Shek. XVIII	Istogu i ultë, Istog
21	Kulla e Xhafer Sylës	Shek. XX	Istogu i ultë, Istog
22	Kulla e Halil Dervish Sylaj	Shek. XIX	Istogu i ultë, Istog
23	Xhamia e Mehmet Akifë Errsojit	Shek. XIX	Shushicë e epërme, Istog
24	Kulla e Hamdi Halil Osmanaj	Shek. XIX	Trurbohovcit, Istog
25	Kulla e Tahir Isuf Osmanaj	Shek. XIX	Trurbohovcit, Istog
26	Xhamia e Trurbohovcit		Turbuhovc, Istog
27	Xhamia e Studenicës		Studenicë, Istog
28	Mulliri i Mazo Hajdarpashiq	Shek. XX	Carrallukë, Istog
29	Kulla e Shaban Turkaj	Shek. XIX	Kashicë, Istog
30	Mulliri i Ibish Arifit	Shek. XX	Muzhevinë, Istog
31	Kulla e Halil Ali Mavraj	Shek. XIX	Saradran, Istog
32	Kulla e Avdurrahman Ramë Kajtazit	Shek. XIX	Lubovë, Istog
33	Kulla e Nimon Bardh Shatrit	Shek. XIX	Tomoc, Istog
34	Xhamia e Tomocit	Shek. XX	Tomoc, Istog
35	Kulla e Sahit Iberdemaj	Shek. XIX	Lluga, Istog
III. Kategoria : Objektet e luajtshme			
1	Maje heshte	shek. VI-V p.Kr.	Lubozhdë, Istog
2	Maje heshte	shek. VI-V p.Kr.	Lubozhdë, Istog
3	Laterculi	Periudha e vonë romake	Cërrcë, Istog

Tab. 36. Tashëgimia arkitekturore dhe e luajtshme

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E MBROJTUR ARKEOLOGJIKE-HISTORIKE	Simboli I zonës
		ZmaH
Lokalitet arkeologjik, vendbanim parahistorik, tumë ilire, gërmadhë kishe, kishë, xhami, kullë, shkollë, truall, mulli dhe urë		

Dimensionet e parcelave		/
Vijat	Vija ndërtimore	/
Lartësia	Varësisht prej nivelit të intervenimit: renovim, rikonstruktiv apo revitalizim	lartësia origjinale e monumentit
Distancat (e ndërtesës ndaj kufirit të parcelës)	Distancat nga monumenti sipas përcaktimit ligjor	Perimetri mbrojtës përfshinë distancën prej monumentit arkitektonik deri te vija e parcelës (në raste specifike përcaktohet nga institucioni).
Katësia	Numri i kateve	/
Intensiteti		/
Vendparkime	Varësisht prej destinimit të dhënë për monumentin, në rast se shfrytëzohet atëherë iu referohet tabelës përkatëse për vendparkingje por gjithëmonë duke u caktuar nga institucioni kompetent. Ndalohet vendosja e parkingjeve para apo në afërsi të monumentit duke e penguar pamjen dhe lëvizjen e lirë.	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme ndërsa në veçanti me kërkesat të përcaktuara me ligjin për trashëgimi kulturore.	
Qasja në parcelë	Nuk lejohet qarkullimi i automjeteve më të rënda se 3 ton, përveç për raste emergjente. Të gjitha tabelat informuese (shtylla, billborde etj) duhet të vendosen sipas kërkesave të përcaktuara për peizazh dhe mobiluar urban duke mos e cenuar vizualitetin e monumentit dhe lëvizjen e lirë. Ndalohet vendosja e kontejnervë për mbeturina, tezgave apo kiosqeve në hapësira të cilat e pengojnë pamjen e monumentit.	
Tjera	Rregullat për zhvillim peizazhor dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme Kërkesat për ndriçim natyror dhe artificial në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme	

Masat mbrojtëse e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore

Në sipërfaqen e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ndalohen aktivitetet në vijim:

- Ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje
- Ndërtimi i autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale
- Zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë
- Instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçesve digjital¹⁰

¹⁰ Normat teknike, 61

6.0 KUSHTET ZHVILLIMORE TË ZONAVE MBISHTRESORE

6.1 Masat mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore – të përcaktuar në zonën bazë (ZMaH)

6.2 Masat mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura dhe zonat mbrojtëse.

6.2.1 Mbrojtja e zonave dhe sipërfaqet e mbrojtura- të përcaktuar tek zona bazë (SM)

6.2.2 Mbrojtja e zonave të veçanta- të përcaktuara tek zona bazë (ZV)

6.2.3 Mbrojtja e zonave të veçanta të mbrojtura- të përcaktuara tek zona bazë (ZVM)

6.3 Masat mbrojtëse për resurset lokale natyrore si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve.

6.3.1 Masat mbrojtëse për tokë pyjore:

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet përmes:

- Mbrojtjes së tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj tokë për shfrytëzime tjera jo-pyjore;
- Mbrojtjes dhe rregullimit të tokës pyjore përmes pyllëzimit- krijimii një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore në një tokë ku nuk kishte pyll.
- Mbrojtjes dhe rregullimit të tokës pyjore përmes ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore në formë të natyrshme ose artificiale.

6.3.2 Masat mbrojtëse për ujëra- të përcaktuara në zonën bazë (ZMU)

6.4 Masat mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, orteqeve, termetet e të tjera

6.4.1 Masat për mbrojtje nga zjarri

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-012 Për Mbrojtje Nga Zjarri, Komuna është përgjegjëse për hartimin e planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal në bazë të vlerësimit të rrezikut nga zjarri në pajtim me Planin shtetëror për mbrojtje nga zjarri.

Në zonat me vegjetacion të lartë, apo në zonat me pyje të larta duhet të ndërmerren masa për parandalimin e përhapjes së zjarreve eventuale. Të ndahen parcelat për mbrojtje nga zjarret. Shërbimi i Zjarrfikësve të pajiset me mjete teknike për intervenim edhe në zonat malore dhe të ngriten kapacitetet njerëzore.

Duhet të shtohet inspektimi për parandalim të zjarrvënies në zonat pyjore dhe tokat bujqësore

Të respektohen kushtet e ndërtimit të përcaktuara me kornizën ligjore për mbrojtje nga zjarri, me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit për të gjitha kategoritë e ndërtimit, ashtu si është

përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Kujdes duhet kushtuar sidomos objekteve të larta (mbi 22 m) nga sipërfaqja e tokës.

Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

6.4.2 Masat për mbrojtje nga vërshimet

Masat që duhet të ndërmerren për mbrojtje nga vërshimet duhet të përfshijnë:

- Hapjen dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve kryesor, në mënyrë që të evitohen vërshimet në rast të reshjeve të mëdha dhe shkrirjes së borës. Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe mirëmbajtja e tyre, mundëson pranimin e sasisë së plotë të ujit në periudhat me intenzitet të madh të reshjeve.
- Të ndërtohen penda mbrojtëse/argjinatura për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrrenjtë e bjeshkëve përgjatë vendbanimeve që shtrihen rrëzë bjeshkëve të komunës. Duhet të bëhet vlerësim se cila është mënyra e duhur e ndërtimit dhe lokacionet e nevojshme përgjatë këtij brezi vendbanimesh. Gjatë hartimit të planeve të tilla duhet t'i kushtohet rëndësi edhe ndikimeve në mjedis, respektivisht mbrojtjes së biodiversitetit dhe respektimin e të gjitha dokumenteve relevante të të nivelit qendror dhe lokal, në zonat ku planifikohen masa të tilla.

6.4.3 Masat për mbrojtje nga erozioni

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmytje (vërshime). Faktorët tjerë që shkaktojnë vërshime, janë edhe mbeturinat nëpër lumenj si dhe rrokullisjet e gurëve nga bjeshkët.

Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave dhe kjo si rezultat i mungesës së pendave mbrojtëse. Përroi i Bollovonës e rrezikon qytetin e Istogut, për shkak se në rrjedhën e tij të dikurshme sot ka ndërtim, përroi i Dragiqit nga ujërat e pyllit e rrezikon fshatin Cerrcë sepse rrjedha e tij e dikurshme sot shfrytëzohet si rrugë nga fshatarët, Vrella rrezikohet nga përroi i quajtur 'Lugu i Madh'.

I rrezikuar konsiderohet edhe Kaliqani nga përroi Drenik, i cili vazhdon shtrirjen e tij edhe nëpër fshatin Studenicë.

Edhe lumi i Istogut vërshon, dhe me këtë rast dëmton fshatrat; Llukavc i Begut, Llugë, Zabllaq, një pjesë afër urës së KFOR-it dhe vazhdon deri te fshati Rudicë.

Dëme të kësaj natyre shkakton edhe Gujavçi i cili përfshin Drejën dhe Zallqin.

Në periudhat kur të reshurat janë të shpeshta, përroskat akumulojnë ujë dhe erodojnë më së shumti pjesën malore. Ky erodim është i theksuar në Syrganë, Kaliqan dhe Vrellë.

Për parandalimin apo miniizimin e erozionit bazuar në ligjin mbi Ujërat e Kosovës, duhet të Mirren këto masa parandaluese:

- Ndalimi i degradimit të pyjeve- prerjes së drunjëve
- Ndalimi mbi kullotjen
- Ndalimi i shfrytëzimit të të mirave material që shkaktojnë erosion

Masat hidroteknike që duhet ndërmarrë janë:

- Mbjellja e vegjetacionit përkatës në shtretërit e rrjedhave ujore
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve nga shtretërit e rrjedhave ujore
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e rrjedhave ujore për të parandaluar gërryerjet e mundhësme
- Punimi i peizazhti apo ndërtimi i pendave apo të ngjajshme në shtretërit e rrjedhave të vogla ujore si masa antierozive

Masat që lidhen me tokën bujqësore:

- Punimi dhe mirëmbajta e tokave bujqësore
- Punimi i sistemit përkatës të ujisjes

Masat që lidhet me tokën pyjore:

- Mbrojtja e pyejeve nga djegjet dhe prerjet e pakontrolluara
- Pyllëzimi i zonave të zhveshura dhe të degraduara
- Krijimi i shiritave të gjelbër të zonat me shkallë më të lartë erozive
- Kontrollimi dhe ndalimi i kullotjes në zonat në të cilat specie të bimësisë janë në rrezik për zhdukje
- Meliorim i pyjeve

Të gjitha kushtet dhe masat mbrojtëse të përcaktuar me udhëzimet administrative përkatëse si UA për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozoni, duhet të respektohen.

6.4.4 Masat për mbrojtje nga tërmetet

Në territorin e Komunës së Istogut, janë vërejtur thuaja të gjitha dridhjet seizmike të cilat janë bërë në hapësirë me epiqendra në ish Jugosllavi. Pasojat e dëmeve janë manifestuar me dëme materiale të vogla dhe të parëndësishme në disa objekte të vogla të ndërtuara nga materiale të dobëta ndërtimore. Sipas interpretimit të hartave seizmike, territori i Komunës së Istogut është nën ndikimin e 6° të intensitetit seizmik MCS. Gjithashtu, sipas të dhënave hartografike, në komunë shtrihen plasjet e mbuluara dhe pak të dukshme si dhe plasjet e mbuluara, gjë që tregon karakteristikën specifike tektonike të territorit.

Gjatë projektimit dhe ndërtimit të objekteve të të gjitha kategorive, inxhinierët, investitorët dhe komuna duhet të respektojnë të gjitha standardet nga sektori i sizmologjisë sipas rregullave të Eurokodit 8, procedurat teknike dhe zonimet sipas rrezikshëmisë sizmike si dhe nga kriteret e përcaktuar sipas UA (MZHE) Nr. XX/2019 ¹¹ për Mikrozonime dhe studime të posaçme të rrezikut sizmik.

¹¹ UA (MZHE) Nr. XX/2019 për mikrozonime dhe studime të posaçme të rrezikut sizmik - në kohën e hartimit të projektit ky dokument ishte ende si draft document.

6.4.5 Masat për mbrojtje nga breshëri

Ekzistojnë dy mënyra për mbrojtjen nga breshëri. Mënyra e parë dhe më efektive sipas ekspertëve, është riaktivizimi i sistemit raketor për shpërndarjen e reve, dhe mënyra e dytë është mbrojtja e parcelave të punueshme bujqësore me rrjeta mbrojtëse nga breshëri.

Për sistemin e parë kompetent është niveli qendror, respektivisht MBPZHR. Prandaj duhet të ndërmerren iniciativa që në bashkëpunim me këtë ministri dhe me institucionet e tjera përgjegjëse të bëhen përpjekje për tejkalimin e problemeve për realizim sa më të shpejtë të këtij sistemi.

Ndërsa në anën tjetër i mbetet komunës që të përkrahë fermerët në subvencionimin e rrjetave mbrojtëse nga reshjet e breshërit, si masë shumë e rëndësishme për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë.

Si masa të përgjithshme, për mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, janë:


- Zbatimi i të gjitha detyrimeve ligjore që dalin nga korniza ligjore në fuqi, e për të cilat është kompetent Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal.
- Ngritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, të shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.
- Sigurimi i hapësirave të nevojshme për strehim në rast të evakuimit të banorëve dhe kafshëve nga zonat e rrezikuara.
- Sigurimi i strehimoreve publike nga qeverisja vendore, me ndihmën ose subvencionimin e qeverisë qendrore

6.5 Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për tu zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

6.5.1 Masat për mbrojtje nga stuhitë e erës


Në zonën me ndikimin më të madh nga stuhitë e erërave të forta lokale, duhet ti kushtohet rëndësi përcaktimit të kushteve të ndërtimit, sidomos të ndërtesave të larta. Gjatë projektimit dhe realizimit të kulmeve duhet të merren parasysh ndikimet e erës. Të respektohen kërkesat ligjore për sigurimin e çasjes së pa penguar nëpër ndërtesa, për intervenime në raste të emergjencave.

Të merren masa teknike për përforcimin e shtyllave të instalimeve elektrike dhe të telekomunikimit (apo zavendësimin me të reja aty ku është e domosdoshme), në vendbanimet e rrezikuara, e me theks të veçantë të rrugët dhe ndërtesat publike që përdoren nga numër më i madh shfrytëzuesish. Masa duhet të ndërmerren edhe për kontrollimin stabilitetit të drunjëve të lartë që janë pjesë e peizazhit të përmbajtjeve të cekura më lartë. Duhet të ndalohen apo të vendosen kushte të veqanta për përforcimin e pajisjeve dhe stabilimenteve të telekomunikimit, klimatizimit e të tjera të ngjashme, nëpër fasadat dhe kulmet e ndërtesave.



7.0 INFRASTRUKTURA RRUGORE

Kjo zonë nënkupton rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike e cila është e përbërë prej tri klasave (HILUCS 2): rrjeti të transportit, shërbimit të logjistikës dhe magazinimit dhe shërbimeve publike në të cilën bën pjesë infrastruktura teknike.



f

Fig. 12 Skema e shpërndarjes së zonës së komunikacionit dhe transportit në komunën e Istogut

7.1 Shfrytëzimet e lejuara dhe kushtet zhvillimore

ZKT	
ZONË E KOMUNIKACIONIT DHE TRANSPORTIT- ZKT	
Sip= 76872.337 ari	
HILUCS Kodi i shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Në këtë zonë bëjnë pjesë rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike. Këtu hyjnë të gjitha hapësirat e shfrytëzuara për transportin rrugor, si: rrugët, zonat e parkimit, stacionet e shërbimit, si dhe hapësirat që shfrytëzohen për shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë termike, ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe hapësirat për trajtimin e mbeturinave.	
4.1.1	Infrastrukturë e transportit rrugor
4.3.1	Infrastrukturë e shpërndarjes së energjisë termike elektrike
4.3.2	Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza
4.3.3	Infrastrukturë për trajtimin e mbeturinave
SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE	
	Vendkalime, tunele, ura, parkingje, shtigje për këmbësorë, shiritat e gjelbër
	shtyllat për ndriçim, reklamat
	Ndalest e autobusëve dhe automjeteve tjera

	Pajisje në shërbim të transportit, sinjalizimi vertikal, mure mbrojtëse
	Rrethrotullimet
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
	Stacion I autobusëve
	Shërbime tregtare dhe të ushqimit
	Shërbim publik
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOZHME
	Pajisje dhe makineri për ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje të rrugëve
	SHFRYTËZIMET E NDALUARA
	Të gjitha ato aktivitetet të cilat nuk janë përfshirë në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, të veçanta dhe të përkohshme

Kushtet zhvillimore për infrastrukturën e transportit rrugor janë bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e infrastrukturës rrugore:

- UA Nr.08/2017 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor
- Ligji Nr.2003/11 për Rrugët
- Ligji Nr.06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120
- UA Nr.09/2015 për Kyçe, Instalime, nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe rajonale
- UA Nr.09/2015 për kyçe, Instalime, nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale.

7.1.1 Kushtet teknike

Rrugët e nivelit qendror- në rrugët rajonale vendosja e instalimeve përcaktohet me rregullat ligjore për instalime, kyçe nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve rajonale.

Kriteret	Rrugë rajonale	
	Që lidhin vendbanimet	Që kalojnë brenda vendbanimit
Gjërësia e rrugës	Min 23.0 m	
Brezi mbrojtës rrugor 1 (BMRR 1)*	< 40,0 m	
Brezi mbrojtës rrugor 2 (BMRR 2)*	< 10,0 m	
Parkim në profil tërthor	/	/
Sinjalizimi dhe shenjëzimi	në përputhje me kushtet sipas UA Nr.04/2011	
BMRR1- nuk lejohet hapja e minierave, ndërtimi i liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të ngajshme		
BMRR 2- nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit, administrative, hapja e puseve të ujit, gropave septike, instalime të transmetuesve elektrik dhe të ngajshme		

Tab. 37 Normat për kategorinë e rrugës rajonale

Rrugët e nivelit lokal - duke pasur parasysh konceptin e përdorur për dimensionim e rrugëve dhe përkimin me situatën në terren (të përshkruar më gjërësisht në nënkapitullin 7.2 ZKT), duhet të mirret parasysh respektimi i kushteve për sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve në trafik.

	Rrugë në vendbanime rurale						Rrugë në vendbanime urbane							
	Brenda VB				Tjera		Primare		Sekondare				Tjera	
	Që lidhin dy a më shumë VB rurale e tranzite	Primare e VB	Sekondare		Të pakatëgorizuara	Shërbyese	Unazë e brendshme	Kryesore e qytetit	Përmbledhëse	Banesore	Qasëse		Shërbyese	Industriale
			Njëkahore	Dykahore							Njëkahore	Dykahore		
Gjërësia e rrugës (m')	9.5	6	3.5	5.5		5.5			10.5	8.5	3.5	5.5	5.5	5.5
Brezi mbrotjtës rrugor 1*	< 30.0						/							
Brezi mbrotjtës rrugor 2*	< 10.0						/							
Parkim në profilin tërthor	Jo	Jo	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Jo	Jo	Jo
Trotualet	1.5	1.5							1.5	1.5	1.5			
Brezi i gjelbërt përgjatë rrugëve	10.0		8.0			>10.0		> 8.0						
Sinjalizimi dhe shenjëzimi	në përputhje me kushtet sipas UA Nr.04/2011													
*1- nuk lejohet hapja e minierave, ndërtimi i liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të ngjajshme														
*2- nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit, administrative, hapja e puseve të ujit, gropave septike, instalime të transmetuesve elektrik dhe të ngjajshme														

Tab. 38 Normat për kategorinë e rrugëve lokale

7.2 Rrjeti i transportit- ZKT (4.1 Kodi HILUCS 3)

7.2.1 Transporti i motorizuar

Rrjeti i infrastrukturës rrugore në territorin e komunës së Istogut është planifikuar duke u bazuar në:

- Profilet ekzistuese të rrugëve
- Planet rregulluese urbane (Istog, Gurakoc, Vrellë, Rakosh, Banjë)
- Plani zhvillimor Urban
- Normave dhe strandareve sipas UA 08/2017
- Tipologjisë së vendbanimeve
- Ruajtjes së tokës bujqësore, dhe
- Kriteri ku çdo parcelë e ndërtuar të këtë qasje ne rrjetin rrugor.

Sipas llojit, sipërfaqes, kapaciteti dhe kushteve teknike për projektim dhe ndërtim, rrjeti i transportit ndahet në:

- Rrugëve publike, të motorizuar dhe jo të motorizuar me kategorizim dhe nivelim
- Ndërtesave dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural
- Sipërfaqeve publike për vendparkim

Destinimi	Sip. Ha
Rrjeti rrugor	752.12
Stacioni i autobusëve	1.037
Impianti për ujëra të zeza	21.83
Ngrohtorja	0.41
Gjithsej	775.397

Tab. 39. Sipërfaqja e rrjetit të komunikacionit- transportit në komunën e Istogut

Rrugët publike, të motorizuara dhe jo të motorizuara me kategorizim dhe nivelim

Sipërfaqet në të cilat shtrihet rrjeti i rrugëve publike të motorizuara në komunën e Istogut janë të përcaktuara për infrastrukturë të transportit rrugor sipas HILUCS në Udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor. Këto sipërfaqe përfshijnë rrugët, zonat e parkimit dhe stacionet e shërbimit.

Në komunën e Istogut rrjeti rrugor kategorizohet në :

1. rrugë rajonale, të cilat janë nën administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe
2. rrugët lokale, të cilat janë nën administrimin e Komunës.

Lloji i rrugës	Kategoria	Funksioni
Rrugët rajonale	ZTR	Rrugët që lidhin dhe shkarkojnë zonën urbane/rurale të komunës
Rrugë tranzite	ZTT	Rrugët që lidhin vendbanimet rurale
Rrugët Përmbledhëse/shpërndarëse	ZTP	Rrugët Përmbledhëse/shpërndarëse për lidhjen e tërësive urbane me rrugët kryesore
Rrugë Servisore	ZTVS	Rrugët që shërbejnë për lidhjen e blloqeve me rrugët rajonale/përmbledhëse
Rrugë Banesore	ZTVB	Rrugët që shërbejnë për lidhjen e grupeve urbane me rrugët përmbledhëse/servisore
Rrugë Qasëse dy kahe	ZTVQ	Rrugët që ofrojnë qasje në të gjitha parcelat
Rrugë malore	ZTPM	Rrugë që shërbejnë për lidhjen e pjesën malore

Tab. 40 Kategorizimi i rrugëve ¹²

¹² Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët Nr. 2003/11.

LLOJET		UA	PZHK , PRRU EKZISTUESE
1	Rrugë rajonale	23m	PRRU-26.4m , E-10m
2	Rrugë tanzit	21	16
3.1	Rrugë përmbledhese primare	10.5	8.4-17.4
3.2	Rrugë përmbledhese sekondare	10.5	8.4-19.4
4	Rrugë servitore	9	6-23.3
5	Rrugë banesore	8.5	5.5-13
6	Rrugë për qasje	5.5-6.0	5.5-11.2
7	Rrugë malore	6	6

Tab. 41. Profilet rrugore ne raport me gjendjen ekzsituase, planet dhe udhëzimin administrative

RRUGËT RAJONALE- Pozita gjeografike e komunës së Istogut e bënë që territori i saj të ketë lidhje të mira me komunat tjera, lidhje kjo që realizohet përmes rrugëve rajonale. Në territorin e komunës shtrihen këto rrugët rajonale: R-101, R-103, R-104 dhe R-221.

Përmes R 101 mundësohet lidhja e Komunës së Pjesë me atë të Skenderajit, kjo rrugë gjithashtu shërben si rrugë përmbledhese e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet brenda komunës.

R 103 është ura lidhëse e 3 qendrave strategjike të Istogut : qytetit , Vrellës, Banjës dhe Dubravës . Përmes kësaj rrugë bëhet zhvillimi ekonomik , kulturor dhe turizmit. Poashtu në PZHK është propozuar që R103 të vazhdoj të lidhet nëpër fshatërat : Studenicë , Kaliqan me rrugën R106 qe e lidhe me Malin e Zi . Nga rruga R 104 realizohet lidhja e Istogut me Prishtinë përmes Klinës, rrugë kjo që kalon nëpër qendër të qytetit. Ndërsa R 221 e lidhë Istogun me Zubin Potok, rrugë kjo që do të duhej ti ipet prioritet për tu asfaltuar në te ardhmen.

Vërejtje: Për shkak të ndërtimeve ekzistuese përgjatë rrugëve rajonale profili I të cilave variron duke filluar prej 10 m’ e tutje, në këtë plan është tentuar adaptimi në raste të caktuara duke e siguruar korridorin prej 23 m’ i paraparë sipas UA 07/2017.

RRUGËT LOKALE- Rrugët lokale në Istog sigurojnë lidhje të mirë mes qendrave të bashkësive lokale dhe qasje kryesisht të mirë të të gjitha vendbanimeve në rrjetin rrugor komunal.

Bazuar në funksionin e tyre në hapësirën e komunës, duke pasur parasysh lidhjen mes qendrave të bashkësive lokale, lidhjen e vendbanimeve dhe lidhjen me vendbanimet e komunave fqinje, është bërë kategorizimi i rrugëve lokale. Kategorizimi i rrugëve lokale sipas funksionit) në:

- Rrugë tranzite,
- Rugë lokale :

- a) Rrugët Përmbledhëse/shpërndarëse (ZTP): primare dhe sekondare
- b) Rrugët në vendbanime ZTVS,ZTVB,ZTVQ: rrugë servitore, rrugë banesore, rrugë për qasje dhe
- c) Rrugë të pakategorizuara: rrugë malore.

Rrugët tranzite (ZTT) janë rrugët të cilat lidhin mes vete vendbanimet rurale dhe ofrojnë qasje të lehtë në rrugët rajonale.

Rrugët lokale të shtrira në tërë sipërfaqen e komunës mundësojnë lidhjen dhe qasje të lehtë për të gjitha vendbanimet e komunës. Në kuadër të kategorisë së rrugëve lokale, ekzistojnë disa nënkategori bazuar në funksionin dhe profilin e rrugëve.

a) Rrugët Përmbledhëse/shpërndarëse (ZTP) - janë të ndara në dy kategori : primare dhe sekondare.

- Rrugë përmbledhëse/shpërndarëse primare (ZTP1) - janë rrugët të cilat lidhin disa vendbanime dhe qendrat e bashkësive lokale mes veti dhe që mbledhin e shpërndajnë trafikun kryesor nga rrugët rajonale.
- Rrugë përmbledhëse/shpërndarëse sekondare (ZTP2) - janë rrugët të cilat lidhin vendbanimet (fshatrat), dhe që mbledhin dhe shpërndajnë trafikun nga rrugët rajonale dhe primare-përmbledhëse/shpërndarëse.

b) Rrugët në vendbanime (ZTV) - janë rrugët të cilat sigurojnë lidhjen e një vendbanimi me rrugët përmbledhëse/shpërndarëse primare dhe sekondare.

Rrugët Servitore (ZTVS) - janë gjithashtu rrugë të zonës urbane që kanë për qëllim lidhjen e blloqeve urbane me rrugët përmbledhëse dhe ato kryesore.

Rrugët Banesore (ZTVB) - janë rrugët që shërbejnë për lidhjen e grupeve urbane dhe lagjeve në vendbanimet rurale me rrugët e tjera lokale dhe rajonale.

Rrugë Qasëse dy kahore (ZTVQ) - Në kuadër të kategorisë së rrugëve lokale ekzistojnë edhe rrugët qasëse me dy kahje varësisht nga nevojat e banorëve të vendbanimeve rurale.

c) Rrugë malore (ZTPM) - janë rrugët të cilat lidhin malet me vendbanime, kanë kryesisht karakter ekonomik dhe shumica janë me sipërfaqe prej dheu.

Tab. 42. Rrjeti i rrugorë- gjatësia dhe sipërfaqja



Vërejtje: Rrjeti rrugor për komunën e Istogut (në aspektin teknik) është punuar në dy shtresa të cilat janë të prezentuara në GIS si attribute të veçanta:



- Shtresa e parë paraqet korridorin e zonës së komunikacionit sipas rregullave teknike të HZ-së
- Shtresa e dytë paraqet profilin detal e cila është punuar për secilën kategori të rrugës rrugë që gjendet në komunën e Istogut

Arsyetimi:

Situata ekzistuese në terren (ndërtimet afër rrugës, ndarja e parcelës si rezultat i ndarjes së familjes, kanalet ekzistuese të rrjedhave ujore, topografia e ndryshueshme e terrenit, fronti i ngushtë për qasje i parcellës etj.) bën që profili “model” i standarizuar nuk mund të implementohet në të gjitha rastet. Prandaj për t’i ikur problemeve të mundshme lidhur me implementin e profilin rrugor, rrjeti rrugor është punuar në nivel më të hollësishëm duke vizatuar dhe adaptuar profilet rrugore me situatën në terren dhe njëkohësisht duke i respektuar të gjitha standardet lidhur me kategoritë përkatëse të rrugëve.


Më poshtë janë të paraqitura profilet bazë të rrugëve të cilat mund të variojnë nga njëra tjetra kryesisht në dimensionet e trotuatëve, largimin e njërës shteg të biciklistëve apo në rastet e vendbanimeve me dendësi të ultë ku lëvizja e këmbësorëve është me frekuencë shumë të ultë edhe zvogëlimi i gjërësisë së shtegut për këmbësorë.

Në detajet e profileve rrugore janë paraqitur edhe instalimet e infrastrukturës teknike përfshirë ndarjen dhe pozicionet e: kablllove, energjetike, kablllove të ndriçimit, telekomunikimit, instalimeve të ngrohjes, gypat e ujësjellësit, kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik.




LEGENDA

- Kabllot energjetike
Power cables
Energetski kablovi
- Kabllot e ndriqimit
Lighting cables
Kablovi za osvetljenje
- Telekom
Telecom
Telekomunikacije
- Instalimet e ngrohjes
Heating installations
Instalacije grejanja
- Ujësjeslesi
Water supply
Vodovod
- Kanalizimi fekal
Fecal water network
Fekalne kanalizacije
- Kanalizimi atmosferik
Rain water network
Atmosferske kanalizacije



LEGENDA

- ● ● Kabllot energjetike
Power cables
Energetski kablovi
- Kabllot e ndriqimit
Lighting cables
Kablovi za osvetljenje
- ■ ■ Telekom
Telecom
Telekomunikacije
- Instalimet e ngrohjes
Heating installations
Instalacije grejanja
- Ujësjesles
Water supply
Vodovod
- Kanalizimi fekal
Fecal water network
Fekalne kanalizacije
- Kanalizimi atmosferik
Rain water network
Atmosferske kanalizacije



Kategoria e rrugës		Brezi I gjelbër (m)	Brezi rrugor (m)	Brezi mbrojtës rrugor (m)		Ngarkesa boshtore (ton)
				Distanca 1*	Distanca 2*	
Rrugë regjionale		22	2	40	10	11.5
Rrugë të rrjetit primar	Rrugë tranzite (urbane & rurale)	10	1	30	10	6
	Rrugë përmbledhëse/ shprëndarëse					
Rrugë të rrjetit sekondar	Rrugë servitore	8				
	Rrugë banesore	/	1	/	/	
	Rrugë qasëse	/	1	/	/	
	Rrugë malore	/	/	/	/	
Shtigjet për këmbësorë		3		0.75		
*1- nuk lejohet hapja e minierave, ndërtimi I liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të ngjajshme						
*2- nuk lejohet ndërtimi I ndërtesave të banimit, administrative, hapja e puseve të ujit, gropave septike, instalime të transmetuesve elektrik dhe të ngjajshme						

Fig. 13 Brezat mbrojtës të rrugëve

7.2.2 Transporti jo I motorizuar

Çiklistët, këmbësorët dhe personat me aftësi të veçanta

Zhvillimet e ardhshme do të përfshijnë arritjen e disa standardeve përmes masave për përmirësimin e qasjes së personave më aftësi të kufizuar, për prind me karrocë si dhe të ndikojnë në rritjen e numrit të çiklistëve dhe këmbësorëve. Këto masa përfshijnë edhe sigurimin e hapësirave dhe objekteve për çiklistë dhe këmbësorë. Shtigjet e sigurta për çiklistë dhe këmbësorë mundësojnë mjete alternative të lëvizjes nëpër komunë dhe mund të zvogëlojnë përdorimin e automjeteve.

Bazuar në normat teknike të planifikimit, gjërësia e shtigjeve është paraparë të jetë 1.8 m , ndërsa gjërësia 0.9 m, duke pasur parasysh edhe lëvizjen e lirë dhe papaengesa për personat me kërkesa të veçanta.

Këmbësorët-Promovimi i ecjes ka rëndësi të veçantë, posaçërisht për shëndetin si formë e aktivitetit fizik, pastaj zvogëlimin e emisionit të gazrave nga trafiku i reduktuar me vetura dhe shtimin e sigurisë në trafik. Ecja gjithnjë e më shumë po bëhet aktivitet kryesor rekreativ, sidomos në peizazhet skenike – kodrinat dhe malet.

Komuna duhet të ndërmerr masa për përmirësimin e sigurisë dhe komoditetin e këmbësorëve, me kalime në udhëkryqe, përmirësojë ndriçimin, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe kanalizimin atmosferik. Shtigjet janë posaçërisht të rëndësishme në zonat me potenciale turistike - peizazhet e hapura, Parkun Nacional. Këto shtigje duhet të jenë pjesë e planit të përgjithshëm të turizmit për tërë komunën.

Autoritetet komunale duhet t'i kushtojnë rëndësi edhe nevojave të njerëzve me aftësi të kufizuar të lëvizjes, duke i trajtuar këto nevoja gjatë menaxhimit të trafikut, ndërtimit të rrugëve, transportit publik dhe projekteve tjera.

Çiklistët- komuna duhet t'i kushtojë rëndësi të madhe zhvillimit të çiklizmit si pjesë integrale e sistemit të transportit. Rrjeti i shtigjeve të çiklistëve duhet të planifikohet me kujdes, duke u bazuar jo vetëm në nevojat e udhëtimit, por kërkesat e turizmit si në pjesën rrafshinore, po ashtu edhe në atë kodrinore-malore.

Shtimi i konsiderueshëm i ecjes dhe përdorimit të biçikletave mund të arrihet përmes promovimit kualitativ dhe publicitetit, kurse promovimi i ecjes dhe çiklizmit është i lidhur ngushtë me zhvillimin e zonave të turizmit dhe rekreacionit.

Shtigjet për biçikleta janë planifikuar përgjatë rrugëve nën 50 km/h dhe varësisht prej mundësisë së zgjerimit në të ardhmen përmes hartës zonale ato do të planifikohen në një apo dy drejtime varësisht prej karakteristikave të terrenit dhe mundësive të zgjerimit.

Korsitë për biçikleta nëpër vendbanime janë : 1.5m të shtegu njëdrejtimësh dhe 2.0m të shtrgu dydrejtimësh, ndërsa korsintë jashtë vendbanimeve mund të jetë prej 1.0-1.6 m.

Ndërsa vendparkimet për bicikleta llogariten të jenë 1.2 m²/ bicikletë. Varesisht nga përmbajtja e ndërtesës vendparkingjet për bicikleta do të jenë: për përmbajtje tregtare-komunale 5 VPB/100m² të bruto sip së ndërtuar për vizitor, përmbajtje arsimore: 1 VPB/ 5 nxënës, përmbajtje kulturore 10 VPB/ 100 ulëse, përmbajtje kulturore: 10 VPB/ 100 ulëse dhe përmbajtje sportive: 10 VPB/ 100 ulëse.

Sipërfaqet publike për vendparkim

Sipas PZHK-së propozimet e reja do të duhej të përgatisin masa për reduktimin e vëllimit të trafikut dhe zvogëlimin e nevojës për sipërfaqe të parkimit mbi tokë. Planet rregulluese duhet të specifikojnë masat për këto reduktime në lokacionet specifike.

Strategjia e parkimit ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe integrimin e përgjithshëm të shfrytëzimit të tokës dhe transportit. Zhvillimet e reja, posaçërisht në peizazh, duhet të sigurojnë parkim të përshtatshëm në harmoni me udhëzimet nga Plani Hapësinor i Kosovës

7.3 Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural

Bazuar në dendësinë e popullsisë nëpër zonat e komunës së Istogut dhe nevojave të udhëtimit, mund të konsiderohen opsionet e ndryshme të transportit si autobusët dhe minibusët, si dhe shfrytëzimi i automjeteve private.

Hierarkia e propozuar e shërbimeve nëpër vendbanime do të duhej të jetë bazë për sistemin e ri të transportit publik. Vendet e reja të punës afër vendbanimeve, mund të zvogëlojnë varshmërinë e banorëve nga automjetet dhe inkurajojë shfrytëzimin e llojeve alternative të transportit si: biçikleta, ecja dhe transporti publik.

Principet e mëposhtme përbëjnë bazën për politikën e transportit – mobilitetit:

- Shkurtimi i distancave në mes të fshatrave dhe qendrave të bashkësive lokale dhe Istogut si qendër kryesore, përmes formave të ndryshme të transportit;
- Promovimi i transportit alternativ ndaj udhëtimit konvencional me veturë;
- Promovimi i qasjes së sigurt në rrugë duke minimizuar numrin e pikave të qasjes përgjatë rrugëve rajonale dhe rrugës përmbledhëse;
- Aty ku është e domosdoshme duhet të bëhet ndarja në mes të trafikut tranzit dhe trafikut lokal;
- Sigurimi i qasjes adekuate në ndërtesat dhe ngastrat në zonat e destinuara për zhvillim;
- Promovimi i formave të zhvillimit të cilat kërkojnë përmirësim vetëm aty ku nuk do të dëmtohen resurset mjedisore dhe skenike;
- Sigurimi i nevojës reale për asfaltimin e rrugëve të reja dhe rikonstruktimin e atyre ekzistuese.

Shërbimet e transportit publik kanë rol qenësor për të mundësuar lëvizjen drejt vendeve të punës, arsim dhe edukim, shëndetësi, tregti, përmbajtje publike dhe rekreacion. Transporti publik ka rol pozitiv në luftimin e dallimeve sociale. Transporti publik brenda komunës bëhet me autobusë dhe minibusë duke siguruar lidhjen e vendbanimeve me qendrën urbane Istogun dhe lidhjen në mes të vendbanimeve. Përveç transportit publik, edhe përdorimi i automjeteve individuale është rritur në mënyrë dramatike pas luftës. Kjo formë e transportit është njëri prej ndotësve kryesor të ambientit, prandaj duhet të investohet në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve të transportit publik, me qëllim të inkurajimit të shfrytëzimit të transportit publik dhe jo atij vetanak. Rrjeti i propozuar me koncept të rrugës përmbledhëse për t'i lidhur të gjitha vendbanimet në mes zonave do të mundësojë një transport publik më efikas.

8.0 INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

8.1 Zona shërbimeve të komunitetit, ZSHK (3.3 Kodi HILUCS 3)

Në këtë zonë bëjnë pjesë të shërbimeve që lidhen me komunitetin duke filluar nga shërbimet e administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbimit arsimor, shërbimit shëndetësor dhe shoqëror, shërbimit fetar si dhe shërbimeve tjera të komunitetit.

Shërbimet e Komunitetit sipas Planit Zhvillimor Komunal të Istogut gjenden në :

Ndërtesa e zjarrfikësave gjendet në Istog; Policia gjendet në Istog dhe Gurrakoc; Kuvendi Komunal gjendet në Istog dhe Zyre vendi janë propozuar në Rakosh, Cërkolez, Vrellë, Bajë, Dobrushë dhe Zallq. Gjykata Komunale gjendet në Istog.

Shërbimet e Arsimit sipas Planit Zhvillimor Komunal të Istogut gjenden në :

Qerdhe/Kopshtë ekzistuese janë në Bajë, Gurrakoc, Zallq, Istog, Rakosh dhe Vrellë, ndërsa janë propozuar në Dobrushë, Dubravë dhe Cërkolez.

Shkollë fillore ekzistuese gjenden në Istog, Dubravë, Rakosh, Cërkolez, Uçë, Shushicë, Vrellë, Kaliqan, Bajë, Staradran, Llukavc I bregut, Gurrakoc dhe Zallq. Është propozuar në Dobrushë.

Shkollë e mesme ekzistuese janë në Istog dhe Gurrakoc.

Paralele të ndara gjenden në Veriq, Kërninë, Dubravë, Synejë, Bollopojë, Suhogërlle, Cërkolez, Padalishtë, Cerrcë, Muzhevinë, Studenicë, Prigodë, Kashicë, Trubuhoc, Dobrushë, Llukac I thatë, Kosh dhe Osojan. Paralele për arsim special gjenden në Istog, Dubravë dhe Bajë.

Shërbimet e Mjekësisë sipas Planit Zhvillimor Komunal të Istogut gjenden në :

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare gjendet në Istog. Qendra Mjekësore Familjare gjenden në Istog dhe Vrellë. Ambulancat gjenden në Istog, Veriq, Kërninë, Dubravë, Cërkolez, Padalishtë, Shushicë, Kaliqan, Studenicë, Staradran, Dobrushë, Zallq dhe Osojan. Shtëpia për të moshuar gjendet në Gurrakoc. Qendra Termale/Banjë gjendet në Bajë. Qendra sociale gjendet në Istog.

Parimet e planifikimit të infrastukturës sociale

Infrastruktura sociale tek vendbanimet të cilat posedojnë plane zhvillimore urbane dhe plane rregulluese (Istog, Vrellë, Gurakoc, Banjë, Rakosh dhe Saradran) përkon me pozitën e planifikuara sipas planit. Ndërsa tek vendbanimet tjera shprehëndarja e tyre është bërë duke u bazuar në disa parime:

- Shfrytëzimi i pronave publike brenda vendbanimit
- Planifikimi afër përmbajteve ekzistuese publike në mënyrë që të krijohet një lloj “qendre” e vendbanimit duke i koncentruar ato e jo shpërndarë nëpër tërë territorin e vendbanimit të caktuar.

Meqë sipas planit zhvillimor komunal përmbajtet e planifikuara të vendbanimit kryesisht I takojnë infrastrukturës sportive dhe shërbimeve të komunitetit (sport, kulturë, zyre vendi, postë, bankë, park), koncepti I planifikimit të tyre është bazuar në disa objektiva:

- Sporti- së pari janë identifikuar se cilat shkolla posedojnë salla të sportit dhe cilat jo. Në rast se shkolla ekzistuese nuk ka sallë është propozuar në brendi të parcellës së shkollës duke siguruar sipërfaqen totale për shkollë prej 1.2 ha. Në rastin tjetër është propozuar në afërsi të saj ose në afërsi të përmbajteve tjera ekzistuese.
- Shërbimet e komunitetit si: zyrja e vendit, posta, banka, biblioteka, janë planifikuar në një parcel të përbashkët duke iu lënë projektuesve në të ardhmen mundësinë e inkorporimit të këtyre funksioneve në një ndërtesë multifunksionale. Ky koncept është i përshtatshëm sidomos për kategorinë e vendbanimeve të vogla duke I koncentruar përmbajtjet në një vend dhe duke krijuar një lloj “qendre” të vendbanimit.

Sallat e sportit të cilat janë realizuar bazuar në PZHK janë ajo në Cërcë dhe në Uçë e cila është në realizim e sipër.

Principi I planifikimit të parcellës varësisht prej mundësive:

- Sallat e sportit të planifikuara në kuadër të parcellës së shkollës ekzistuese

Bellopojë- salla e sportit e planifikuar brenda parcellës ku aktualisht gjendet fushat në të hapur. Dmth propozohet ridizajnim I hapësirës ekzistuese duke përfshirë : sallën e sportit dhe fushat në të hapur.

Osojan- salla e sportit në anën perëndimore (tek fushat ekzistuese) në mënyrë që të mos mbyllet komunikimi dhe pamja ndaj qendrës së komunitetit

- Park dhe sallë sporti

Kosh- në anën lindore planifikimi I sallës në mënyrë që të ruhet gjelbrimi I lartë në anën perëndimore përgjatë rrugës.

- Park dhe fushë sporti

Shalinovicë- për shkak të afërsisë me Osojanin (1 km largësi nga salla e sportit) nuk është planifikuar sipas PZHK-së.

Belicë- e shfrytëzojnë infrastrukturën në vendbanimin Kërninë.

Polanë- për shkak të numrit shumë të vogël të banorëve nuk është konsideruar rentabile në kontekst të investimeve, meqë banorët e saj shfrytëzojnë infrasturëne e vendbanimeve të afërta.

- Sport, qerdhe, postë, zyre vendi, kulturë

Cërkolez- salla e sportit është planifikuar në kuadër të shkollës eksituese ndrës qerdhja, posta, zyrja e vendit dhe objekti kuturore në pronë publike në brendi të vendbanimit.

Dubravë- është propozuar ridizjanim I hapësirës ekzistuese në ëtë cilën gjendet shkolla dhe QMF-ja duke e shtuar edhe qerdhen dhe një sallë të sportit.



Fig. 14 Një nga mundësitë e ridizajnit të kompleksit të përmbatjeve publike në Dubravë.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara

ZSH- 3

ZONË E SHËRBIMEVE TË KOMUNITETIT- ZSHK

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Në këtë zonë bëjnë pjesë të shërbimeve që lidhen me komunitetin duke filluar nga shërbimet e administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbimit arsimor, shërbimit shëndetësor dhe shoqëror, shërbimit fetar si dhe shërbimeve tjera të komunitetit.	
3.3.1	Kuvend Komunal- ZSHK-KK
	Zyre vendi- ZSHK-ZV
	Policia- ZSHK-P
	Zjarrëfikësit- ZSHK-ZF
3.3.2	Qerdhe- ZSHK-Q
	Shkollë fillore dhe e mesme e ultë- ZSHK-SHF
	Shkollë e mesme e lartë- ZSHK-SHM
3.3.3	Punkt I mjekësisë familjare- ZSHK-PMF

	Qendër e mjekësisë familjare- ZSHK-QMF
	Qendër kryesore e mjekësisë familjare- ZSHK-QKMF
	Qendër rehabilituese- ZSHK-QR
	Shtëpi për të moshuar- ZSHK- ShtM
	Shoqata për punë sociale- ZSHK-ps
	Qendra e komunitetit- ZSHK-KMN
	Stacion I veterinarisë- ZSHK-SV
3.3.4	Kishë- ZSHK-k
	Xhami- ZSHK-xh
3.3.5	Varreza- ZSHK-V
	SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA
3.1	Shërbim tregtar
4.2	Shërbime logjistike dhe depo

8.1.1 Shërbimi I administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale (3.3.1- HILUCS

3)

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat e komunitetit.

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E SHËRBIMEVE TË KOMUNITETIT	Simboli I zonës							
	Shërbim I adminstatës publike, mbrojtjes dhe sigursë sociale- Sip=339.704 ari	ZSHK							
	Kuvend Komunal, Zyre vendi, Policia, Zjarrfikësit	ZSHK 3.3.1							
	Zyre vendi janë propozuar në: Rakosh, Cërkolez, Vrellë, Bajë, Dobrushë, Zallq	Kuvend Komunal ZSHK-KK		Zyre vendi ZSHK-ZV		Policia ZSHK-P		Zjarrfikësit ZSHK-ZF	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m ²)	min	max	min	max	min	max	min	max
Vijat	Vija rregulluese (m')	2000	15000	500	2000	1500	5000	250	2000
Lartësia	Lartësia (m')	4.5	13	4.5	13	5.5	10	6.5	10.5
Intensiteti	ISHPKZH	40%		40%		40%		40%	
	ISN	0.4-1.2		0.4-1.2		0.3-0.8		0.3-0.8	

Vendparkime	SGJP	60%	60%	60%	60%
		2 VP / 100 m2	1 VP / 30 m2	1 VP / 1 Punëtor	1 VP / 1 Punëtor
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës. Të gjitha materialet e përdorura për fasada në objekte publike duhet të jenë të përpunuara në atë mënyrë që të kërkojnë më pak mirëmbajtje dhe të lehta për pastrim.				
Tjera	Distanca- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi i qasjes për objektet publike Te stacionet policore duhet të konsiderohet lidhja me hapësirës me komunitetin, duke ruajtur nivelin e duhur të sigurisë. Në stacionet e zjarrfikësve, lokacioni duhet të ketë qasje të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në rrugë për dalje të lehtë të kamionit në raste emergjente.				

Tab. 43 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për shërbime të administratës publike, mbrojtjes dhe sigursë sociale

8.1.2 Shërbimi arsimor (3.3.2- Kodi HILUCS 3)

Ndërtesat e institucioneve parashkollore- Lokacionet e zgjedhura kanë pasur parasysh kriteret si në vijim:

- Në kuadër të zonës së banimit;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ndotura;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

Ndërsa institucionet e arsimit parauniversitar, kriteret si:

- në afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
- në kuadër të zonës së banimit në vendbanime rurale;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;

- në largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore;
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industrial

Bazuar në normat e sipërpërmendura për institucionet e arsimit janë përpiluar edhe kushtet zhvillimore dhe nërtimore.

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E SHËRBIMEVE TË KOMUNITETIT	Simboli i zonës					
	Shërbimi arsimor Sip=336.826 ari	ZSHK					
	Qerdhe-kopsht,shkollë fillore dhe e mesme e ulët, shkollë e mesme e lartë	ZSHK 3.3.2					
Qerdhe të propozuara në: Dobrushë, Dubravë, Cërkolez Shkollë fillore e propozuar në: Dobrushë		Qerdhe/ kopsht ZSHK-Q		Shkollë fillore dhe e mesme e ulët ZSHK-SHF		Shkollë e mesme e lartë ZSHK-SHM	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m2)	min	max	min	max	min	max
		2000	3000	1565 4774	8310 13017	6700	12000
	Pjesa e përparme e parcelës (min)						
Vijat	Vija rregulluese (m')	7.5 m - 15 m		7.5 m - 15 m		7.5 m - 15 m	
Lartësia	Lartësia (m')	4	8.5	5	12	5	12
Intensiteti	ISHPKZH	30%		40%		40%	
	ISN	0.25-0.5		0.5-1.0		0.5-1.0	
	SGJP	70%		60%		60%	
Vendparkime		1 VP / 100 m2		0.5 VP / 100 m2		0.5 VP / 100 m2	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.						

Tjera	Distancat- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore publike dhe teknike. Lokacioni duhet të jetë me diell, oborri duhet të ketë orientim ku ka së paku 50% diell. Të planifikohen parkingje të shpejta dhe qasje të sigurtë për fëmijët në ndërtesat e arsimit. Të punohet në konceptin e "rrugëve të gjelbra" për në shkollë. Parcela e shkollës të rrethohet me gardh për arsye të sigurisë. Duhet të analizohet dhe të propozohet përdorimi i hapësirave rekreative të shkollave edhe për nevojat e komunitetit përreth.
-------	---

Tab. 44 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për institucionet arsimore

8.1.3 Shërbim shëndetësor dhe shoqëror (3.3.3- Kodi HILUCS 3)

Shërbimet mjekësore- sistemi I infrastrukturës shëndetësore në komunën e Istogut përbëhet nga niveli parësor dhe dytësor. Lokacionet e zgjedhura të institucioneve shëndetësore të nivelit parësor kanë marrë për bazë kriteret si:

- në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ndotura;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat.

Infrastrukturën e institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor që gjenden në komunën e Istogut e përbëjnë:

- Ndërtesat e ambulancave specialistike;
- Ndërtesat e ambulancave stomatologjike;
- Ndërtesat e qendrave të rehabilitimit fizik dhe klimatik.

Sipërfaqja për kokë banori për këtë kategori është 1.2 m²/banor, ndërsa indeksi I shkërrëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) është 50%.

Ndërtesat e institucioneve të mirëqenies sociale dhe të komunitetit- Infrastruktura e institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetet në komunën e Istogut përfshinë:

- Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare;

- ndërtesat e institucioneve për përkujdesje sociale ndaj personave me nevoja të veçanta;
- Ndërtesat e institucioneve të komunitetit.

Sipërfaqja për kokë banori për ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare është: 0.25 m²/banor, ndërsa për institucionet e komunitetit është 0.20 m²/banor.

Lokacionet kryesisht janë përzgjedhur duke u bazuar në kriteret si:

- Terren të rrafshët
- Në afërsi me infrastrukturën rrugore, shtigjeve për këbësorë dhe biçikleta si dhe qasjen për transport public
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë

Bazuar në normat e sipërpërmendura janë dhënë edhe kushtet zhvillimore dhe ndërtimore.

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E SHËRBIMEVE TË KOMUNITETIT	Simboli I zonës					
	Shërbim shëndetësor dhe shoqëror Sip=832.533 ari	ZSHK					
	Qendër e mjekësisë familjare, punkt i mjekësisë familjare, shtëpi për të moshuar	ZSHK 3.33					
Punkte të mjekësisë familjare të propozuara në: Kërninë, Padalishtë		Qendër e mjekësisë familjare ZSHK-QMF		Punkt i mjekësisë familjare ZSHK-PMF		Shtëpi për të moshuar ZSHK- SHTM	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m2)	min	max	min	max	min	max
		2000	5000	600	1000	550	1900
		0.20 m2 / banorë				0.25 m2 / banorë	
Vijat	Vija rregulluese (m')	sipas profilit rrugor					
Lartësia	Lartësia (m')	4	8.5	4	8.5	4	8.5
Intensiteti	ISHPKZH	40%		40%		40%	
	ISN	0.3-0.8		0.3-0.8		0.3-0.8	
	SGJP	60%		60%		60%	
Vendparkime		1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2		0.5 VP / 100 m2	

Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës. Qasje e lehtë për Ambulancën në raste emergjente. Strehë para ndërtesës. T'iu jepet rëndësi e veçantë kopshteve rreth klinikave për rehabilitimin e pacientëve. Shtëpitë për të moshuar të jenë në zona ku mund të ndërldhen me funksione të tjera të qytetit që të kenë mundësi kontribuimi në shoqëri. Në ndërtesat 1 katëshe të Shtëpive për të moshuar, preferohet të ndërtohen nga konstrukcioni i drurit. Qarkullimi brenda lokacionit të shtëpisë për të moshuar duhet të jetë sa më i thjeshtë, që të mos shkaktojë konfuzitet dhe çorientim.
Tjera	Distanca- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- siguri i qasjes për ndërtesë mjekësore të bëhet para zhvillimit të parcelës Të jetë e dukshme hyrja në front të rrugës.

Tab. 45 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për institucionet shëndetësore

8.1.4 Shërbim tjetër I komunitetit (3.3.5- Kodi HILUCS 3)

Kjo klasë përfshinë hapësirat e shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të tjera të komunitetit siç janë varrezat (ZSHKV).

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së varrezave është 1.5 m²/banor, ndërsa Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) është 40%.

Përpos afërsisë të zonave të banimit dhe infrastrukturës rrugore, shtigjeve për biçikleta dhe qasjes në transport publik, lokacionet e varrezave nuk janë planifikuar në afërsi më të vogël se 300 m nga zona e banimit dhe jo në largësi më të madhe se 15 km nga vendbanimi.

8.2 Zona e shërbimeve kulturore, argëtuese dhe rekreative, ZSHKR (3.4 Kodi HILUCS 3)

Në këtë zonë bëjnë pjesë të gjitha shërbimet kulturore, argëtuese, sportive, rekreative dhe shërbime tjera rekreative.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Istogut këto shërbime ofrohen:

Shtëpi e kulturës gjendet në Istog, Rakosh, Bajë dhe Gurrakoc. Ndërsa janë propozuar në Cërkohez, Dobrushë dhe Zallq.

Bibliotekë/Shtëpi e kulturës gjendet në Istog, Bajë dhe Gurrakoc.

Muze arkeologjik/Shtëpi e kulturës gjendet në Istog.

Sport ekzistuese janë në Istog, Gurakoc dhe Osojan, ndërsa janë propozuar në Veriq, Kërninë, Belicë, Dragolevc, Dubravë, Synejë, Mojstir, Bollopojë, Rakosh, Cërkolez, Padalishtë, Uçë, Zhakovë, Shushicë, Vrellë, Lubozhdë, Cërrcë, Muzhevnë, Kalijan, Orobërdë, Studenicë, Dubovë e vogël, Bajë, Corrollukë, Lubovë, Prigodë, Kashicë, Staradran, Prekalë, Trubuhoc, Dobrushë, Llukavc I bregut, Llugë, Tomoc, Llukac I thatë, Zallq, Zabllaq, Drejë, Shalinovicë, Kosh, Polanë, Kovragë dhe Tuçep.

Park ekzistues gjendet në Istog, Bajë, Dobrushë dhe Gurakoc.

Shfrytëzimet e lejuara, dytësore, të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara për zonën e shërbimeve kuturore, argëtues dhe rekreative

ZSH-4

**ZONË E SHËRBIMEVE KULTURORE, ARGËTUESE DHE REKREATIVE-
ZSHKR**

HILUCS Kodi I shfryt. të tokës	SHFRYTËZIMET E LEJUARA
Arsyetimi dhe qëllimi: Kjo zonë parasheh të gjitha shërbimet kulturore, argëtuese dhe sportive duke përfshirë jo vetëm ndërtesat por edhe hapësirat e hapura rekreative si parqet kombëtare, zonat natyrore dhe shërbime tjera .	
3.4.1	Bibliotekë- ZSHKR-B
	Muze- ZSHKR-M
	Galeri- ZSHKR-G
	Teatër- ZSHKR-T
	Shtëpi e kulturës- ZSHKR-SHK
3.4.2	Park memorial- ZSHKR-PM
3.4.3	Stadion- ZSHKR-S
	Palestër sportive- ZSHKR-PS
	Fushë sporti- ZSHKR-FS
3.4.4	Sport dhe rekreim- ZSHKR-SR
	Park- ZSHKR-P
	Pyll- ZSHKR-p
	Gjelbërim përgjatë sipërfaqve ujore- ZSHKR-gj
3.4.5	Shesh- ZSHKR-sh
SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË VEÇANTA	
3.1	Shërbim tregtar
5.3	Shfrytëzim tjetër banimi
4.3	Shërbime publike

Tab. 46. Shfrytëzimet e tokës për shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore

8.2.1 Shërbimi kulturor (3.4.1- Kodi HILUCS 3)

Infrastruktura e institucioneve publike kulturore në Istog përbëhet nga:

- Ndërtesa e bibliotekës
- Ndërtesa e 'shtëpive' të kulturës
- Ndërtesa e teatrit
- Ndërtesa e kinemasë

Këto ndërtesa kanë qenë të përcaktuara me plane zhvillimore urbane si dhe me planet rregulluese në fuqi.

Sipërfaqet e zonës së shërbimeve janë:

- Shërbim kulturor- Sip=186.205 ari
- Shërbim argëtues- Sip= 170.791 ari

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE		ZONA E SHËRBIMEVE KULTURORE, ARGËTUESE DHE REKREATIVE		Simboli i zonës											
		Shërbim kulturor		ZSHKR											
		Bibliotekë, muze, galeri, teater, shtëpi e kulturës, qendër e komunitetit		ZSHKR 3.4.1											
Shtëpi e kulturës është propozuar në: Cërkohez, Dobrushë, Zallq				Bibliotekë ZSHKR-B		Muze ZSHKR-M		Galeri ZSHKR-G		Teater ZSHKR-T		Shtëpi e kulturës ZSHKR-SHK		Qendra e Komunitetit ZSHK-KMN	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m2)			min 750	max 2500	min 800	max 1200	min 500	max 1000	min 800	max 1200	min 750	max 2500	min 400	max 1000
Vijat	Vija rregulluese (m')			sipas profilit rrugor											
Lartësia	Lartësia (m')			5	8.5	4	8.5	4	8.5	4	13	5	8.5	5	8.5
Intensiteti	ISZPK			40%		40%		40%		40%		40%		40%	
	ISN			0.3-0.8		0.25-0.5		0.25-0.5		0.25-0.5		0.3-0.8		0.5-1.2	
	SGJP			60%		60%		60%		60%		60%		60%	
Vendparkime				1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2		1 VP / 100 m2	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës. Të gjitha këto ndërtesa duhet të jenë atraktive dhe kualitative që të kontribojnë në krijimin e ndjenjës së krenarisë dhe identitetit të përdoruesit të tyre. Hyrja në Bibliotekë dhe Shtëpi të kulturës duhet të jetë e dukshme dhe në atë pjesë ku është qasja më e madhe e shfrytëzuesve. Të identifikohen lehtë dhe të njihen nga komuniteti si objekte publike për përdorim të komunitetit. Të hapura (fizikisht) për t'u dalluar nga jashtë (kalimtarët) se çfarë aktiviteti zhvillohen brenda qendrave të komunitetit.														
Tjera	Distancat- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- siguri i qasjes për ndërtesë publike të behët para zhvillimit të parcelës Lokacioni për këto ndërtesa publike duhet të jetë në një ambient të qetë, me ndriçim natyral dhe hapësira të mjaftueshme. Në vendet ku ka zhurmë dhe ndotje, të krijohet një tampon i gjelbërimit rreth parcelës së ndërtesës.														

Tab. 47 Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për ndërtesat kulturore

8.2.2 Infrastruktura sportive dhe rekreative (3.4.3- Kodi HILUCS 3)

Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative në Istog përbëhet nga:

- Ndërtesa e sallave sportive;
- Fushat sportive- rekreative shume- funksionale;
- Shtigjet për ngjitje dhe marshim alpin;
- Shtigjet për çiklizëm;

- Shkëmbinjtë natyror dhe artificial për ngjitje;

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) për ndërtesat sportive është 60%, ndërsa distanca optimale shërbyese për fushat sportive dhe rekreative është 800 m.

Lokacionet janë tentuarr të sigurohen në lokacione të diellosura dhe të mbrojtura nga erërat e forta , të jenë të rrafshta dhe në disa raste edhe pranë burimeve.

KUSHTET ZHVILLIMORE NDËRTIMORE	ZONA E SHËRBIMEVE KULTURORE, ARGËTUESE DHE REKREATIVE	Simboli i zonës			
	Infrastrukturë sportive Sip=5797.60 ari	ZSHKR			
	Stadion, sallë sportive, Fushë sporti në të hapur	ZSHKR 3.4.3			
Fusha sportive janë propozuar në: Veriq, Kërninë, Belicë, Dragolevc, Dubravë, Synejë, Mojstir, Bollopojë, Rakosh, Cërkolez, Padalishtë, Uçë, Zhakovë, Shushicë, Vrellë, Lubozhdë, Cërrcë, Muzhevnë, Kaliqan, Orobërdë, Studenicë, Dubovë e vogël, Bajë, Corrollukë, Lubovë, Prigodë, Kashicë, Staradran, Prekallë, Trubuhoc, Dobrushë, Llukavc I bregut, Llugë, Tomoc, Llukac I thatë, Zallq, Zabllaq, Drejë, Shalinovicë, Kosh, Polanë, Kovragë, Tuçep		Fushë sporti ZSHKR-FS		Sallë sportive ZSHKR-PS	
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (m2)	min	max	min	max
		700	12000	4000	12000
Vijat	Vija rregulluese (m')	sipas profilin rrugor			
Lartësia	Lartësia (m')	/	/	8.6	10.6
Intensiteti	ISHPKZH			60%	
	ISN			0.5-1.0	
	SGJP			40%	
Vendparkime		1VP/200-300m2		1VP/20 ulëse të paktën 10 VP	
Formësimi arkitektonik dhe estetik	Formësimi arkitektonik dhe estetik në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kushtet zhvillimore të përgjithshme. Forma dhe ngjyrat t'i përshtaten kontekstit si dhe funksionit të ndërtesës.				
Tjera	Distancat- duhet të mirren parasysh: orientimi, raporti me parcelat fqinje, raporti me rrugën, lëvizshmëria në rastet emergjente etj. Siguria nga zjarri- në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri. Qasja në infrastrukturë rrugore dhe teknike- sigurimi i qasjes për ndërtesë sportive të bëhet para zhvillimit të parcelës Hyrja e dukshme nga qasja kryesore në lokacion; struktura e duhur për objekte sportive; sinjalizimi brenda lokacionit; materialet kualitative për strehën e kulmit dhe mureve				

Tab. 48. Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për infrastrukturën sportive


8.2.3 Hapësirë e hapur rekreative (3.4.4- Kodi HILUCS 3)

Hapësirat e gjelbra në Istog përbëhen nga:

- Parqet publike ose hapësirat e lira për shfrytëzim nga këmbësorët ose çiklistët
- Fushat e hapura sportive dhe rekreative.

Lokacionet kryesisht janë munduar të jenë në afërsi të zonave të banimit si dhe në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

Vërejtje: Në zonën urbane në Istog, parcella nr. 01758/1 është planifikuar si zonë e shërbimeve duke mos e përcaktuar nënkategorinë HILUCS 2 apo 3 duke iu lënë mundësinë e shfrytëzimit të komunës sipas kërkesave të tyre në të ardhmen.



Harta 8 Zona e shërbimeve

9.0 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Shërbimet publike- Infrastruktura teknike, ZKT-IT (4.3 Kodi HILUCS 3)

9.1 Rrjeti i ujësjellësit

Furnizimi me ujë i qytetit të Istogut bëhet drejtpërdrejt nga burimi i Istogut. Në burimin e Istogut ekziston kaptazha ku grumbullohen uji. Kaptazha është e tipit të hapur, kështu që bëhet dezinfektimi i ujit para se të lëshohet në rrjet.

Gypi kryesor është me diametër Ø300 nga AC dhe ky diametër vazhdon duke u zvogëluar. Pasi që nga ky gyp do të furnizohen edhe vendbanimet që momentalisht nuk kanë ujë të pijshëm, është i domosdoshëm ndërrimi i këtij gypi dhe rritja e dimensionit të tij.

Problemi kryesor i furnizimit me ujë të pijshëm janë gypat që janë nga materiali i ndryshëm dhe me dimensione më të vegjël.

Bazuar në parashikimet demografike për 8 vitet e ardhshme, rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe rrjetin rrugor të propozuar është planifikuar edhe rrjeti i ujësjellësit. Dimensionimi i rrjetit të ujësjellësit është bërë duke u bazuar në këto të dhëna:


- Norma L/banor/dit = 180 liter
- Koha e përdorimit (orari i përdorimit) 16 ore
- Koeficienti ditor i jo njëtrajtshmërisë 1
- Koeficienti orare i jo njëtrajtshmërisë 2.

Sipas këtyre të dhënave disa nga gypat duhet të ndërrohen për shkak të vjetërsisë së tyre, kurse disa për shkak të dimensioneve të vogla. Për shfrytëzimin maksimal më të mirë të sasisë së ujit ekzistues si dhe të presionin në disa vende janë paraparë krijimi i unazave të reja.

Furnizimi i vendbanimeve të komunës së Istogut bëhet nga disa sisteme. Barrën më të madhe të furnizimit me ujë e bartë burimi i Istogut i cili furnizon me ujë të pijshëm 45% të komunës. Furnizues tjerë janë burimi i Vrellës, Vojdullës/Kosharicës, Javorit dhe burimi i Radavcit

Mungesë të qasjes së ujit të pijes në komunën e Istogut kanë 3 vendbanime: Kerninë, Polanë dhe Blice, është duke u zhvilluar projekti për qasjen e disa fshatrave tjerë nga Qeveria Austriake i cili pritet që brenda vitit 2021 të përfundojë.

Burimi i Istogut ka sasi të mjaftueshme për furnizimin e tërë komunës me ujë të pijshëm, mirëpo gypat ekzistues nuk kanë dimensionet e mjaftueshme. Prandaj, gypi kryesor furnizues duhet të zëvendësohet me gypi të materialit aktual dhe me dimensione më të madh Ø400mm.



Harta 9 Rrjeti i ujësjiellësit

9.2 Rrjeti i kanalizimit

Qyteti i Istogut ka sistemin e rrjeti të kombinuar të kanalizimit dhe nuk është i shtrirë në tërë qytetin. Dimensionet e këtyre gypave janë të vegjël dhe shpesh nuk pranojnë të gjitha ujërat e zeza dhe ato atmosferike. Me Planin Zhvillimor Komunal është paraparë sistem i ndarë i kanalizimit: në rrjet të kanalizimit fekal dhe rrjet të kanalizimit atmosferik. Në bazë të këtij koncepti edhe janë realizuar disa nga rrjetet si psh ai në vendbanimin e Studenicë, Saradran, Suhogërrll, Kashicë, Gurakoc (degezim), Bajicë, Dubovë e Vogël etj.

Në bazë të dimensione të gypave ekzistuesi është planifikuar që këta gypa të shfrytëzohen për rrjetin e kanalizimit fekale, kurse rrjeti i kanalizimit atmosferik të ndërtohet i ri.

Orientimi i të gjitha gypave të kanalizimit fekale do të jenë në drejtim të rrugës kryesore pasi që kolektori kryesor do të jetë në këtë drejtim. Prandaj, në disa rrugë duhet të ndërrohet kahja e gypave. Secila rrugë do të ketë gypin e vetë të kanalizimit fekale dhe atmosferik dhe kahja e tyre do të caktohet varësisht nga konfiguracioni i terrenit.

Siç u cek edhe më lartë rrjeti i kanalizimit atmosferik do të jetë plotësisht i ri. Të gjithë ujërat atmosferike do të shkarkohen në lumin Istog dhe në prrojet e qytetit. Pra, drejtimi i gypave do të përshtatet konfiguracionit të terrenit të qytetit. Në mënyrë që gypat të kenë dimensione më të vogla është planifikuar që gjatësia e gypave të jetë më e vogël dhe të ketë sa më shumë shkarkimi në lumë.


Sistemi është i ndërtuar dhe Operuar si Sistem Miks ku përfshihen Ujerat e Zeza dhe Ujerat Atmosferike.

Koncepti i zhvillimit të rrjetit të kanalizimit - Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit duhet të bëhet në mënyrë suksesive duke mbuluar gradualisht zonat më problematike e kështu me radhë. Po ashtu ti kushtohet rëndësia e parë mbulimit të zonave që nuk kanë të ndërtuar rrjetin e Kanalizimit.

Shtrirja e rrjeteve të cilat duhet të riparohen do të bëhet sipas normave të planifikimit hapësinor, Ligjeve dhe Udhëzimeve në fuqi, vetëm në rastet kur nuk lejohen mundësitë në terren të aplikohet një rregull i tillë, apo bie ndesh me rregulla tjera dhe në raste kur zgjedhja Inxhinierike ose edhe aspekti Ekonomik e Mjedisore e favorizojnë një zgjedhje të qëndrueshme në segmente të caktuara.

Shtrirja e rrjetit brenda projektit duhet të bëhet në harmoni me kushte përzgjedhjen e lokacionit të cilat janë të specifikuara të kushtet zhvillimore për projektim.

Është e rëndësishme që për komplet rrjetin të ndërtohet një model i mirëfilltë Hidraulik dhe ai model të shfrytëzohet nga K.R.U “Hidroregjioni Jugor” në mënyrë sa më efektive.



Harta 10 Rrjeti i kanalizimit fekal

9.3 Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza

Ndërtesat përcjellëse të Kanalizimit

- Puset kontrolluese
- Objektet për ndarjen e kanalizimit fekale me atë atmosferik
- Stacionet e pompimit
- Impiantet Industriale për trajtimin e ujerave te zeza

Impiantet për trajtimin e ujerave industriale

Këta impiante duhet të instalohen ne te gjitha objektet ku shkarkimet e ujerave te zeza kanë shkallen e ndotjes aq te larte sa e parasheh Udhëzimi Administrativ.

Nr.	Objektet	Njësia matëse	Norma e shkarkimit litra	Kof. Kd	Kof. Kd
1	Banjo	Një Larje	150-80 L	1	1
2	Lavanderi	1kg Rroba	60-70 L	1	1
3	Mens – Restorant	Një Klient	15-25 L	1	1.5
4	Spital	Një Shtrat	250-300 L	1	2.5
5	Dispanceri	Një Pacient	6-10 L	1	2
6	Sanatorium	Një Shtrat	300-400 L	1	2.5
7	Kopsht	Një Fëmijë	75-80 L	1	2
8	Qerdhe	Një Fëmijë	75-80 L	1	2
9	Shkolle	Një Nxënës	5-10 L	1	1.5
10	Institut	Një Student	7-12 L	1	1.5
11	Park Kamionash	Një Kamion	500 L	1	1
12	Park Veturash	Një Veture	300 L	1	1
13	Ujitje	1 m ² Sipërfaqe	2-5 L	1	1
14	Furrë Buke	1 Ton Bukë	2000 L	1	1
15	Stacion Treni	1 m ² Sipërfaqe	0.5-1 L	1	1
16	ËC Publike	Një Vend	500 L	1	1

Tab. 49 Normat e përdorimit

Norma e ujerave te Përdorura	N <200	N=1000 – 10000	N=1000 – 25000	N>25000	Kd
60-90	2.2	1.8	1.7	1.5	1.2
90-120	1.8	1.6	1.4	1.2	1.5
150-200	1.6	1.4	1.3	1.15	1.1

Tab. 50 Norma e ujerave të përdorura L/dite

Norma mesatare ditore	Orare	Ditore	E Përgjithshme
-----------------------	-------	--------	----------------

60-90	1.3 – 1.5	1.2 – 1.3	1.6 – 1.8
90-120	1.2 – 1.5	1.10 – 1.15	1.45 – 1.75
150-200	1.15 – 1.3	1.10 – 1.15	1.3 – 1.5

Tab. 51 Norma mesatare ditore

Si në çdo vendbanim të Kosovës edhe në Komunën e Istogut ndotja e ujit është e evidentë. Ndotja më e madhe paraqitet e lumenjve bëhet përmes lëshimit të drejtpërdrejt të ujërave të zeza të vendbanimeve dhe të objekteve industriale, pa ndonjë trajtim paraprak. Gjithashtu hedhja e mbeturinat të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh.

Vlen të përmendet se nga 44 vendbanimet në komunën e Istogut 12 kanë kanalizim plotësisht, 19 prej vendbanimeve kanë pjesërisht si dhe 13 vendbanime akoma nuk kanë një shtrirje të mirëfillte të rrjetit të kanalizimit fekale.


Trajtimi i ujërave të zeza

Koncepti strategjik: Rehabilitimi dhe zëvendësimi i pjesërisht të rrjetit të ujërave të zeza në bazë të kyçjeve shtëpiake.

Për shkak të faktit se sistemi i kombinuar i kolektorit kryesor është plotësisht funksional për momentin, ky do të mbetet si sistem i kombinuar. Por ngarkesat e ujërave të shiut duhet të reduktohen dhe objektet për kapërderdhjen e ujërave të shiut duhet të ndërtohen në afërsi të pikës shkarkuese.

Bashkimi i pikave të ndryshme shkarkuese të ujërave të zeza dhe ndërtimi i kolektorit kryesorë për transportimi i ujërave të zeza në impiant të trajtimit (ITUZ). Rehabilitimi i pjesëve të rrjetit kryesor të ujërave të zeza duke përfshirë edhe kyçjet shtëpiake. Pastrimi i kanaleve sipërfaqësore nga kyçjet e parregullta të ujërave të zeza. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit si sistem plotësisht i ndarë për zonat e zgjerimit urban.

Figurat e mëposhtme krahasojnë në mënyrë skematike gjendjen e tanishme të sistemit të ujërave të zeza të sistemit të kombinuar dhe sistemit të ndarë me konceptin strategjik të rrjetit për 2046.






Fig. 15 Sistemi aktual i përzier dhe ai i ndarë që planifikohet

Sipas udhëzimit 13/2008 më poshtë janë paraqitur vlerat që lejohen të shkarkohen në trupat ujorë pas trajtimit të ujërave të zeza:

Kërkesat sipas udhëzimit				
a) Uji i trajtuar		Përqëndrimi (mg/l)	Përqindja e trajtimit 2021	Përqindja e trajtimit 2046
Shpenzimi biokimik i Oksigjenit SHBO ₅ - (BOD ₅)	<	25	70 - 90%	90 %
Shpenzimi kimik i Oksigjenit SHKO – (COD)	<	125	75%	75%
Largimi total i pjesëve të ngurta – (T.S.S.)		35 (mbi 10,000 banorë)	90% (mbi 10,000 banorë)	mg/l
Total azot - TN	(15	----	----	80%
Total fosfor - TP	(2)	----	----	80%
b) Llumi				
- Thatësia (% D.M. në peshë)	≥	22	22	%

Tab. 52 Vlerat kufizuese të efluentit urban që shkarkohet nga impianti

Sipas numrit të banorëve që gjenden në vendbanime përkatës kemi menduar edhe ndërtimin e Impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe atë dy Impiante:

- Impianti kryesore qe përfshinë Qytetin e Istogut si dhe Bashkësinë lokale te Gjurakovcit me 21 vendbanime tjera
- Impianti i dyte do përfshije Bashkësinë lokale Vrellë dhe Banje me 7 vendbanime tjera

Skema e tyre po e paraqesim me poshtë:





Fig. 16 Skema e impiantit

Kurse do kemi edhe 12 vane banime qe kane pozite shume te përshtatshëm për ndërtimin e impianteve te decentralizuar dhe ato janë: Kosh, Planë, Osojan, Kerninë, Bollopojë, Mojtirë, Shushicë, Zhakovë, Uçë, Cerrkolez, Suhagërl, Kaliqan. Këta impiante do jenë të lehta për ndërtim me kosto të ulët po ashtu edhe operimi dhe mirëmbajtja shume efikase me poshtë po paraqesim konceptim për ta.

Modeli ËETLENDE VERTIKALE DHE HORIZONTALE.

Moqalishtet vertikale janë të ndërtuara nga filtra me të mbjella bimore. Janë disa filtra të mbushur me shtresa të njëpasnjëshme të zhavorrit të cilët ujiten (mbushen) me efluent çdo 3-4 ditë. Ujërat e zeza shpërndahen mbi sipërfaqen e moqalishteve nga lart duke përdorur sistemin e shpërndarjes me rënje të lirë. Uji i shpërndarë rrjedh mbi filtër në mënyrë vertikale.

Materiet e ngurta filtrohen më së shpeshti në sipërfaqe ku thahen dhe humifikohen dhe pastaj shndërrohen në bio masë.



Përderisa kalon përmes filtrit, pjesa e lëngshme është subjekt i trajtimit fizik (filtrimi) dhe trajtimit biologjik. Uji i trajtuar në këtë filtër drenazhohet dhe shkarkohet në lumë ose tek etapa e dyte, varësisht nga kërkesa. Etapa e parë e moqalishteve vertikale kërkon një sipërfaqe prej 1.2 m²/banorë të ndarë në 3 filtra dhe me rënje përafërsisht 2 m pjerrësi. Niveli i arritur i trajtimit të ujërave të zeza me këtë opsion është largimi rreth 80 % të SHKO-së dhe 90 % të materieve të ngurta.

Trajtimi sekondar me moqalishte vertikale kërkon sipërfaqe shtesë prej 0.8 m²/banorë të ndarë në 2 filtra dhe përafërsisht 2 m pjerrësi. Pjerrtësia e saktë e nevojshme varet nga dimensionet e filtrit. Nëse pjerrtësia nuk është në dispozicion atëherë pompa është e nevojshme. Niveli i pastrimit të arritur me anë të këtij trajtimi (kombinimin e 2 etapave vertikale) është largimi i SHKO-së më shumë se 90 % dhe i materieve të ngurta rreth 95 %, që shpjen tek kuota maksimale prej 25 mg/L e SHBO5 për efluentin e shkarkuar. Moqalishtet e ndërtuara horizontale janë një filtër i ngopur me ujë.

Efluenti shpërndahet mbi kallamishte, pastaj ai rrjedh horizontalisht përmes një shtrese të hollë zhavorri kualitativ. Uji shkon në drenazhë i cili ndodhet në anën tjetër të shtratit të pondit. Kjo drenazhë është e lidhur me një pusetë e cila e lejon që rrjedhja e ujit të rregullohet.

Etapa e dytë e moqalishteve horizontale kërkon sipërfaqe prej përafërsisht

1.2 m²/banorë dhe 1 m pjerrtësi.

Niveli i trajtimit të arritur për kombinimin e 2 moqalishteve të ndërtuara me rrjedhje vertikale dhe horizontale na shpie deri tek kuota maksimale prej 25 mg/L të SHBO5 për efluentin e shkarkuar.




Fig. 18 Prerja gjatësore e implantit horizontal

9.4 Sistemi e drenazhimit

Komuna e Istogut për shkak të karakteristikave gjeomorfologjike si dhe kualitetit të tokës është e ndarë në 3 zona karakteristike në kontekst të drenazhimit:

- sipërfaqet të cilat janë të nënshtruara ndaj qëndrimit të ujit nga të reshurat
- sipërfaqet e rrezikuara nga uji sipërfaqësor dhe nëntokësor, dhe
- terreneve me lagështi të brendshme të tokës


9.5 Rrjeti e ujitjes

Në komunën e Istogut ekzistojnë disa sisteme të ujitjes si: sistemi i Orobërdës 1.070 ha (neto), 1.350ha (bruto). Për ujitjen e sipërfaqeve të përfshira me sistem shfrytëzohen ujërat e burimit të Vrellës, debiti i të cilit bie në 100 l/sek,

Sistemi gjysmë fiks është i lënë pas dorës dhe është i shkatërruar. Sistemi i kullimit nuk është ndërtuar në tërësi sipas projektit. Sistemi i Anës së Djathtë (1.720 ha neto, 2.120 ha bruto) nuk ka qenë i përfunduar së ndërtuari dhe furnizohet me ujë nga Burimi i Lumit të Istogut.

Sistemi Ana e Majtë përfshinë sipërfaqet prej 1.400 ha të cilat ujitën nga kanali i betonit dhe 320 ha me kanale të hapura dheu. Sistemi i Dubravës përfshinë sipërfaqen prej 800 ha (neto) dhe është sistem gjysmë fiks, ndërsa ujitja është dashur të bëhet në trajtë shiu. Presioni duhet të arrihet për mes të Stacionit të pompimit “Dubrava” i cili nuk është në funksion. Sistemi “Gusar” 400 ha (neto) është sistem me ujitje në trajtë të shiu. Presioni arrihet pjesërisht në mënyrë natyrore dhe artificiale. Ujitja në trajtë shiu nuk është në funksion që nga ndërtimi i tij, për shkak të mungesës së ujit.

Sa l përket komasacionit, në komunë e Istogut nuk ka pasur ndonjë projekt apo aktivitet të ndërmarrur për rregullimin e tokave bujqësore sipas përcaktimit të Ligjit nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës.



128

9.6 Rrjeti I energjisë elektrike

Bazuar në planin zhvillimor komunal të Istogut, kërkimeve dhe analizave në teren, janë nxjerrur përfundimet mbi gjendjen ekzistuese dhe janë paraqitur nevojat për shtimin e kapaciteteve energjetike, kapaciteteve të reja në ndriçimin e rrugëve dhe për rrjete të reja telekomunikuese.

Duke u nisur nga Plani Zhvillimor Komunal, gjendja ekzistuese si dhe propozimet arkitektonike, Rrjeti i Energjisë Elektrike dhe Rrjeti Telekomunikues duhet të përditësohet në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

1. Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës, që përfshinë:
 - Eliminimin gradual të TS 35/10 kV dhe kalimin në TS 110/20 kV
 - Kalimin nga rrjeti distributiv 10 kV në rrjetin distributiv 20 kV
 - Zëvendësimin e TS 10/0.4 kV me ata 20/0.4 kV
 - Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kablllo bistek apo edhe kablllo nëntokësorë.
2. Regulloret e IEC, IEEE dhe ANSI që për projekte të reja në vende urbane, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe ato të rrjetit telekomunikues të ndjekin të njëjtën trasë dhe të realizohen në të njëjtën kohë.

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) udhëzon që të bëhet përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të Internetit dhe telefonisë.

Gjendja aktuale elektroenergjetike

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit si dhe furnizimit të konsumatorve me energji elektrike, i tërë konsumi i Istogut, në nivelin distributiv, menaxhohet dhe eksploatohet nga distrikti i Pejës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit distributiv kjo njësi participon vetëm me shënimet nga terreni. Poashtu për implementimin e projekteve të reja, kjo njësi punuese vetëm garanton furnizim me energji elektrike, si dhe merr pjesë në pranimet teknike të objekteve të reja për nivelin distributiv.

Qyteti i Istogut me rrethinë furnizohet nga trafostacionet:

- TS Istogu 110/35/10 kV me fuqi instaluese 31,5 MVA, pronë e kompanisë KOSTT dhe
- TS Gjurakoc 35/10 kVA me fuqi 2x4 MVA, pronë e kompanisë KEDS.

TS Istogu furnizohet përmes linjës së dyfishtë 110 kV-she, konkretisht linjës TS Peja 3 - TS Istogu. Vlen të potencohet se siguria furnizuese në nivelin 110 kV relativisht është e mirë, nga shkak se rënja e njëres nga linjat 110 kV nuk shkakton pamundësinë e furnizimit kontinual të Istogut me rrethinë, pra plotësohet kriteri shumë i nevojshën N-1.

Trafostacioni 400/110 kV me fuqi 2x300 MVA - Peja 3, rritë besueshmërinë e sistemit dhe nivelin e tensionit në Istog, sepse ky qytet për një kohë të gjatë ndodhej larg pikave injektuese të njësive gjeneruese.

TS Istogu 110/35/10 kV furnizon pjesën veriore të rrjetit distributiv të komunës së Istogut, ndërsa trafostacioni TS Gjirakoc 35/10 kV atë jugore.

Nga këto dy trafostacione furnizohen të gjitha daljet 10(20) kV. Në nivelin e tensionit të mesëm të gjitha objektet e instaluar elektro energjetike punojnë nën tension 10 kV.

Nga harta e rrjetit elektroenergjetik të Kosovës të publikuar nga KOSST (Fig. 1) shihet se në komunën e Istogut janë 3 nënstacione energjetike, duke përfshirë edhe TS Peja 3, që aktualisht gjendet në teritorin e komunës së Istogut.




Fig. 19 Harta elektroenergjetike e Kosovës (burimi: kostt, Sistemi transmetues I Republikës së Kosovës 2016)

Linjat furnizuese të tensionit të mesëm janë të dimensionuara kryesisht për nivelin 10 kV. Këto linja janë ajrore, të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD) në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD). Në disa nga trasat e linjave 10 kV

dhe 0.4kV, me shtylla të drurit, lartësia e pëçuesve është e ulët, distanca me objektet e banimit, afariste dhe shoqërore e pamjaftueshme, kalimet në rrugë janë joadekuate, kështu që nuk i përmbushin kriteret nga aspekti i sigurisë.

Në disa pjesë urbane të Istogut janë të vendosura edhe kablllo nëntokësore të nivelit 10(20) kV mirëpo në gjatësi shumë të kufizuar dhe që punojnë në tension 10 kV.

Njësitë transformuese janë të kombinuara, në pjesen urbane ka të tipit “blindë” TSMB, ndërsa në pjesët rurale trafostacionet janë të tipit “kullë” - TS Kullë, të montuara në shtyllë metalike -TSM dhe të montuara në shtyllë betoni -TSB. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuara dhe jo të mirëmbajtura si duhet. Edhe këtu një pjesë e konsiderueshme e objekteve transformuese nuk posedojnë pajisje teknisht në rregull, kështu që paraqesin rrezik për stafin operues dhe atë të mirëmbajtjes, e veqënisht për sigurinë e qytetarëve.

Mund të konstatohet se rrjetit distributiv në komunën e istogut është realizuar pa ndonjë analizë, sidomos në aspektin e optimizimit. Problem poashtu të theksuar paraqesin seksionet jo adekuate të përcuesve të linjave 10 kV-she në raport me gjatësitë e tyre dhe numri i trafostacioneve të kyçura në to.

Kushtet teknike për zhvillimin e rrjetit energjetik

Kushtet teknike janë dhënë bazuar në procedurat bazike që aplikohen gjatë planifikimit urban të një Sistemi Elektroenergjetik (SEE), e që janë:

1. Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
2. Analiza e rrjetit ekzistues
3. Ngarkesa aktuale dhe ajo e parashikuar
4. Planifikimi optimal i lokacionit, madhësisë dhe zonës së TS 20/0.4kV.
5. Planifikimi i rrjetit distributiv 20 kV.
6. Planifikimi i rrjetit distributiv 230/400V.
7. Analizat e rrjedhes së fuqisë.

Rrjeti ekzistues energjetik i transmisionit (KOSTT) dhe ai distributiv (KEDS) në pjesën më të madhe është i ndërtuar para më se 20 viteve, që dmth se linjat ajrore janë në gjendje teknike të keqe, ndërsa kabllot që tani furnizojnë shpenzuesit janë dielektrikisht të dobësuar, veqanërisht kabllot e tensionit 10 kV, të shtrira në kanale pa kanalizim kablllovik. Shumica e trafostacioneve janë të tensioneve 10/0.4 kV.

Vetëm në lagjet e reja të ndërtuara pas luftes janë të vendosura kabllot e tensionit 20 kV, mirëpo edhe këto pa ndonjë planifikim të mirëfilltë dhe me seksione jo adekuate për zgjerim të planifikuar.

Rekomandimet dhe rregulloret e lartëshënuara obligojnë që Rrjeti Energjetik dhe ai Telekomunikues të realizohen ashtu që:

Në të gjitha rrugët e asfaltuara në zonat Urbane, në njërën anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim, në thellësi mbi 750mm, të ndërtohet i ashtuquajti “kanalizimi kablovik” – Fig.2.

Numri dhe dimensionimi i gypave fleksibil të vendosur në kanalizim kabllorik përcaktohet në varësi nga nevoja. Do të ishte dashur të definohet në projektin detal – zbatues.

Zakonisht një kanalizim kabllorik përmban gypa të brinjëzuar me diametër prej 100mm, 160mm dhe 200mm që përforcohem me rërë.

Në këta gypa vendosen:

1. Linja të tensionit 10(20) kV me kablllo XHP 49A 240mm². Me këtë bëhet furnizimi i trafostacioneve të blinduara me herës 10(20)/0.4 kV dhe fuqi 400 kVA, 630 kVA dhe 1000 kVA.
2. Linja e tensionit 400/231 V me kablllo PP00 4x95 mm² për furnizimin e ndërtesave për banim kolektiv.
3. Linja e tensionit 400/231 V me kablllo PP00 4x25 mm² ose 4x16 mm² për furnizime të ndriçimit publik dhe banimeve individuale.
4. Linja të kablllove të komunikimit (kablllo me fije optike apo STP 4x0.75mm²).




Fig. 20 Trafostacionet distributive në vendbanimet e komunës së Istogut

Përgjatë trasës së kanalizimit kablovik duhet ndërtuar puseta me dimensione dhe forma të ndryshme sipas rastit. Në trasa të linjave të shumëfishta ndërtohen puseta të kombinuara – Elektrike – Telekom.

Pusetat kanë thellësi së paku 1.8 m dhe dimensione të brendshme së paku 1.8 m x 1.2 m. Puseta e përbashkët është e ndarë me mur betoni 20 cm në atë për rrymë dhe në atë për komunikim dhe kanë hyrje (vrime) të ndara.

Pusetat për kryqëzime të linjave të tensionit të ulët dhe linjave telekomunikuese mund të ndërtohen si të ndara dhe mund të kenë edhe dimensione më të vogla (por jo më të vogla se 1.2 x 1.2 x 1.2 m)

Hyrja në Puseta bëhet nëpër vrimën me formë rrethore me diameter së paku 75 cm. Në kapak duhet shkruar për puseta rryme – ELEKTRIKA, ndërsa për ato të komunikimit – TELEKOM.

Në zonat rurale, largpëçuesit (LP) ekzistues të nivelit 10 kV janë me shtylla druri, në të ardhmen duhet të ndërtohen vetëm për nivele 20 kV-she dhe atë në shtylla betoni. Trafostacionet (TS) e reja që do të ndërtohen në pjeset rurale duhet të jenë të punuara për

tension 10(20) kV në mënyrë që kur të vijë koha e kalimin në sistemin 20kV, ky kalim të mos vërehet.

Trafostacionet 10(20)/0.4 kV duhet të kenë fuqi të mjaftuashme për të furnizuar të gjithë konsumatorët me tension 230/400 $\pm 10\%$ V. Në rast se transformatorët furnizojnë objekte me banesa kolektive, me qëllim të ruajtjes së ambientit përreth objekteve, atëherë kur të ka mundësi teknike, rekomandohet që transformatorët të vendosen në mbrendi të objektit të ndërtuar.

Trafostacionet e vendosur në mbrendi të objektit do të duhet të plotësojnë kushtet teknike të parapara me standarde për objekte të tilla, që janë:

- Transformatorët që montohen në objekte duhet të jenë të tipit të thatë.
- Vendi i montimit të trafostacionit duhet të ketë çasje me pirun karrocë, të jetë i mbrojtur nga vërshimet dhe të ketë ventilim.
- Blloku i tensionit të mesëm duhet të ketë së paku një kthinë dalëse reserve për zgjerim të mëvonshëm.

Duke u bazuar në analizat e rrjetit energjetik të komunës së Istogut, duhet planifikuar zgjidhjet e mëposhtme:

1. Trafostacioni 35/10 kV TS Gjurakoc, që aktualisht furnizohet me Largëpërçues 35 kV nga TS 110/35/10(20) kV Peja 1, të dalë nga përdorimi si trafostacion 35/10 kV dhe të përdoret vetëm si nyje lidhëse 20 kV ndërmjet linjave ekzistuese dhe trafostacionit 110/10(20) kV në Istog.
2. Të eliminohen të gjithë largëpërçuesit 35 kV-tësh.
3. Operatorët e transmisionit KOSTT dhe distribucionit KEDS janë të obliguar që gjatë projektimit të linjave të tyre të jenë në harmoni me U.A. MMPH-NR. 08/2017 Për Normat teknike të Planifikimit Hapësinor, Kapitulli IV. Neni 16.
4. Bazuar në standardin EN 50341-1, dhe EN50341-3-1 distanca minimale e lejuar për banim rezidencial në afërsi të LP 110 kV, nga vija vertikale që lëshohet nga përçuesi nën tension 110 kV është 4 m. Me rekomandimet e KOSTT kjo distancë është rritur në 5 m.
5. Bazuar në pikën 3, dhe duke ditur se gjërësia e LP ekzistues 110 kV është 6 m, zona ku do të ndalohen ndërtimet e objekteve do të jetë 6 m+10 m=16 m, respektivisht ± 8 m nga boshti i largëpërçuesit 110 kV.
6. I tërë sistemi i furnizimit të trafostacioneve të reja dhe atyre ekzistuese do të bëhet me tension 20 kV, respektivisht me kablo të tensionit 24 kV dhe LP në shtylla të betonit. Kablo do të vendosen në kanalizim kabllorik përgjatë rrugëve në trotuara ashtu si është dhënë në vizatimet përkatëse. Të gjitha kabllot duhet të jenë të tipit XHP 49A. Këto kablo duhet llogaritur për ta bartur tërë ngarkesat e mundshme për 25 vitet e ardhshme dhe të kenë rezerve edhe së paku 20% për ndonjë rritje të paraparshikuar edhe për një kohë më të gjatë.
7. Numri i trafostacioneve dhe numri i banorëve që furnizohen nga to janë të dhëna në

situacion dhe në tabelën e Trafostacioneve Distributive.

Numri i TS-ve në Vendbanime është caktuar i tillë që për çdo m² të banimit, lokalit apo qendrës afariste të ketë në disponim fuqinë elektrike në vlerë prej 61.18Ë, respektivisht është parashikuar fuqi e instaluar në trafostacione lokale e tillë që për një banor në vendbanime trafostacioni të ketë në disponim 1.00 kVA

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve (ekzistues)	Nr. i banorëve (l parashikuar)	Numri i TS ekzistues	Numri i TS te reja
1	Banjë	1360	1594	4	2
2	Banjicë	552	647	0	1
3	Belicë	72	84	2	0
4	Bellopojë	176	210	2	0
5	Carrallukë	581	700	8	1
6	Cerkolez	346	420	4	1
7	Cerrcë	1248	1500	6	1
8	Dobrushë	1178	1400	6	1
9	Dragolec	420	500	2	0
10	Drejë	415	500	2	0
11	Dubovë e Vogël	258	300	0	1
12	Dubravë	1383	1621	4	1
13	Gjurakoc	2209	2589	9	2
14	Istog	5115	5995	26	3
15	Istog i Poshtëm	597	700	5	1
16	Kaliqan	835	1000	4	1
17	Kashicë	493	600	4	1
18	Kërninë	538	640	4	1
19	Kosh	245	290	3	0
20	Kovragë	731	900	5	1
21	Lubovë	732	900	4	1
22	Lubozhdë	893	1100	5	1
23	Llugë	589	700	2	1
24	Llukac i Begut	1267	1500	2	1
25	Llukac i Thatë	160	200	3	0
26	Mojstir	281	350	2	0
27	Muzhevinë	626	734	6	1
28	Orobërdë	1087	1300	6	1

29	Osojan	65	100	3	0
30	Polanë	15	20	0	1
31	Prekallë	343	410	4	1
32	Prigodë	571	669	4	1
33	Rakosh	872	1022	2	1
34	Savllakë	321	376	2	0
35	Synajë	228	300	2	0
36	Saradran	1563	2000	5	2
37	Studenicë	1495	1800	8	2
38	Suhogërlle	895	1100	4	1
39	Shalinovicë	105	150	1	0
40	Shushicë	1533	1900	5	1
41	Tomoc	765	950	5	1
42	Trubuhoc	904	1100	5	1
43	Tuçep	12	14	1	0
44	Uçë	786	950	4	1
45	Veriq+Veriq i ri	478	600	3	1
47	Vrellë	2641	3095	7	2
48	Zabllaq	459	600	2	1
49	Zallq	502	650	5	1
50	Zhakovë	349	420	1	1
Gjithsej TS		39289	47200	203	44

Tab. 53 Trafostacionet distributive në vendbanimet e komunës së Istogut

Planifikimi I ndriçimit rrugor

Ndriçimi aktual i vendbanimeve në Komunën e Istogut nuk është i kompletuar në të gjitha rrugët ashtu si duhet. Për këtë arsye për këtë 25 vjeçar janë paraparë të ndriçohen të gjitha rrugët e lagjeve, në të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale. Duhet planifikuar që ndriçimi të bëhet me llampa eficiente të teknologjive më të reja LED, të vendosura në shtylla metalike në vende Urbane apo në shtylla të Rrjetit Energjetik në vende rurale. Numri i llampave për ndriçimin e rrugëve të lagjes do të përcaktohet me projekt detal - zbatues dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare për ndriçim të rrugëve.

Furnizimi i këtyre llampave do të bëhet nga trafostacionet ekzistuese ose të reja ku edhe do të vendoset grupi mates i energjisë së nevojshme për ndriçim. Pajisjet për komandim të ndriçimit të jashtëm duhet të vendosen në trafostacione. Këto pajisje duhet të mundësojnë kyçjen automatike në mbrëmje dhe shkyçjen në mëngjes.

Për ndriçimim publik të hapësirave të veqanta, duhet veqar vendbanimet. Në fazat e para duhet ndjekur vendbanimet e mëdha në zonat urbane dhe vendbanimet në fshatrat e mëdhenjë, pastaj vendbanimet më të vogla.

Përveq vendbanimeve duhet të ndriçohen edhe hapsira tjera me interes të veqant si rrugët me qarkullim më të madh, zonat tregtare, zejtare, monumentet, etj. Gjatë projektimit të ndriçimit publik duhet pasur parasysh kushtet teknike. Kushtet e ndërtimit të ndriçimit publik do të trajtohen me leje ndërtimore dhe në bazë të planeve detale rregulluese, si dhe zgjidhjeve të bazuara në kushtet dhe teknologji, duke respektuar kërkesat e organeve për trashëgimi kulturore, ato komunale dhe të ndërmarrjeve energjetike.

Me këtë plan parashihet shfrytëzimi racional i burimeve shtesë si ato eficiente apo edhe të ripërtitëshme - nëse ka, duke siguruar funksionalitet dhe akomodim të këtyre stabilimenteve në hapësira publike dhe tjera, gjithnjë duke u përshtatur me rrethinën dhe në pajtim me normat teknike.

Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik përgjatë rrugëve dhe hapësirave tjera për rreth, në zonën e planifikuar, duhet ti plotësojë parametrat fotometrik të dhënë sipas normave evropiane EN 13201.

Gjatë realizimit të ndriçimit të rrugëve duhet të kihen parasysh këta faktor meritator për kualitetin e ndriçimit:

- Niveli i shkëlqimit të sipërfaqes së rrugës
- Shpërndarja e njëtrajtshme e shkëlqimit gjatësor dhe të përgjithëshëm.
- Kufizimi i verbimit momental për shkak të ndriçimit jekomfort, (zvogëlimin psikologjik të blinkimit).
- Lëvizje vizuale e trafikut.

Gjatë projektimit të ndriçimit për hapësira të rregulluara, kujdes i veçant duhet kushtuar pamjes estetike dhe vendosjes adekuate të ndriçimit.

Sistemi i ndriçimit parashihet të jetë për gjithë natën, dhe me mundësi të zvogëlimit të fuqisë pas orës 24.00, ndërsa kujdes ti kushtohet zgjedhjes së poçave për mirëmbajtje sa më të thjeshtë (lehtë).

Në raste kur ka mundësi buxhetore, të cilat detyrimisht i kthehen investitorit, është mirë të parashihet sistemi i kombinuar nga furnizimi me energji elektrike dhe panele solar në periudhat kur ka rrezatim nga dielli.

Me projekte të veqanta duhet të parashihen sisteme eficientë të ndriçimit.

Rrënja maksimale e tensionit në instalimin e ndriçimit nuk guxon të jetë më e madhe se 5% kur furnizimi bëhet nga trafostacioni.

Gjatë realizimit të instalimit të ndriçimit duhet të aplikohen masat e mbrojtjes nga tensioni i goditjes (mbrojtja direkt dhe indirekte), në këtë nënkuptohet shtrirja e përtokëzuesit të përbashkët të të gjitha shtyllat e instalimit të ndriçimit. Tokëzimi realizohet me shirit tokëzimi Fe\Zn 25x4 mm dhe lidhja e tij me shtylla dhe me përtokëzuesin e trafostacioneve.

Gjithashtu të realizohet mbrojtja selektive e secilit qark dhe e secilës poqë veçanërisht. Të realizohen pajisje për matjen e energjisë së shpenzuar të ndriçimit si dhe komandimi (kyçje – shklyçje) të realizohen ose nga foto-celulat ose me mekanizëm inkuadruar i orës.

Ndriçimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera të nevojshme do të bëhet me ndriçim artificial. Kur jemi te rrugët, një zonë e trajtuar ka disa nivele të klasifikimit të rrugëve, dhe varësisht nga kjo bëhet edhe klasifikimi i ndriçimit, dhe atë:

- për rrugët automobilistike kemi klasë M5 – 0,5 cd/m², për rrugë lokale me shpejtësi të ulët 10 deri 40 km/h dhe
- klasën M1 – 2,0 cd/m² për autorrugë.

Ndriçimi i këtyre hapësirave duhet të reflektoj një harmoni ndërmjet objekteve që ndriçohen, natyrës dhe ambientit përreth.

Për ndriçimin sa më të njëtrajtshëm trupi ndriqes do të vendoset në shtylla me lartësi të ndryshme, duke filluar nga 3 m në trotuare e deri 10-12 m në rrugë, të shpërndara nga njëra tjetra për 6 deri 50 m.

- Vendosja bëhet varësisht nga kërkesat për ndriçim dhe rëndësisë së rrugëve
- Rrugët me gjerësi deri 12 m ndriqesit vendosen vetëm në një anë.
- Rrugët me gjerësi deri 18 m ndriqesit varen mbi rrugë.
- Rrugët me gjerësi deri 40 m ndriqesit vendosen në dy anë të rrugëve.

Ndriçimi i rrugëve në kryqëzim duhet të jetë më i madh se i atyre që nuk kryqëzohen. Gjithashtu edhe ndriçimi i shesheve duhet të jetë më i madh se i rrugëve prej 50%.

Kërkesat e përafërta për ndriçim të rrugëve janë:

- Rrugët kryesore në qytet 4-8 lux/m².
- Për rrugë banimi 1-2 lux/m².

Dukuritë e shpërndarjeve jo të njëtrajtshme pastaj reflektime si dhe ndotje fotometrike dhe ndriçimet e deformuara duhet të evitohen. Rrjeti i ndriçimit do të shtrihet buzë rrugëve dhe do të jetë pjesë e atyre projekteve ekzistuese (zgjerim), por në raste të caktuara mund të ndërtohet edhe si rrjet i veçantë.


Kyçja në tension mund të realizohet edhe në trafostacionet e tensionit 20/04 kV në anën e tensionit të ulët por në fazën e ndërtimit duhet të lihen dalje rezerve për kyçje me tension 230/400 V si dhe kuadri për matjen e energjisë elektrike. Në vendet ku veç ekziston rrjeti i

ndriçimit ai duhet të mirëmbahet dhe të adaptohet në raport me kërkesat e këtij plani dhe të bëhen ndërhyrjet e nevojshme.

Për shtrirjen e kabllave për ndriçim vlejné normat për shtrirjen e kabllave tjerë të tensionit të ulët ashtu që të ruhen distancat ndërmjet kabllave dhe instalimeve tjera.

Investitori është i obliguar që të siguroj dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejës së ndërtimit dhe mbikëqyrjen profesionale të punimeve dhe lejës për shfrytëzim.

Pas përfundimit të punimeve investitori është i obliguar të paraqesë kërkesë për pranim teknik dhe pas kësaj të parashtroj kërkesë për lejën e përdorimit të objektit.



Harta 12 Rrjeti elektroenergetik

9.7 Rrjeti i telekomunikacionit

Gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në komunën e Istogut është relativisht e mirë, ajo përbehet nga disa rrjete telekomunikuese të pavaruara që janë:

- Rrjeti i postës dhe telefonisë së Kosovës PTK
- Rrjeti i kompanisë private IPKO dhe
- Rrjeti i kompanisë private KUJTESA.
- Rrjeti i kompanisë private ArtMotion

Përveq operatorve kryesor privat, në komunë operojnë edhe operatorët tjerë që kanë shtrirje më të vogël kryesisht në nivel lokal vetëm në ndonjë fshat.

Qendra e PTK-së është në Istog, me degët e veta në Rakosh, Vrellë, Gjurakoc dhe Bajë. Rëndësi të veçantë ka lidhja kryesore e PTK-së që shtrihet përgjatë autorrugës Pejë- Mitrovicë.

Telefonia Fikse- Aktualisht Komuna e Istogut disponon me një numër të vogël të lidhjeve të telefonisë fikse, që ka tendencë të zvogëlimit të mëtutjeshëm. Lidhjet kryesore të telekomunikacionit për Komunën e Istogut me qytetet tjara dhe jashtë komunës janë kablloptike të PTK dhe të operatorëve privat të telekomunikimeve. Rrjeti i kabllove optike dhe telekomunikimeve të PTK, menaxhohet nga njësia e PTK-së në Istog e cila ka objektet postare ku janë cetralet e telefonisë fikse. Përveq pjesës më të madhe të qytetit dhe fshatrave (Rakosh, Vrellë, Gjurakoc dhe Bajë), telefonia fikse nuk është e shtrirë në pjesët tjera të vendbanimeve rurale.

Shërbime Postare - PTK në përbërjen e vet ka edhe Postën që jap shërbime postare (mbedhjen, pranimin dhe distribuimin e letrave, paketave, të hollave dhe dërgesave të ndryshme). Gjithashtu nga kompanit private të cilat kryejnë shërbime si posta të shpejta dhe ngjajshëm.

Telefonia mobile - ka rrjet të zhvilluar të dy operatorëve të Kosovës Vala 900 dhe IPKO. Mbuluesmeria me rrjet të telefonive mobile në Komunen e Istogut është mjaft mire, mund të thuhet se shtrihet në të gjitha vendbanimet e komunës. Dy operatorët janë të licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunes.

Shërbime Interneti - të njëjtit operatorë së bashku me Kujtesën dhe ArtMotion japin edhe shërbime të Internetit dhe Televizionit kabllovik në tërë territorin e Komunës së Istogut. Territori i komunës është mjaft mirë i mbuluar me shërbime të internetit, të cilat funksionojnë si rrjete të sistemeve kabllorë me fije optike dhe rrjete kabllorë me kablo kaoksiale. Në ato lokacione ku nuk ka sistem kabllor, interneti shpërndahet me anë të antenave.


Radiotelevizioni – Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Istogut është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

- Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV
- Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore.
- Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllorë.

Planifikimi I sistemit të telekomunikimit

Rrjetet ekzistuese të telekomunikacionit nuk janë mire të planifikuara dhe të zhvilluara. Linjat telekomunikuese përdorin rrjetin ajëror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraparak. Ajo qka ka nevojë të përmiresohet në këtë sistem janë shtyllat nëpër lagje të caktuara të cilat janë deri diku të demtuara nga koha. Këto shtylla bejnë shpërndarjen e rrjetit telefonik në vendbanime dhe mundesojnë kalimin e këtij sistemi nga kabllo nëntokësorë në kablo ajrore, veqanërisht në vendbanime Urbane.

Duhet planifikuar që gjatë ndërtimit të rrugëve të reja të ndërtohen kanalizime kablovike ku do të shtrihet edhe kabllot optike. Kabllot do të nisen nga posta në disa drejtime. Në të ardhmen jo shumë të largët duhet planifikuar që fijet optike të vazhdojnë tutje deri të secili shfrytëzues në sistemin "fibre to home". Me fije optike do të sigurohet një kualitet shumëfish më i mirë dhe shumëfish më i fuqishëm i bartjes së informative.



Harta 13 Rrjeti i telekomunikacionit

Linja telekomunikuese të reja do të duheshin të jenë me kabllot me fije optike dhe me mundësi të barjes edhe të Internetit dhe televizionit kablovik. Njëherit duhet të planifikohet që operatorët e ndryshëm që operojnë në komunë siq janë PTK, IPKO, KUJTESA, etj. të koordinohen ndërmjet veti dhe të bëjnë plane- projekte të përbashkëta dhe aktuale me kohën.

9.8 Rrjeti i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave

Bazuar në planin zhvillimor komunal i cili ka përcjellë parimet dhe propozimet nga plani komunal të për menaxhimin e mbeturinave, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në Istog bëhet në 5 zonatë shërbimit:

- Zona e parë përfshinë qytetin e Istogut, Istogun e poshtëm, Dubravën dhe burgun e Dubravës.

- Zona e dytë përfshinë fshatrat Kovragë, Tomoc, Llukac i Begut, Gjurakoc, Banjë, Banjicë dhe Carallukë.
- Zona e tretë përfshinë fshatrat Kashicë, Staradran, Trubuhoc, Zabllaq, Zallq, dhe Dubovë e Vogël
- Zona e katërt përfshinë fshatrat Studenicë, Vrellë, Lubozhdë dhe Cërrcë.


Vendbanimeve të cilat nuk ju ofrohet shërbim i grumbullimit të mbeturinave nga KRM Ambienti janë fshatrat Belicë, Bellopojë, Cërrcë, Dobrushë, Dragolec, Drejë, Dubovë e Vogël (pjesërisht), Kaliqan, Kashicë, Kërrninë, Kosh, Llugë, Llukac i Thatë, Lubovë, Mojtir, Muzhevinë, Orrobërdë, Osojan, Polanë, Prekallë, Prigodë, Rakosh, Serbobran, Shalinovicë, Shushicë, Sinajë, Staradran, Suhogërlle, Tuçep, Uçë, Veriq, Veriq i Ri, dhe Zhakovë.

Në ndërkohë Istogu ka bërë përmirësime dhe zgjerim të zonës së shërbimit në fshatrat në vijim: Kovragë, Studenicë, Vrellë, Cërrcë, Lubozhdë, Dragolec dhe Tomoc, të cilat kanë qenë vetëm pjesërisht të mbuluara dhe numri i amvisërive është rritur për 1,355 më shumë. Tani këto vendbanime janë 100% të mbuluara me shërbime.

Ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe kompostim

Përmes dokumentit komunal të menaxhimit të mbeturinave komuna e e Istogut dëshiron të zbatojë në praktikë një plan menaxhimi të mbeturinave në mënyrë të integruar dhe bashkëkohore për të siguruar shërbime dhe kapacitete grumbullimi e deponimi duke rritur reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave në bashkëpunim me komunitetin si edhe duke ndërgjegjësuar gjithë palët përbërëse të këtij komuniteti.

Duke promovuar konceptin 3R zvogëlo, ripërdoro, dhe reciklo komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth benefiteve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Në këtë kontekst ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe kompostim do të përcaktohet në relacion me interesat qoftë ajo nga fusha e bizneseve apo donatorëve.



10.0 ARSYETIMI PËR NEVOJËN E HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME TË PLANIFIKUARA


Disa zona të caktuara në komunë për shkak të karakteristikave të tyre si dhe tendencës për zhvillim në të ardhmen kërkojnë një zhvillim më të detajuar, prandaj janë përcaktuar disa zona për të cilat parashikohen hartimi i planeve rregulluese të hollësishme.

Në zonën urbane Istog janë paraparë 2 zona:

- Zona përgjatë lumit Istog, prej burimit deri tek memoriali “Ibrahim Rugova”. Theksimi i trashëgimisë kulturore ‘zona historike’, mbrojtja e lumit si dhe ndërlidhja me qendrën e qytetit respektivisht integrimin e memorialit dhe krijimin e një “shtegu historic”.
- Zona “Qendra ana perëndimore”, e cila përfshinë një terësi banimi kolektiv, xhaminë, kishën, palestrën sportive, tregu, një pronë publike etj, në mënyrë të rregullimit dhe krijimit të një depërtueshmërie, krijimit të një hapësire publike dhe përmirësimit të imazhit të qendrës së qytetit e sidomos në relacion me memorailin “Ibrahim Rugova”

Plane Rregulluese të hollësishme janë paraparë edhe në subqendrat si:

- Gurakoc- zona “Qendra”
- Vrellë- Zona e burimit të Vrellës e cila përfshinë hapësirën prej burimit të Vrellës deri tek arteria kryesore e cila paraqet zonën me përmbajtje më të llojllojshme të këtij vendbanimi
- Banjë:
 - Zona përgjatë rrugës rajonale si një ndër zonat e zhvillimit komercial e cila përfshinë segmentin brenda kufirit të zonës së Banjës dhe kërkon trajtimi të vecantë sidomos në kontekst të rregullimit të kësaj “fasade” rrugore, mbrotjes së tokës bujqësor si dhe inkorporimit të banimit ekzsitues si një nga të metat e kësaj pjese.
 - Zona “Qendra” te stacioni i autobusëve e cila duhet t’i paraprijë projekteve të ardhshme turistike që lidhen me promovimin e turizimit shëndetësor.



11.0 PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM

Gjatë rishikimit të PZHK-së 2019-2027, pjesë e dokumentit është edhe analiza hapësinore (PZHK 2019-2027, fq 100) lidhur me implementim e planeve të veprimit (nga PZH 2007-2027) dhe ka rezultuar me një përputhshmëri të lartë implemementimesh të planeve të planifikuara në PZHK. Me po të njëjtin trend ka vazhduar edhe realizimi i planeve të veprimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Sipas raportit të dorëzuar nga komuna në MMPHI lidhur me “Projektet e realizuara”, rrjedh që projektet e planifikuara në vitin 2019 (të përcaktuara si me prioritet të lartë) janë realizuar plotësisht, projektet e planifikuara në vitin 2020 (të parçaktuara si me prioritet të dytë) janë realizuar plotësisht ndërsa projektet e vitit 2021 jo të gjitha, marrë për bazë ndrrimin e qeverisë si dhe situatën pandemike me COVID 19.

11.1 Planet e veprimit lidhur me zhvillimin socio-ekonomik

	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	KOSTO E PËRAFËRT	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM
1	Ndërtimi i parkut pranë Shkollës “Avni Rustemi” , në Zallq	Zallq	30000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2022-2023	Komuna
2	Ndërtimi i objektit të testoreve në stadium të futbollit "Demush"		280000	Transferet qeveritare	2021-2022-2023	Komuna
3	Rregullimi i poligonit sportiv me tartam në Uqë	Uqë	60000	Burime tjera financimi /	2021;2023	Komuna
4	Rregullimi i poligonit sportiv me tartam në Zallq	Zallq	40000	Transferet qeveritare	2022-2023	Komuna
5	Rregullimi dhe rrethimi i poligonit sportiv në Lluga	Lluga	20000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
6	Rregullimi i poligonit sportiv me bare sintetik në Saradran	Saradran	7000	Transferet qeveritare	2023	Komuna
7	Ndërtimi i sallës së sportit Shfmu-N.Mjeda,Rakosh	Rakosh	250000	Burime tjera financimi	2022	Komuna
8	Ndërtimi i sallës së sportit Shfmu "Trepça"Banjë	Banjë	450000	Burime tjera financimi	2021; 2023	Komuna
9	Ndërtimi i sallës së sportit Shml - "Haxhi Zeka " Istog	Istog	500000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
10	Ndërtimi i polig. sportive Shfmu Fan Noli Dobrushë	Dobrushë	20000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
11	Rregullimi i infrastrukturës jashtë Fan Noli Dobrushë	Dobrushë	20000	Nga të hyrat vetanake të komunës	2022	Komuna

12	Rregullimi i infrastruk.+rretho-Trepça, N.Mjeda		50000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
13	Ndërtimi i shtëpive për familjet pa strehë	Komunë	200000	Transfere qeveritare/ burime	2021-2022	Komuna
14	Ndërtimi i objektit të ri të QKMF	Istog	700000	Nga burime tjera të financimit	2022	Komuna
15	Ndërtimi i ambulancës në fshatin Veriq	Veriq	50000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
16	Inventarizimi i muzeut të qytetit tek memoriali "Ibrahim Rugova"	Istog	150000	Transferet qeveritare/ Burime	2021-2022	Komuna
17	Renovimi i sallës së koncerteve , ulseve ,ventilimi dhe dyshemese	Istog	64168	Transferte qeveritare	2022	Komuna
18	Rregullimi i oborrit prapa shtëpise së Kulturës	Istog	2000	Transferte qeveritare	2022	Komuna
19	Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në Gurakoc	Gurakoc	170000	Transferet qeveritare/ Burime tjera financimi/ të hyra vetanake	2021-2022	Komuna
20	Hartimi i planit rregullues të hollësishëm për zonën me karakter turistik "Zona përgjatë lumit Istog" sipas kufirit në HZK	Istog	80000	Tw hyra vetanake/ Nga burime tjera të financimit	2023-2025	Kompani projektuese
21	Hartimi i planit rregullues të hollësishëm për zonën "Qendra-ana perëndimore" sipas kufirit në HZK	Istog	72000	Tw hyra vetanake/ Nga burime tjera të financimit	2024-2026	Kompani projektuese
22	Ndërtimi i fushës sportive në të hapur	Belicë, Dragolevc, Dubravë, Synejë, Mojtir,	18000 (për 1 fushë)	Të hyra vetanake	2023-2025	Komuna
23	Ndërtimi i fushës sportive në të hapur	Muzhevnë, Kaliqan, Orobërdë, Studenicë,	18000 (për 1 fushë)	Të hyra vetanake	2025-2027	Komuna
24	Ndërtimi i fushës sportive në të hapur	Trubuhoc, Dobrushë, Llukavc I bregut, Llugë, Tomoc, Llukac I thatë, Zallq, Zabllaq, Drejë, Shalinovicë, Kosh, Polanë, Kovragë, Tuçep	18000 (për 1 fushë)	Të hyra vetanake	2027-2029	Komuna
25	Projektimi dhe ndërtimi i qendrës së komunitetit	Cërkolez	220000	Të hyra vetanake/ Burime tjera financimi	2023-2025	Kompani projektuese & Komuna
26	Projektimi dhe ndërtimi i qendrës së komunitetit	Dobrushë	200000	Të hyra vetanake/ Burime tjera financimi	2025-2027	Kompani projektuese & Komuna
27	Projektimi dhe ndërtimi i qendrës së komunitetit	Zallq	200000	Të hyra vetanake/ Burime tjera financimi	2027-2029	Kompani projektuese & Komuna

11.2 Planet e veprimit lidhur me transportin

	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	KOSTO E PËRAFËRT	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM
1	Riparimi i bus-stacioneve	Komunë	15000	Transferet qeveritare / Të hyra vetanake	2022	Komuna
2	Rregullimi i rrugës Shushicë-Shishicë e Ulët	Shushicë	35000	Të hyra vetanake	2021-2022	Komuna
3	Rregullimi i rrugës malore Vojdulle-Javor	Vojdulle-Javor	40000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021 / 2023	Komuna
4	Ndërtimi i rrugëve ne Istog	Istog	420000	Transferet qeveritare / Të hyra vetanake	2021-2023	Komuna
5	Ndërtimi i rrugëve ne Banje	Banje	200000	Transferet qeveritare	2021-2023	Komuna
6	Ndërtimi i rrugëve ne Gurrakoc	Gurrakoc	200000	Transferet qeveritare / Të hyra vetanake	2021, 2023	Komuna
7	Ndërtimi i rrugës "Selim Brahimaj" Shushicë	Shushicë	87469	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare / Të hyra vetanake	2021-2022-2023	Komuna
8	Ndërtimi i rrugëve në Rakosh	Rakosh	150000	Burime tjera financimi / Të hyra vetanake	2021-2022-2023	Komuna
9	Ndërtimi i rrugës "Shaban Hazeraj" ne Veriq	Veriq	276000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
10	Ndërtimi i rrugës "Bekë Salih" në Dubravë	Dubravë	44000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
11	Ndërtimi i rrugës në lagjen Dërvishaj		100000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
12	Ndërtimi i rrugës në Cerkolez	Cerkolez	100000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
13	Ndërtimi i rrugëve lokale ne Zallq	Zallq	100000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
14	Ndërtimi i rrugës "Unazore" në Istog	Istog	4020000	Burime tjera financimi	2021-2022-2023	Komuna
15	Ndërtimi i rrugës "Ramë Tahiri" në Cerrcë	Cerrcë	40000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
16	Ndërtimi i rrugës ne Kërminë	Kërminë	80000	Burime tjera financimi	2021-2022-2023	Komuna
17	Ndërtimi i rrugëve në Drejë	Drejë	30000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
18	Ndërtimi i rrugës Dubovë e Madhe-Dubovë e Vogël	Dubovë	40000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
19	Ndërtimi i rrugëve Kashicë	Kashicë	50000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
20	Ndërtimi i rrugës lagja Llapaj dhe Kurtaj Istog I Poshtëm	Istog I Poshtëm	20000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
21	Ndërtimi i rrugës në lagjen e Sadikrexhëve-Llukavc i Begut	Llukavc i Begut	30000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
22	Ndërtimi i rrugës "Rusolia" ne Dobrushë	Dobrushë	30000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
23	Ndërtimi i rrugës Oprashkë-Shalinovicë	Shalinovicë	150000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
24	Ndërtimi i rrugës "Bajram Hasani"		70000	Transferet qeveritare	2020	Komuna

25	Ndërtimi i rrugës Llukafci i Thatë-Osojan	Llukafci i Thatë/Osojan	422000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021-2022	Komuna
26	Rruga transit në Istog	Istog	1205000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021; 2023	Komuna
27	Ndërrimi i kaldasë/ngrohjes qendrore G.Ynë		10000	Transferet qeveritare	2023	Komuna
28	Ndërtimi i trotuareve në Gurakoc	Gurakoc	10000	Transfere qeveritare	2023	Komuna
29	Ndërtimi i trotuarit Istog-Gurakoc (vazhdimi)	Istog-Gurakoc	40000	transfere qeveritare/ të hyra vetanake	2023	Komuna
30	Trotuari Serboran-Gurakoc	Serbobran ,Gurakoc	90000	transfere qeveritare/ të hyra vetanake/ burime tjera financimi	2022-2023	Komuna
31	Vazhdimi i trotuarit dhe shtigjeve të biçikletave në Rrugën "Dëshmorët e Kombit"		61953	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021-2022-2023	Komuna
32	Rregullimi i trotuarve në zonat urbane të Komunës	Istog	170000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021-2022-2023	Komuna
33	Trotuari nga fshati Corollukë nga Rruga "Ahmet Rugova" dhe "Podrimaj"	Corollukë	20000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021;2023	Komuna

11.3 Planet e veprimit lidhur me infrastrukturën teknike

AKTIVITETI		VENDNDODHJA	KOSTO E PËRAFËRT	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM
1	Ndërtimi i kanalizimit në Kashicë	Kashicë	43000	Të hyrat vetanake, grante qeveritare dhe donatorë	2020 dhe 2022	Komuna
2	Ndërtimi i kanalizimit në Rakosh	Rakosh	30000	Të hyrat vetanake, grante qeveritare	2020-2021	Komuna
3	Ndërtimi i kanalizimit në Mojstir-Syne	Mojstir, Syne	75000	Transfere qeveritare/ të hyra vetanake/ burime tjera financimi	2022-2023	Komuna
4	Ndërtimi i kanalizimit në Trubuhovc-Prekallë	Trubuhovc, Prekallë	40000	Burime tjera financimi	2023	Komuna
5	Ndërtimi i kanalizimit në Zallq-Zabllaq	Zallq, Zabllaq	100000	burime tjera financimi	2023	Komuna
6	Ndërtimi i kanalizimit në Dubravë-Kovragë	Dubravë, Kovragë	10000	burime tjera financimi	2023	Komuna
7	Ndërtimi i kanalizimit në Tomoc-(by pas-i)	Tomoc	40000	Transfere qeveritare/ burime tjera financimi	2021-2022	Komuna
8	Ndërtimi i kanalizimit në Cërkolez	Cërkolez	25000	Transfere qeveritare/ të hyra vetanake	2022	Komuna
9	Ndërtimi i kanalizimit Kalijan-Orobërd-Studenicë-Kalijan (Faza 3)	Kalijan, Orobërd, Studenicë	50000	Transfere qeveritare/ të hyra vetanake	2022	Komuna
10	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në rrugën "24 Qershori"	Zallq	15000	Të hyra vetanake	2023	Komuna
11	Kanalizimi në Kashicë	Kashicë	105000	Transfere qeveritare/ të hyra vetanake	2022-2023	Komuna
12	kanalizimi në Serboran- Iajga Zikoli, Bajraktarovic	Serbobran	50000	Të hyra vetanake	2023	Komuna
13	Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog	Istog	85000	Transfere qeveritare/ Të hyra vetanake	2021-2023	Komuna
14	Ndërtimi i ndriçimit publik në lagjen Qazim Hakaj	Studenicë	20000	Të hyra vetanake/ Burime tjera financimi	2021-2022	Komuna
15	Identifikimi dhe analiza e instalimeve elektrike, të telekomunikacionit dhe drunjtëve në vendbanimet e rrezikuara nga era	VendRakosh, Kovragë, Fushë e Tomocit. Prigodë, Lubovë	100000	Transfere qeveritare/ Burime tjera financimi	2022-2026	Kompani e spacializuar & Komuna

11.4 Planet e veprimit lidhur me mjedisin

AKTIVITETI		VENDNDODHJA	KOSTO E PËRAFËRT	BURIMET E PARAPARA TË FINANCIMIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR ZBATIM
1	Ndërtimi i deponisë së mbeturianve në Tuçep	Tuçep	40,000	Transferet qeveritare/ Të hyra vetanake/ nga burime tjera financimi	2022-2023	Komuna
2	Mirëmbajtja e rrugëve malore	Pjesa e Bjeshkës	150,000	Transferet qeveritare	2021, 2022, 2023	Komuna
3	Rregullimi i lumit Shushica Kovrage-Tomoc	Kovragë, Tomoc	150000	Transferet qeveritare	2023	Komuna
4	Rregullimi i argjinaturave të lumit Istog	Istog	2300000	Burime tjera financimi	2021-2022-2023	Komuna
5	Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit te ujit e deri te ura	Istog	597773	Transferet qeveritare / Të hyra vetanake	2021-2022	Komuna
6	Ndërtimi i stazes se skijimit nga Bajshja ne Livadhe te Istogut	Istog	60000	Nga burime tjera të financimit / Transferet qeveritare	2021 ; 2023	Komuna
7	Rregullimii përroit vërshues -lagja Haskaj-	Cërccë	20000	Transferet qeveritare/ Të hyra vetanake	2023	Komuna
8	Kanali i ujitjes në Dobrushë	Dobrushë	70000	Transferet qeveritare/ Të hyra vetanake	2023	Komuna
9	Kullimi i tokave bujqesore	Komunë	80000	Transferet qeveritare	2021-2022	
10	Betonimi i kanalit për ujitje -lagja Gjocaj	Tomoc	80000	Transferet qeveritare	2021, 2022, 2023	Komuna
11	Rregullimi i kanalit të ujitjes Osmanaj-Drejsë	Drejë	150000	Transferet qeveritare	2021-2022	Komuna
12	Betonimi i kanalit te ujitjes Prekalle-Zabllaq	Zabllaq	300000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
13	Betonimi i kanalit te ujitjes Coorrolluke-Saradran	Corrollukë, Saradran	250000	Burime tjera financimi	2022	Komuna
14	Betonimi i kanalit të ujitjes Stupë-Gollopolë në Vrellë	Vrellë	40000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
15	Rehabilitimi i sistemit te ujitjes ana e djathte Vrelle-	Vrellë, Studenic	120000	Të hyra vetanake	2023	Komuna
16	Betonimi i kanalit te ujitjes -Llukavc I Begut	Llukavc I Begut	40000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
17	Betonimi i kanalit te ujitjes jazi I Begut-Te lagja		70000	Transferet qeveritare	2022	Komuna
18	Betonimi i kanalit Jaruga-Istog	Istog	165000	Burime tjera financimi / Transferet	2021, 2023	Komuna
19	Betoni i kanalit te ujitjes Uqë-Rakosh	Uqë, Rakosh	360000	Burime tjera financimi / Transfere qeveritare	2021, 2023	Komuna
20	Betonimi i Kanalit të ujit Termal nga Oniksi deri në Corollukë	Corollukë	60000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021, 2023	Komuna
21	Rregullimin e kanalit të ujitjes nga Lagjia Hysen Hysenaj dhe Rëxhë Destani"		30000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021, 2023	Komuna

22	Betonimi i kanaleve për ujtitje – Dubovë e vogël	Dubovë e vogël	40000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2021, 2023	Komuna
23	Pyllëzim i sipërfaqeve të zhveshura dhe të degraduara	Pjesa e Bjeshkës (Kaliqan, Studenicë, Vrellë, Lubozhdë, Cërrcë, Uçë, Zhakovë)	100000 / ha	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2022-2029	Komuna &
24	Hulumtimi i pendave mbrojtëse/argjinatura për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjë të bjeshkëve	Vendbanimet që shtrihen rrëzë bjeshkëve të komunës	120000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2022-2024	Kompani e specializuar & Komuna
25	Projektimi dhe ndërtimi i pendave mbrojtëse/argjinatura për mbrojtje nga erozioni që shkaktojnë përrenjë të bjeshkëve	Vendbanimet që dalin nga analiza e fizibilitetit	varësisht prej analizës së fizibilitetit	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2024-2029	Kompani e specializuar & Komuna
26	Projektimi dhe Rregullimi i varrezave të qytetit dhe shëndërrimi i tyre në park	Istog	300000	Të hyra vetanake	2022-2025	Kompani projektuese
27	Ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe kompostim	Tuçep	120000	Burime tjera financimi / Transferet qeveritare	2026-2028	Kompani e specializuar & Komuna & Organizata

12.0 NDRYSHIM PLOTËSIMET, PËRJASHTIMET DHE JOKONFORMITETI

12.1 Ndryshim plotësimet

Në bazë të Neni 34 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, pjesët tekstuale ose hartografike të hartës zonale mund të ndryshohen plotësohen me vendim të Kuvendit të Komunës, dhe të miratohen nga Ministria. Propozimet për ndryshim-plotësime mund të bëhen nga:

- anëtarët e Kuvendit Komunal;
- nga autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, ose
- nga pronarët e parcelave kadastrale të sipërfaqes e cila është subjekt i ndryshim-plotësimit të propozuar.

Ndryshim plotësimet nuk përdoren për ti dhënë privilegje ndonjë pronari të veçantë të pronës, por përdoren vetëm për të përshtatur dispozitat e Hartës Zonale të Komunës si rezultat i ndryshimeve të kushteve rishtas të identifikuara, ose ti shërbej për një interes bindës publik. Ndryshim-plotësimet përbëhen nga një proces dy-hapësh:

- propozimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimit e cila miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe
- propozimin për ndryshim plotësimin e Hartës zonale të komunës që miratohet nga dy te tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Nëse propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës dorëzohet nga ndonjë subjekt tjetër e jo nga komuna, të gjitha shpenzimet për hartimin e këtij ndryshim plotësimi kompensohen nga aplikuesi. Të gjitha propozimet për ndryshim plotësim duhet t'i dorëzohen Komunës në formë fizike dhe në formë digjitale (GIS).

Kërkesat për ndryshim plotësime realizohen në përputhje me Nenin 35 dhe 36 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

12.2 Përfashtimet

Në bazë të Neni 37 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Komuna mund të lejoj përfashtime nga Kushtet zhvillimore vetëm në rastet kur dëshmohet privimi i mundësisë së zhvillimit të një parcele kadastrale sipas këtyre kriterëve:

- karakteristikat e veçanta të tokës e bëjnë të pamundur që aplikuesi t'u përmbahet të gjitha kushteve zhvillimore;
- përfashtimi kërkohet për shkak të kushteve unike të pronës e jo për shkak të kushteve të përgjithshme të lagjes;

- përjashtimi nuk ka efekt dëmtues në mjedis ose në hapësirën gjithëpërfshirëse;
- privimi nuk është rezultat i veprimeve të marra nga pronari i tokës ose ish pronari;
- përjashtimi nuk do të krijojë ndikime negative në pronat fqinje ose pronave të tjera në afërsi;
- vlerat e pronave fqinje;
- shfrytëzimin dhe zhvillimin e pronave fqinje;

Përjashtimi mund të lejohet edhe për nevojat e personave me aftësi të kufizuar që jeton në atë pronë dhe ka nevojë për qasje në parcelë dhe ndërtesë, deri në kohëzgjatjen e aftësisë së kufizuar ose derisa personi jeton në atë pronë;

Përjashtimet vendosen nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor. Komuna mund të themelojë një komision profesional për të vendosur apo për të këshilluar mbi kërkesat për përjashtim. Përjashtimet mund të jepen vetëm nëse:

- struktura dhe shfrytëzimi i propozuar plotëson kushtet zhvillimore të Hartës zonale të Komunës, përveç dispozitës specifike nga e cila kërkohet lehtësim;
- aplikuesi dëshmon kriteret e përcaktuara në këtë nen;

Përjashtim mund të jepet me kushte të veçanta sipas nevojës, për të parandaluar dëmin ndaj parcelave dhe ndërtesave tjera në zonë, ndaj shërbimeve apo infrastrukturës publike dhe për të zvogëluar ndikimet tjera negative.

Në rastet kur miratohet përjashtimi, aplikuesi aplikon për leje ndërtimore sipas procedurës së rregullt. Aplikacioni për leje ndërtimore dorëzohet brenda 1 (viti) pas vendimit për miratim të kushteve të veçanta për përjashtim, kurse pas këtij afati kohor përjashtimi bëhet i pavlefshëm.

12.3 Jokonfomiteti

Në bazë të Neni 38 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës jo-konformitet është një shfrytëzim, ndërtim apo parcelë kadastrale ekzistuese para miratimit të Hartës Zonale të Komunës të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat aktuale të zonimit. Jo-konformitetet do të lejohen të vazhdojnë edhe nëse nuk është në përputhje me Hartën zonale të Komunës për aq sa jo konformiteti të vazhdojë të plotësojë kërkesat e ligjeve tjera, dhe nuk pëson ndryshime.

Komuna zbaton kushtet zhvillimore ndaj jo konformitetit në rastet kur:

- Shfrytëzimi jonkonform është ndryshuar;
- Ndërtimi jonkonform është zgjeruar, ndryshuar apo edhe rindërtuar si shfrytëzim jonkonform për arsye tjera që nuk janë me rëndësi madhore.

13.0 INTERPRETIMI, ANKESAT, ZBATIMI DHE MONITORIMI I HARTËS ZONALE TË ISTOGUT

Harta Zonale e Komunës për çështje praktike nuk mund të adresojë çdo çështje specifike të zonimit, meqenëse është e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse. Prandaj autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për interpretimin e rregulloreve të zonimit, duke mos shtuar apo ndryshuar përmbajtjen thelbësore të Hartës Zonale të Komunës.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis është përgjegjëse për interpretimin e shfrytëzimit dhe dispozitave të HZI-së duke u bazuar në Udhëzuesin për hartim dhe monitorim të Hartës Zonale të Komunës. Gjithashtu bazuar në këtë udhëzues drejtoria duhet të bëjë interpretimin e dispozitave të HZI-së për aplikuesin e lejes ndërtimore.

DPUM gjithashtu është përgjegjëse për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për ankesat e parashtruara, trajtimi i të cilave do të bëhet në përputhje me Ligjin për procedurën e Përgjithshme Administrative apo të rregulloreve komunale në fuqi.

DPUM ka për detyrë përcjelljen e procesit të zbatimit dhe monitorimit të HZK-së. Komuna e Istogut duhet të përcaktojë ekipin komunal për zbatimin dhe monitorimin e dokumenteve. Ky ekip mund të përbëhet nga zyrtarë komunal dhe ekspertë të jashtëm. Administrimi i zbatimit të HZK-së, përfshin procesin e përcjelljes së zbatimit të dispozitave të HZK-së si dhe administrimin e aktiviteteve, financimit, koordinimit dhe të gjitha përpjekjeve të administratës komunale dhe organeve tjera kompetente për zbatimin e HZK-së.

DPUM është përgjegjëse edhe për monitorimin e zbatimit të HZK-së sipas UA mbi elementet dhe kërkesat për hartim, zbatim dhe monitorim të Hartës Zonale. DPUM së bashku me ekipin komunal për zbatim dhe monitorim të HZK-së vlerësojnë nëse zhvillimet korrespondojnë me ato të planifikuara me PZHK apo HZK. Monitorimi duhet të bëhet në atë mënyrë që të koordinohet me futjen e të dhanve nga secila drejtori në databzën në programin e GIS-it. Drejtoritë duhet të përgatisin raportin vjetor lidhur me zbatimin dhe vlerësimin e HZK0së apo PZHK-së dhe t'a hartojë atë sipas udhëzimeve administrative respective. Raportet nga secila drejtori do t'i dorëzohet DPUM-së e cila përgatit raportin përfundimtar të zbatimit dhe vlerësimit të HZK-së apo PZHK-së dhe i dorëzohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim. Pas shqyrtimi dhe miratimit e dorëzon në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nga ky raport rrjedhin konkludimet lidhur me përmirësimet e nevojshme të HZK-së në fuqi.

PJESA HARTOGRAFIKE

1.0 Shtresat e përgjithshme

2.0 Harta e të dhënave bazë

3.0 Harta me sipërfaqe dhe ndërtesa me rëndësi për Kosovën

4.0 Harta e shfrytëzimit bazë të tokës

5.0 Harta e shfrytëzimit të tokës bujqësore

5.1 Harta e shfrytëzimit të tokës bujqësore- boniteti

6.0 Harta e infrastrukturës rrugore

7.0 Harta e infrastrukturës publike dhe sociale

7.1 Harta e infrastrukturës publike dhe sociale- Shërbimi I komuniteti

7.2 Harta e infrastrukturës publike dhe sociale- Shërbimi I kulturor, argëtues, rekreativ

8.0 Harta e infrastrukturës teknike

8.1 Rrjeti I ujësjellësit

8.2 Rrjeti I kanalizimit fekal

8.3 Rrjeti I kanalizimit atmosferik

8.4 Sistemi I drenazimit

8.5 Rrjeti I energjisë elektrike

8.6 Rrjeti I telekomunikacionit

8.7 Rrjeti I deponimit dhe menaxhimit të mbeturinave

9.0 Harta e zonave mbishtresore

10. Harta e Zonave te Veçanta te Mbrojtura

11.0 Harta e Planeve rregulluese- Planet ne fuqi

11.1 Harta e Planeve Rregulluese- Kufinjte e PRRH-ve të parashikuara

12.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona Urbane Istog

12.1 Karakteristikat dhe kushtet e terrenit ne zonën urbane

13.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona suburban Banjë

14.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona suburban Gurakoc

15.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona suburban Vrellë

16.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona suburban Rakosh

17.0 Shfrytëzimi bazë I tokës- Zona rurale Saradran

Referencat

- Tourism planning – fourth edition Clare A. Gunn, Turgut Var
- Rulebook on types, minimum technical conditions and categorization of hospitality facilities (Official gazette of Montenegro 036/18)
- A sense of place, Design guidelines for Yosemite national park
- Plani hapësinor, Parku kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës
- Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e Turizmit-Instituti i planifikimit
- Udhëzim Administrativ MMPH-Nr. 08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor
- Metric Handbook Planning and Design data edited by David Littlefield
- American society of planning officials;
- DSD Design Standards for Nursing Homes;
- Introduction to Architectural Design: Libraries J. Paul Guyer, P.E., R.A., Felloë ASCE, Felloë AEI;
- IFLA/UNESCO Guidelines for development The Public Library Service;
- Libraries and Learning Resource Centres - Brian Edëards;
- Sportski Objekti Arch.dipl.ing Slobodan Ilić;
- Sports Halls design & Layouts Sport England;
- Ernst and Peter Neufert “Architects’ Data” Third edition;
- Community centre guidelines - for Landcom projects
- Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore; Udhëzimet e përgjithshme; Vëllimi 1;
- Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore; Udhëzimet e përgjithshme; Vëllimi 2;
- Udhëzues për normat dhe standardet e hapësirave të objekteve parashkollore;
- Manual of standard building specifications
<https://ëëë.gsa.gov/cdnstatic/designguidesmall.pdf>
- Plani Zhvillimor Komunal I Istogut
- Plani Zhvillimor Urban – Istogu
- Plani Rregulles Urban – Istog
- Plani Rregulles Urban-Banjë
- Plani Zhvillimor Urban -Vrellë
- Plani Plani Zhvillimor Urban -Rakosh
- Plani Rregulles Urban-Gurakoc
- Plani territorial për Istogun 1997-1998 “ Karakteristikat e terrenit dhe kushtet e zhvillimit te terrenit”

- Plani Regional i Trashëgimisë 2012-2015: Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
- Ligji Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore
- Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
- Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e natyrës
- Ligji Nr.03/L-230 për Vlerësim Strategjik Mjedisor
- Ligji Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore
- Ligji Nr.04/L- 110 për Ndërtim
- Ligji Nr.2003/11 për Rrugët
- Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji Nr.03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr.2003/11
- Ligji Nr.06/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/11 për Rrugët i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-120
- Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e veçanta të mbrojtura
- Ligji Nr.02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma
- Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës
- Udhëzimi Administrativ Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal
- Udhëzimi Administrativ Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e hartës zonale të komunës si dhe
- Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve;
- UA Nr.08/2017 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor
- UA Nr.04/2011 për Vendosjen, Formën, Ngjyrën, Dimensionet e Shenjave dhe Sinjalizimet e Pajisjeve në Komunikacion Rrugor
- UA Nr.09/2015 për Kyçje, Instalime, nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe rajonale
- UA Nr.09/2015 për kyçje, Instalime, nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale.
- UA Nr.08/2009 mbi vlerat e lejuara të emisioneve të zhurmës nga burimet e ndotjes
- UA Nr.11/2016 për përcaktimin, mënyrë e mbrojtjes së zonave erozive
- UA Nr. 04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve
- UA Nr.15/2017 për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit
- UA Nr. 02/2012 klasifikimi I përshtatshmërisë së tokës bujqësore